

Më 2015, Albanisches Institut në bashkëpunim më shtëpinë botuese "Konica" kemi botuar librin e Injac Zamputtit "Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)", vepër të cilën autori e kishte lënë në dorëshkrim. Ashtu edhe siç kemi paralajmëruar edhe më herët se do të ribotojmë veprat të tjera të Injac Zamputtit, kësaj radhe po ribotojmë "Relacionet", vepër që ishte botuar më parë në dy vëllime, por që këtu po i botojmë së bashku në një vëllim të vetëm. Injac Zamputti është njëri ndër historianët më të rëndësishëm për historinë shqiptare. Vepra e tij është pa dyshim themeli dhe shtylla kryesore e historiografisë shqiptare. Zamputti kishte kuptuar rëndësinë e dokumenteve dhe e kishte marrë përsipër këtë si një mision, që të sillte në shqip dokumentet më të rëndësishme për historinë shqiptare. Në fakt ai ishte pothuajse i vetmi shqiptar që e kuptoi si askush tjetër se njohja e burimeve janë mundësia më e mirë për të studiuar si duhet historinë e një vendi dhe përmes kësaj nisme ai synoi të krijonte breza të rinj historianësh të mirëfilltë. Modeli i transkriptimit, përkthimit dhe botimit të dokumenteve në gjuhën shqipe dhe origjinale (italiane e latine), ka mbetur sot e kësaj dite ende i "vetmuar".

Albert Ramaj

RELACIONE DHE DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1610-1650)

RELAZIONI E DOCUMENTI
PER LA STORIA
DELL' ALBANIA 1610-1650

Transkriptuar e përkthyer nga
Trascritti e tradotti da

Injac Zamputti

**RELACIONE E DOKUMENTE
PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1610-1650)**

**RELAZIONI E DOCUMENTI
PER LA STORIA DELL'ALBANIA (1610-1650)**

Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti da

Injac Zamputti

**RELACIONE E DOKUMENTE
PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1610-1650)**

**RELAZIONI E DOCUMENTI
PER LA STORIA DELL'ALBANIA (1610-1650)**

Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti da

Injac Zamputti

Ribotim i përpunuar nga - riedizione elaborata da
Jozef Zamputti

albanisches
institut

FAIK KONICA

St. Gallen-Prishtinë
2018

RELACIONE E DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1610-1650)
RELAZIONI E DOCUMENTI PER LA STORIA DELL'ALBANIA (1610-1650)

Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti
da **Injac Zamputti**

Përgjegjës të këtij botimi:

Jozef Zamputti
Albert Ramaj
Nazmi Rrahmani
Zef Ahmeti
Kastriot Marku

© Albanisches Institut

Albanisches Institut
Postfach 7, CH-9001 CH-St. Gallen
www.albanisches-institut.ch
info@albanisches-institut.ch

(CIP) Schweizerische Landesbibliothek
ISBN 978-3-9524201-5-7

SHB Faik Konica
Rr. Ganimete Tërbeshi nr. 20
10000 Prishtinë
konica_faik@hotmail.com

(CIP) Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"
ISBN 978-9951-06-679-2

RELACIONE E DOKUMENTE PËR HISTORINË E SHQIPËRISË (1610-1650)
RELAZIONI E DOCUMENTI PER LA STORIA DELL'ALBANIA (1610-1650)



Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti da

Injac Zamputti

Përgatitur për shtyp nga i biri i autorit, *Jozef Zamputti*
Me rastin e 20 vjetorit të kalimit në amshim të Injac. Zamputtit
Kujtimit të paharrueshëm të babës së dashtun, *djali e vajzat.*

*Vëllimet e relacioneve të botuara në vitet 1963 dhe 1965 kanë origjinalin e transkriptuar dhe përkthimin në dy fletë krahas njera tjetrës. Ne i kemi sjellë në të njejtën faqe në dy shtylla, ashtu si në të gjitha vëllimet e mëvonshme të dokumenteve. Po ashtu, kemi sjellë në fund të çdo faqeje shënimet që, në botimet e para të relacioneve, janë në fund të vëllimeve. Nuk kemi ndërhyrë në gjuhën e përdorur nga autori. (Deri në fund të viteve '60 është lejuar edhe dialekti i veriut siç del edhe në punimet e tjera të autorit të asaj periudhe). Kemi pasqyruar ndreqjet e autorit mbi librin e botuar si edhe kemi ndrequr gabimet sipas listës së botuar në fund të librit. "Parathania" është e vetë autorit. Jemi përpjekur të mos bëjmë gabime gjatë hedhjes së materialit në kompjuter, por, me gjithë kontrollin tonë edhe gjatë përgatitjes për shtyp, mund të ketë gabime. Kur lexuesi të ketë ndonjë dyshim, mund të na sinjalizojë në adresën: jozef_zamputti@yahoo.it dhe ne e kontrollojmë me librin e botuar më parë. Shënimet tona i kemi me siglën **J. Z. - Jozef Zamputti**. E kemi shkruar mbiemrin **Zamputti** me dy **t** siç ka qenë dhe është gjithmonë në regjistrat e gjendjes civile, por që nga autori dhe familjarët u përdor me një **t** në ato vite për arsye që kuptohen. Falenderojmë Z. Kastriot Marku për punimin kushtuar autorit të këtij libri. Një falenderim i veçantë për Z. Albert Ramaj pa dashamirësinë e të cilit ky ribotim do të ishte i pamundur.*

Jozef Zamputti

PËRMBAJTJA- INDICE

Parafjala e botuesit	9
Parathanie	11
SHËNIME MBI RANDËSINË E RELACIONEVE SI BURIM	17
PËR HISTORINË E VENDIT TONË.....	17
I.....	41
(1610 – 1634)	41
INDEKSI	43
INDEKSI I EMNAVE.....	379
BURIMI ARKIVAL DHE BIBLIOGRAFIA	424
AUTORËT E RELACIONEVE E TË KORRESPONDENCËS	425
II	427
(1634 – 1650)	427
INDEKSI	429
TERMINOLOGJI	759
INDEKSI I EMNAVE.....	771
BURIMI ARKIVAL DHE BIBLIOGRAFIA	800
AUTORËT E RELACIONEVE E TË KORRESPONDENCËS	801
INJAC ZAMPUTTI - THEMUESI I DIPLOMATIKËS DHE I SHKOLLËS HISTORIOGRAFIKE MODERNE SHQIPTARE	
<i>Nga Dr. Kastriot Marku.....</i>	803

Parafjala e botuesit

Më 2015, Albanisches Institut në bashkëpunim më shtëpinë botuese “Faik Konica” kemi botuar librin e Injac Zamputtit “Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)”, vepër të cilën autori e kishte lënë në dorëshkrim. Ashtu edhe siç kemi paralajmëruar edhe më herët se do të ribotojmë veprat të tjera të Injac Zamputtit, kësaj radhe po ribotojmë “Relacionet”, vepër që ishte botuar më parë në dy vëllime, por që këtu po i botojmë së bashku në një vëllim të vetëm.

Injac Zamputti është njëri ndër historianët më të rëndësishëm për historinë shqiptare. Vepra e tij është pa dyshim themeli dhe shtylla kryesore e historiografisë shqiptare. Zamputti kishte kuptuar rëndësinë e dokumenteve dhe e kishte marrë përsipër këtë si një mision, që të sillte në shqip dokumentet më të rëndësishme për historinë shqiptare. Në fakt ai ishte pothuajse i vetmi që e kuptoi si askush tjetër se njohja e burimeve janë mundësia më e mirë për të studiuar si duhet historinë e një vendi dhe përmes kësaj nisme ai synoi të krijonte breza të rinj historianësh të mirëfilltë. Modeli i transkriptimit, përkthimit dhe botimit të dokumenteve në gjuhën shqipe dhe origjinale (italiane e latine), ka mbetur sot e kësaj dite ende i “vetmuar”.

Për Institutin tonë në Zvicër “*Albanisches Institut*”, është nder i madh që të ribotojmë “*Relacionet*” e Zamputtit, botuar së pari në Tiranë para më shumë se 50-vjetësh, me titullin: “*Relacionet mbi gjendjen e Shqipërisë veriore e të mesme në shekullin XVII*” vëllimi I (1610-1634) më 1963 dhe vëllimi II (1634-1650) më 1965. Këto dy vëllime po i ribotojmë në një të përbashkët. Përgatitjet për këtë botim janë meritë e Jozef Zamputtit - i biri i Injac Zamputtit, i cili duhet falënderuar për punën e tij të zellshme dhe të durueshme. Duke qenë se vëllimet me dokumente qenë botuar në dialektin gegë, pra para vendosjes së standardit gjuhësor të vitit 1972, ne kemi respektuar botimin e parë edhe në këtë ribotim. Një ndryshim tjetër vjen në këtë botim, krahasuar me botimin e parë, sepse titullin e kemi vënë edhe në gjuhën italiane, përveçse atij shqip, ngaqë dokumentet janë në dy gjuhë, pra shqip e italisht kështu që e pamë të arsyeshme që titulli të jetë po ashtu dygjuhësh.

Ribotimin e shoqëron në fund një pasthënje e studuesit *Kastriot Marku*, një ndër njohësit më të mirë të punës studimore të Injac Zamputtit. Po ashtu Instituti do të ribotojë të gjitha botimet apo dorëshkrimet e Zamputtit, sikurse jemi marrë vesh me Jozef Zamputtin, pra të gjitha veprat e artikujt dhe shkrimet e tij të botuara nëpër revistat shkencore apo në gazeta të ndryshme; tezën e tij të doktoraturës (të pabotuar), si dhe ditarin e tij (të pabotuar). I gjithë ky angazhim bëhet për respektin që kemi ndaj punës dhe veprës së Zamputtit.

Këtë botim e bëjmë së bashku me shtëpinë botuese “Faik Konica” në Prishtinë për të cilën gjejmë rastin për të falënderuar Nazmi dhe Arbër Rrahmanin për përkrahjen e tyre dhe bashkëpunimin dinjitoz si dhe Zef Ahmetin për angazhimin e tij në përgatitjen librit.

Ripublikimi bëhet në 20 vjetorin e kalimit në amshim të Injac Zamputtit (1910-1998).

Shpenzimet (pjesërisht) të këtij botimi-vëllimi i mbuloi autori i këtyre rreshtave, në respekt të punës dhe veprës së vlerëtë albanologjike së Injac Zamputtit.

Albert Ramaj, St. Gallen 2018.

Parathanie

Materialet dokumentare të këtyne dy vëllimeve tona, në masën ma të madhe, janë të nxjerruna nga Arkivi i Propagandës Fide dhe kanë të bajnë me aktivitetin misionar katolik në Shqipni në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të. Janë relacione e korrespondenca që niseshin asokohe nga Shqipnia në të cilat, përveç çashtjeve kishtarë, shkojnë tue u regjistruar ngjarje shumë të randësishme për historinë e vendit e të popullit tonë.

Këto materiale, përveç atyne uniteteve që kanë qenë botue ma parë nga studiozë të ndryshëm, kanë qenë transkriptue prej nesh drejtpërdrejt nga fotokopjet që Instituti ynë ka nxjerrë nga ai Arkiv.

Njihet prej të gjithëve vlera që kanë për studimet historike relacionet dhe korrespondenca e klerit misionar që Roma kishte shpërnda në të gjitha anët e botës. Randësia e materialit burimor të kësaj natyre ka qenë vu në dukje prej kohe. Mendojmë se u bajmë një shërbim lexuesve të themi këtu dy fjalë në lidhje me gjendjen e hulumtimeve dhe të botimit të tyne.

Nuk ka dyshim se Arkivi i Vatikanit dhe ai i Propaganda Fide-s kanë qenë pështetja kryesore për veprën monumentale të Farlati-Koletit "Illyricum Sacrum" dhe, për sa na intereson ne, veçanërisht vëllimi i VII-të.

Gjithashtu këto burime duhet të jenë shfrytëzue në një vepër tjetër monumentale me karakter historik-kishtar që ka për objekt, gjithmonë për pjesën që na intereson ne, misionet françeskane në Shqipni; e kemi fjalën për veprën "Orbis Seraphicus" të P. Marcelinus a Civetia dhe Domenichelli. Por, për veprën e misionarëve në Shqipni, këta autorë kanë pasë në dorë edhe burime të tjera, në radhë të parë arkivat e kuvendeve françeskane, fonde edhe këto me shumë randësi.

Disa relacione të veçueme kanë qenë botue nga studiozët në shekullin e XIX-të si edhe në të XX-in, por pa ndonjë pretendim të hulumtimit e të botimit të gjithanshëm të materialeve që i përkasin vendit tonë.

Studiuesi i njohun i dokumentave gjuhësorë të lashtë të shqipes, Mario Rok (Roques), tue u marrë me hulumtimin e materialeve për autorët tanë të vjetër, na tregon për pasuninë e vëllimeve t'Arkivit të Propaganda Fide-s në Romë, dhe na thotë se në te ai ka nxjerrë të dhana të çmueshme, megjithëse nuk ka pasë mundësinë t'i hulumtonte në mënyrë sistematike dhe të plotë. Ai shprehet kështu: "Tash asht detyra e punëtorëve shqiptarë, për të mos folë vetëm për ata, që të ndërmarrin gjurmimin metodik; ata kanë për të gjetun aty, edhe mjaft të tjerë bashkë me ta, landën për shumë vëllime Monumentash"¹.

Kështu fliste më 1932 ky studiues kur botoi fjalorin e Frang Bardhit. Në këtë botim, ashtu edhe në një botim tjetër po t'atij vjeti², Mario Rok na ka dhanë shumë shënime orientuese të vendosjes së materialeve që interesojnë Shqipninë, veçanërisht për shekullin e XVII-të.

Me sa dijmë na, dëshira e këtij studiuesi nuk ka qenë zbatue, dhe punimet për nxjerrjen në mënyrë sistematike të këtyne materialeve nuk kanë qenë ndërmarrë prej askujt. Kjo ka rrjedhë kryesisht sepse, në kohë të kalueme, përveç ndonjë privati, me mjete e me kohë të kufizueme, nuk ka pasë ndonjë interesim shtetnor për një punë të tillë.

Pak kohë ma vonë se veprat e frengut Rok doli edhe një botim tjetër i pështetun në këto materiale. E kemi fjalën për një vepër të Fulv Kordinjanos (Cordignano), që ka për qëllim paraqitjen e një gjeografie kishtarë shqiptarë; vepra asht e pasun gjithashtu me materiale dhe

¹ M. Roques Mario Roques: Le Dictionnaire albanais de 1635 etc.; Paris, Librairie Orientalist F.Geuthner, 1932, fq. 31, shën. 4.

² M.R.: Recherches sur les anciens textes albanais etc., Paris, 1932.

me shënime për vendosjen e tyne në vëllimet e arkivit të Propagandës. Por, për vetë qëllimin e këtij punimi, materialet dokumentare të sjelluna aty janë të cungueme ose të përmbledhuna³.

Në vjetin 1940, autori G. Praga, në studimin e tij: "Gjendja aktuale e studimeve shqiptare" u ban një analizë materialeve burimore të njohuna dhe të botueme deri n'atë vjet⁴. Për shekullin e XVII-të që na intereson ne, ai përmend dy relacionet e Nikollë Mekajshit (1603-1610), relacionin e Marin Bicit (1610), atë të Mariano Bolicës (1614) dhe kalon fill te relacioni i Gasparit (1671-1672) etj. Sikurse shihet, ka zbrazti të plotë për periudhën që përfshihet ndërmjet dy datave 1614-1671. Autori në fjalë nuk e njeh relacionin e Pjetër Budit të botuem shqip më 1914, as ndonjë tjetër material burimor, po të botuem, dhe që i përket kësaj periudhe.

Ndër studiuesit që, tue u pështetë në relacionet e këtij shekulli, janë mundue të ndërtojnë një kuadër të gjendjes shoqnore të Shqipnisë në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të, po përmendim Fernanda Granata-n, punimi i së cilës me titull: "Shqipnia dhe misionet italiane në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të në bazë të dokumentave të pabotuem", qe botue më 1942⁵. Me sa dijmë na, ky punim asht orvatja e parë për të dhanë një kuadër të gjendjes shoqnore për një pjesë të vendit tonë në shekullin e XVII-të. Sipas rrëfimit t'autores, burimi i vetëm i studimit kanë qenë vëllimet në dorëshkrim të P. Kamilo (Camillo) Libardit da Leviko (Levico): "Sylva documentorum ad Albaniam pertinentium", përveç dy relacioneve të njohuna të Bicit e të Bolicës. Sikurse na dëshmon autorja, "Sylva" e Libardit janë tri vëllime me dokumenta, të pregatituna për shtyp dhe, qysh n'atë vjet 1942, ishin caktue të botoheshin. Si ka vajtun fati i këtyne tri vëllimeve na nuk e dijmë. Me interes do t'ishte për ne të dinim cilat kanë qenë fondet arkivale nga të cilat e ka nxjerrë të gjithë landën Libardi, autori i "Sylva"-s. Artikullshkruesja numëron vetëm 9 relacione që ka marrë nga ato tri vëllime dhe mbi të cilat ka ndërtue trajtesën e vet. Lexuesi ynë mund t'i shikojë për cilat relacione flitet aty. Ato 9 relacione, ekstraktet e të cilave merren në studim dhe riprodhohen, janë me shumë interes por, me sa na len me kuptue shkruesja, shihet se ma të randësishmet janë të nxjerruna nga arkivi i kuvendit të Shën Mëhillit të Venedikut dhe njeni relacion nga arkivi i Bibliotekës Nazionale të Napolit. Pra, ato 9 relacione të "Sylva"-s nuk janë të nxjerruna nga vëllimet e arkivit të Propagandës. Na s'jemi në gjendje të themi për materialet e tjera të këtij koleksioni për ne të panjohun të "Sylva"-s.

Ai, që ka pasë mundësinë të përdorë gjanësisht materiale të nxjerruna nga arkivi i Propagandës, asht J. Radoniqi në veprën e tij: "Kurja romake dhe vendet jugosllave në shekujt XVI-XIX"⁶. Citatet e vazhdueshme, që ky autor bie nëpër fletët e kësaj vepre, tregojnë se janë shkue nëpër dorë vëllimet e atij arkivi. Por Radoniqi ka pasë një qëllim të caktuem në trajtimin e temës së vet. Ai pikë së pari ban një trajtesë dhe jo një botim dokumentacioni. Pastaj ai ka për qëllim të shtrojë çashtje që u përkasin vendeve sllave dhe prandej citatet e nxjerruna dhe të qituna ndër ato fletë interesojnë vetëm një pjesë të vendit e të popullit tonë.

Jemi larg prandej nga një botim i materialeve dokumentare të nxjerruna nga arkivi i Propagandës për shekullin e XVII-të në mënyrë sistematike dhe të gjithanshme. Jemi larg nga puna që duhet krye për një botim të Monumentave sikurse dëshronte dhe uronte M. Rok.

³ F. Cordignano: Geografia Ecclesiastica dell'Albania etc. në [ORIENTALIA Christiana, vol. XXXVI-4, Num. 99, Decem. 1934].

⁴ G. Praga: Stato attuale degli studi albanesi, në [RIVISTA Storica Italiana, 30.VI.1940, fq. 218].

⁵ F. Granata: L'Albania e le Missioni italiane nella prima metà del secolo XVII in base a documenti inediti, në [RIVISTA d'Albania, a. III, fasc. IV, dic. 1942, fq. 226-248].

⁶ J. Radonič: Rimska Kurija i Juhnoslovenske zemje od XVI do XIX veka, Beograd, 1950.

Kërkesat tona, gjatë këtyne vjetëve, kanë dhanë disa rezultate, por natyrisht as këto nuk mund të quhen të plota. Deri tash kërkesat i kemi përqëndruar në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të. Kështu, për një periudhë të caktuar dhe për një krahinë të Shqipnisë, d.m.th. që nga Shkumbini e deri në ekstremin verior shqiptar, mund të themi se kemi një pamje mjaft të kënaqshme. Mendojmë se, me vazhdimin e punës, mund të pasunoheshin me materiale të tilla qoftë kjo periudhë, qoftë periudhat e tjera.

* * *

Këtu na duket e nevojshme të themi arsytet pse na, në ndërtimin e këtyne dy vëllimeve, nuk jemi kufizuar vetëm në materialet e transkriptuara prej nesh dhe të pabotuara, por kemi marrë edhe disa nga botimet e bame ma parë prej të tjerëve. E kemi fjalën sidomos për relacionin e Marin Bicit më 1610, për atë të Bolicës më 1614 dhe për atë të Budit më 1621.

Relacioni i Marin Bicit, për qëllimin për të cilin u shkruar, për masat e tija dhe për çashtjet që shtrohen në të, ashtu padyshim një nga monumentet ma të çmueshme që kemi për këtë kohë. Vlera e tij njihet dhe nuk ka pasë asnjë studim që të jetë marrë me këtë shekull të historisë së Shqipnisë që mos ta ketë shfrytëzuar. Relacioni i Marin Bicit u botuar më 1886 nga historiani kroat Franc Racki në vëllimin e XX-të të STARINE-ve. Lexuesi shqiptar ka qenë vu në dijeni të këtij relacioni nga një paraqitje që bëri P. Bardhi në numrat e ndryshëm të revistës "Zani i Shna Ndout" të Shkodrës më 1917-1920 dhe vazhduar pastaj në revistën tjetër "Hylli i Dritës" më 1943. Më 1941, në këtë revistë e fundit, fq. 46-171, Filip Fishta, tue u përshtetur në leximin e dorëshkrimit origjinal, i bëri disa korrigjime kritike botimit të Rackit. Korrigjimet ma të randësishme na i kemi pasë parasysh. Studiuesi i sotëm me vështirësi mund ta ketë në dorë numrin e STARINE-ve ku u botuar relacioni i M. Bicit. Nga ana tjetër, paraqitja e botuar në gjuhën shqipe, përveç një kënaqësie të kureshtjes, nuk mund të shërbejë për bazë studimi. Për këto arsye, dhe sidomos sepse na e numërojmë relacionin e Marin Bicit si një prelud për vendosjen e misioneve të Vatikanit në Shqipëri, e përfshimë në vëllimin tonë që ka materiale kryesisht për këtë periudhë t'aktivitetit misionar.

Ma i shkurtë se relacioni i Marin Bicit, por me randësi historike aspak ma të vogël, asht relacioni i kalorësit venedikas nga Kotorri, Mariano ose Françesk Bolica. Edhe ky relacion, krahas atij të Bicit, ka për bamë kurdo një nga burimet e para për studiuesit e ndryshëm. Ky relacion, me emnin e autorit Mariano Bolica, ka qenë botuar dy heresh me ndryshime të parandësi, në shekullin e XIX-të, më 1866 nga F. Lenormant në shtojcën e librit të vet mbi Turqit dhe Malazet⁷, dhe më 1880 nga Sime Ljubic, në vëllimin e XII-të të STARINE-ve. Lexuesi shqiptar nuk e njeh në ndonjë përkthim.

Në Bibliotekën tonë Kombëtare ekziston në dorëshkrim një kopje e origjinalit që shkon me emnin e Françesk Bolicës. Kjo kopje, si e tregon letra dhe shkrimi, ka qenë nxjerrë nga një studiues i shekullit të XIX-t dhe ka qenë gjetë në Shkodër. Më si duket edhe Dora d'Istria po këtë variant, me emnin e Françesk Bolicës, ka gjetë në Arkivin e Venedikut⁸. Ky variant, me sa dijmë, s'ka qenë botuar deri më sot. Në botimin që po bëjmë, i kemi pasë parasysh të trija variantet, dhe jemi mundue të japim, me shënimet tona në vendet përkatëse, edhe ndonjë kontribut për çashtjen e autorisë së tij. Ndonse autori i tij as nuk asht një klerik, si pothuej të gjithë të tjerët, as nuk shkruen për një qëllim të dukshëm kishtar, dhe vetë relacioni na vjen nga arkivat e Venedikut dhe jo nga ata të Vatikanit, na e kemi përfshimë këtë relacion në vëllimin tonë sepse vepra e këtij

⁷ Turcs et Monténégrins par Fr. Lenormant, Paris, Didier et C. ie, 1866.

⁸ Shih shënimin 371 të tekstit origjinalit, Vëll. I, Dokum. Nr. 3.

kalorësi venedikas të Kotorrit ka qenë e lidhun ngusht me aksionin misionar në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të. Lexuesi i këtyne materialeve dokumentare do të gjejë edhe të tjera relacione e korrespondenca të këtij njeriu, të drejtueme në Romë e të gjetuna së bashku me korrespondencën e klerikëve. Relacioni i Bolicës (1614), ashtu sikurse ai i Bicit, janë paralajmuesit e aksionit misionar të Propagandës në Shqipëri.

Relacionin e Pjetër Budit të vjetit 1621 studiuesi shqiptar (po ashtu edhe të huejt) e njohën vetëm nga përkthimi që një anonim i bani në revistën e Shkodrës "PËRPARIMI" më 1914. Me gjithë kërkesat që qenë bamë pastaj n'arkivat e Venedikut, nga ishte nxjerrë origjinali italisht, nuk qe e mundun të gjendej. Një kopje e këtij relacioni gjendet e depozitueme pranë Arkivit Qëndror Historik të Tiranës. Qoftë origjinali, qoftë përkthimi i ri shqip, kanë qenë botue prej nesh më 1958⁹. Ashtu sikurse relacioni i Nikollë Mekajshit më 1610, që na nxorëm nga koleksioni i Theinerit, relacioni i Budit më 1621 dëshmon se përballë problemit të çlirimit të vendit klerikët tanë vendas u treguen përherë të gatshëm të vihen në krye të punëve.

Në përgatitjen dhe në paraqitjen e këtyne materialeve dokumentare kemi punue në bazë të disa kritereve të cilat e shohim të nevojshme t'ua themi lexuesve.

Në radhë të parë do të flasim për ato materiale që na i kemi marrë nga botimet e maparshme. Në redaktimin e tyre na jemi përshtetë mbi tekstin e botuem sepse nuk i posedojmë origjinalet në fotokopje. Gjatë procesit të punës shpesh kemi pasë rasë dyshimi rreth një terme, një emni ose një shprehje për të cilën na patëm bindjen se duhej t'ishte një gabim transkriptimi ose shtypi. Kur të mendojmë shkrimet e vështira t'origjinaleve, damtimet që ato kanë pësue nga koha, emnat e panjohun e të huej për botuesit, si edhe vështirësitë tipografike në të cilat kanë ndeshë botuesit, atëherë bindemi se lajthitjet janë të mundshme. Megjithatë, sa kohë që qemë të detyruem të punojmë vetëm përmbi ato botime, nuk patëm mundësi në rasë të dyshimta veçse të çfaqnim dyshimet tona dhe të banim shënime relative.

Kur u gjetëm përballë dy ose tri varianteve të të njëjtit dokument, si p.sh. na ngjau me relacionin e Marian ose Françesk Bolicës të vjetit 1614, atëherë bamë çdo përpjekje që të jepnim një tekst sa ma kritik që patëm mundësi.

Në lidhje me materialet dokumentare, që na kemi transkriptue nga fotokopjet e origjinaleve, kemi ndjekë kriterin t'i mbahemi besnikë tekstit tue pranue çdo grafi, të sigurtë, të pasigurtë ose edhe të gabueme që mund të kishte dhanë autori, pa prekë asnjë shenj dhe asnjë veçanti të shkrimit. Në rasë të rralla, aty ku fjala n'origjinal mund të sillte ndonjë dyshim ndër lexuesit se mos ishte lexim i gabuem prej nesh, i kemi vumë përbri një **(sic)**. Nga një herë, në të tilla rasë, kemi vumë edhe të zakonshmen (!) për t'ua tërheqë vemendjen lexuesve se e kemi lexue me kujdes. Natyrisht kjo nuk përjashton se në ndonjë rasë mundet që na vetë nuk kemi dijtë të lexojmë mirë, sepse lajthitjet janë gjithmonë të mundshme, sado kujdes që t'i vihet punës. Gabimet e vogla të dukshme nuk e pamë me udhë as t'i ndreqnim as t'i shënonim me ndonjë kllapë si u tha sipri. As kjo nuk përjashton gabimet tona dhe ato që eventualisht do të na dalin nga shtypi. Në përgjithësi lexuesi duhet të ketë parasysh se tekstet i kemi lexue me kujdes, por se gjuha, stili dhe sidomos ortografia e këtyne materialeve pasqyrojnë në përgjithësi vështirësitë ose lëkundjet karakteristike të gjuhës italishte në korrespondencën private e kancelareske si edhe shkallën e ultë t'arësimit në të cilën gjendej ky ose ai shkruer.

Shpesh herë ndodh që origjinalet janë të damtueme dhe ndonjë fjalë ose shprehje ka mbetë e copëtueme ose fare e shlyeme. Në përgjithësi, dhe me ndonjë përjashtim të parandësi, fjalët i kemi

⁹ BULETINI i Universitetit Shtetëror të Tiranës – Seria për Shkencat Shoqërore, vjeti 1958, Nr. 2, fq. 79-92.

plotësue kur kemi qenë të qartë, dhe këto pjesë të shtueme i kemi vendosë në kllapa katrore. Edhe këtu gjithashtu nuk përjashtohet ndonjë lajthitje jonë. Në lidhje me kllapat katrore, që kemi vendosë në pjesët e përkthimeve, do të vërejmë se kanë vlerë tjetër. Mbrenda këtyne kllapave, në pjesët shqipe, kemi vendosë fjalë e shprehje që nuk i ka teksti, por që na vetë i kemi shtue me qëllim që ta bajmë ma të kuptueshëm. Qoftë në tekstet e origjinaleve, qoftë në përkthimet, kudo ku na vetë nuk kemi pasë siguri leximi, kuptimi, përkthimi etj., zgjidhjen që kemi dhanë e kemi shoqnu me një pikëpyetje të vendosun në kllapë (?). Aty ku nuk kemi pasë asnjë mundësi të plotësojmë vendet e zbrazta etj. kemi vendosë një radhë pikash:

E vetmja punë, që kemi bamë në redaktimin e materialeve të transkriptueme prej nesh nga fotokopjet, ka qenë se fjalëve ua kemi zhvillue shkurtimet që përdorte grafia e kohës dhe prandaj fjalët, në këto rasë, i kemi dhanë të plota. Dhania e fjalëve të plota asht përdorë dendun nga botuesit e dokumentave të kësaj natyre. Mundësi lajthitje nuk ka, por, kur na u paraqit edhe dyshimi ma i vogël, na e lamë të paprekun fjalën. Këtu na duhet të vemë në dijeni lexuesit se na dallojmë atë që, në këto shkrime, asht shkurtim i grafisë së fjalëve nga copëtimi që u ban fjalëve në disa rasë shkruasi. Për shkurtim na kuptojmë ato trajta që e riejnë rranjën e fjalëve, ose një pjesë të saj, dhe e lidhin me mbaresën; p.sh. V're, Ves°, t'po, n'ro, Ill.mo etj. që na i zbërthejmë respektivisht: Vostre, Vescouo, tempo, nostro, Illustrissimo etj. Fjalë të copëtueme janë përkundra ato që jepen ose me një shkrojë të vetme, ose vetëm me dy-tri shkrojat e para, pa ndonjë mbaresë; p.sh. N.S., sac., V.S. etj. që na n'original i lamë të paprekuna por tue i dhanë të plota ose të zbërthyeme në përkthim kur edhe këtu nuk patëm mundësinë të lamë copëtimet pa shkaktue keqkuptim.

Në lidhje me përkthimet do të shënojmë se jemi përpjekë jo vetëm t'i qëndrojmë besnikë origjinalit, por edhe të ruenim deri ku t'ishte e mundun edhe stilin e autorit. Nuk i kemi standardizue as kristalizue disa shprehje e disa terma të cilat, nga gjuha e origjinalit, mund të sillëshin (dhe efektivisht i sollëm) ose në një formë ose në një tjetër pa ia cenuë kuptimin. Dihet se secila gjuhë ka veçoritë e veta. P.sh. fjalën possessioni disa herë e përkthijem tokë buke, disa herë vetëm tokë dhe ndonjë herë edhe prona, si na u duk ma mirë në rasë të veçanta, por që të gjitha të njëjtën gja thonë. Ka pastaj rasë sinonimie, si p.sh. dy fjalët parroco dhe curato, me gjithë ndryshimet e nuancat që mund të kenë, për rasët tona i përkthijem me të njëjtën termë: famullitar. Por nga ndonjë herë na u duk se për fjalën e dytë mund të përdornim pa keqkuptim fjalën shqipe kujdestar; kështu, rrjedhimisht, fjalën cura e përkthijem kujdestari. Në disa relacione ka shprehje që përsëriten në pambarim në formë të standardizueme; na i kemi përkthijë me forma të ndryshme, të gjitha me kuptim të barabartë, sepse s'dinim pse të zgjidhnim njenën formë ma parë se tjetrën. Kështu p.sh: frazën che la serve e përkthijem pavarësisht herë: që i shërben asaj (kishë), herë: që shërben aty (n'atë kishë). Dhe kështu me radhë, dhe lexuesi do të na falë lajthitjet të cilat aspak nuk besojmë se i kemi shmangë, me qenë se vështirësitë në disa rasë janë të pakapërcyeshme për fuqitë tona. Ne na qetëson fakti se studiuesit po i vemë para edhe tekstet origjinale dhe do të dijë t'i gjejë e t'i korrigjojë lajthitjet tona.

Dihet se ka vështirësi të mëdha t'identifikosh toponimet në disa rasë dhe t'ua vesh përbri termën që u përgjigjet sot. Disa identifikime që kanë bamë botuesit të bajnë edhe me buzëqeshë. Këto vështirësi rrjedhin: a) ose nga pasiguria grafike e shkruasit; b) ose nga evolucioni që ka bamë vetë terma; c) ose nga zhdukja dhe emigrimi i toponimave. Në pamundësi ta banim në çdo rasë identifikimin, kemi ndjekë këtë rrugë: në përkthimin shqip i japim toponimet n'ato grafi dhe n'atë interpretim si kemi arrijtë me ndihmën e hartave gjeografike ose me bibliografinë ekzistuese. Aty ku nuk dijtëm ta identifikonim, e sollëm fjalën n'atë trajtë që na u duk ma mirë për leximin shqip.

Edhe në rasët në të cilat interpretimi ynë paraqet pasiguri ose do të shkaktojë gjithnjë buzëqeshje, menduem se përpjekja jonë nuk e damton saktësimin dhe punën e matejshme që mund të bajnë studiuesit.

Po ashtu kemi veprue edhe me onomastikën të cilën po e japim të shqiptarizuese n'atë interpretim si kemi arrijtë me kërkimet tona, por gjithëmonë me rezervë dhe pa mbyllë shtegun e përsaktësimeve të matejshme.

Në lidhje me fjalët turco, greco, serbiano në përgjithësi, në këto materiale dokumentare, do të vrehmë se duhen kuptue respektivisht: mysliman, ortodoks ritit grek, ortodoks ritit sllav. Na nuk i ndryshuem këto terma në përkthim sepse vetë lexuesi e studiuesi ua heton pa vështirsi vështrimin. Vetëm në disa raste, në të cilat na u duk se ishte nevoja, ua vumë përbri, në kllapë katrore edhe fjalën shpjeguese: turk [mysliman], etj.

Në lidhje me shënimet me të cilat i kemi përcjellë këto materiale, do të vrehmë se u munduem të kufizoheshim n'ato të dhana që na u duk se vlejné për kuptimin ma të drejtë qoftë të një pjese të dokumentit, qoftë të dokumentit në tanësi. Shënimet, zakonisht, i vemë në pjesët shqipe, edhe kur i referohen tekstit origjinal. Vetëm për disa relacione, mbi të cilat kemi bamë një punë të veçantë kritike (si p.sh. relacioni i Bolicës më 1614), kemi përcjellë edhe origjinalin me shënimet relative¹⁰.

Për sa i përket terminologjisë specifike kishtarë dhe ndonjë elementi tjetër, na aty-këtu i kemi dhanë shpjegimet ndër shënime, por në përgjithësi, termat që përsëriten dendun, i kemi lanë të pa shpjegueme në të gjitha rasët, dhe lexuesin e drejtojmë te fjalorthi që na do të vendosim në fund të vëllimit të II-të.

Sikurse do të shihet në vendet përkatëse, landën e re që na kemi transkriptue nga fotokopjet, e kemi nxjerrë nga Arkivi i Propagandës Fide në fondet SRCG dhe Vis. e Coll. dhe vetëm në disa vëllime të tyne. Vepra e hulumtimit n'ato fonde duhet vazhdue.

¹⁰ Shënimet e origjinalit janë vendosur në pjesën e përkthyer me shkronja kursive – J. Z.

SHËNIME MBI RANDËSINË E RELACIONEVE SI BURIM PËR HISTORINË E VENDIT TONË

Materialet dokumentare të dy vëllimeve tona interesojnë gjysmën e parë të shekullit të XVII-të. Kjo kohë, për historinë e popullit dhe të vendit tonë, asht periudha kur lufta ma shumë se njëqindvjeçare e shqiptarëve kundër pushtimit turk kishte arritë kulmin. Kryengritjet e shpeshta të shqiptarëve u kishin shkaktue vështirësi të mëdha sundimtarëve dhe, nga ana tjetër, kishin tërheqë vemendjen e fuqive evropiane dhe përbanin një peshë të randësishme në planet e tyre për zhvillimin e luftës kundër Turqisë. Nga ana tjetër, këto kryengritje kishin sjellë një ringjallje në popullsitë tona, tue mbajtë të gjallë dashuninë për vend e për liri e tue mbajtë lidhje të pakëputun me kohën e lavdishme të luftave të kohës së Skanderbeut. Tridhetëvjetori i fundit i shekullit të XVI-të si edhe dhetëvjetori i parë i shekullit të XVII-të shënuen lulëzimin ma të madh të përpjekjeve shqiptare për liri.

Pas ramjes së Shkodrës dhe pas pushtimit të bregdetit himariot (1479), turqit mundën ma në fund të vendosnin pushtimin dhe sundimin feudal-ushtarak mbi të gjithë Shqipninë. Qëndresa e armatosun e shqiptarëve nuk u shue, por u kufizue në zonat malore të vendit. Këtu popullsitë shqiptare qëndruen pa iu shtrëue plotësisht shfrytëzimit feudal turk; u mbajtën me kanunet e veta tradicionale dhe, kohë pas kohe – në bashkëpunim edhe me fshatarësinë e fushës dhe në koordinim me luftat evropiane kundër Turqisë – organizuen lëvizje të gjana që synonin dëbimin e turqve nga i gjithë vendi.

Zona malore e Shqipnisë së Mesme, gjatë kohës së pushtimit turk, deri aty nga mesi i shekullit të XVII-të, ka qenë një nga qëndrat ma të randësishme të qëndresës s'armatosun dhe të lëvizjeve shqiptare për çlirimin e vendit. Në këtë zonë u organizuen në shekujt XV-XVII lëvizje t'armatosuna të cilat, në disa etape, morën edhe karakter panshqiptar. Në zonën malore të Shqipnisë së Mesme piqeshin zonat tjera periferike ku ishin krijuë gjithashtu vatra të qëndresës shqiptare: këtu takohej me zonat malore të Shqipnisë Lindore vargu i popullsive të lira malore që nisej nga Malet e Veriut, zbriste nëpër Pult, kalonte Drinin dhe kapej nëpër Dukagjin deri në zemrën e Matit, dhe këtu mbaheshin lidhjet edhe me popullsinë malore të jugut të Vlonës, me Himarën heroike. Nuk duhet qitë në harresë se Shqipnia e Mesme ka qenë qëndra e principatës së Kastriotëve. Në kalim prej shekullit të XVI-të në të XVII-tin, në këtë zonë u zhvilluen kuvende panshqiptare në të cilat krenët e lëvizjeve hartuen projekte për një luftë të përgjithshme shqiptare dhe ballkanike.¹

Por pikërisht vjeti 1610 shënon një kthesë të randësishme për fatet e zhvillimit të matejshëm të këtyne përpjekjeve. Në këtë vjet, turqit, tue vazhduë përpjekjet e veta shekullore për copëtimin e Shqipnisë, mujtën ma në fund të thenin unitetin e madh malor të Dukagjinit, që deri në këtë kohë shtrihej pa ndërpreme, tue u nisë nga bregu i majtë i Drinit në kthesën e tij ma veriore, dhe arrinte deri në luginën e Matit. Ky unitet malor, me fate të ndryshme, kish qëndruë me armë në dorë kundër çdo përpjekje të feudaleve për të depërtue sidomos në luginën e Drinit që asht rruga e natyrshme për Kosovë. Prej vjetit 1610 e tëhu, mbasi qe

¹ I. Z. – Projektet shqiptare për çlirimin e vendit drejtue Evropës në vjetët 1577-1621, në [BULETINI për Shk. Shoq., 1956, Nr. 4].

rindërtue Qytezja e Re në zemër të kësaj zone, lugina mbeti e kontrollueme nga feudalët turq. Jo se u shue lufta e rezistencës kundër vendosjes së regjimit feudal, por fakti asht se tash e tëhu vetëm disa zona të veçueme të Dukagjinit e vazhdojnë këtë luftë t'armatosun dhe jo ma si unitet i madh i së kaluemes. Ky unitet i madh qe nda n'unitete ma të vogla territoriale në jug të luginës së Drinit.

Në dhetëvjeterin e parë të shekullit të XVII-të, kur turqit po copëtonin unitetin e Dukagjinit, doli në skenën politike dhe mori në dorë flamurin e luftës një tjetër unitet i madh malor, që përfshinte malësinë në Veri të Drinit dhe që u quejt "Malet Shqiptare".²

Qysh prej kohësh ishte formue bindja se lufta ishte punë jo vetëm e një krahine, por e gjithë vendit. Pikërisht për bashkimin e të gjitha zonave të qëndresës shqiptare ishin zhvillue në kalim prej shekullit të XVI-të në të XVII-tin kuvendet panshqiptare që thamë ma nalt. Në këto kuvende kishin marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha zonave të rezistencës. Na mund të përmendim sidomos kuvendin e Shën Mërisë së Matit më 7 nandor 1594 dhe atë të Shën Llezhdrit të Dukagjinit në vjetët 1601-1602.

Në të gjitha projektet që dolën nga kuvendet shqiptare, u muer parasysh fakti se lufta për çlirim do të përhapej në të gjithë Ballkanin, në një bashkëpunim të ngushtë të luftarëve shqiptarë me popullsitë sllave të pushtueme.

Prandej në fillim të shekullit të XVII-të krenët e lëvizjeve tona organizuen takime dhe morën pjesë në kuvendet ndërballkanike: më 1614 u zhvilluen dy seancat e kuvendit të Kuçit në Malet Shqiptare; më 1616 u mbajt kuvendi i Prokopjes në Serbi dhe më 1620 në Belgrad, ku krenët shqiptarë u ulën dhe biseduen krah për krah me krenët boshnjakë, serbë, malazez, hercegovinas, maqedonas e bullgarë.

Projektet, që dilnin nga kuvendet shqiptare ose nga ato ballkaniket, dërgoheshin nëpër oborret e Evropës për të gjetë zbatim, tue i kombinue me organizimin e ekspeditave që princat e ndryshëm donin të ndërmerren për të dalë në Ballkan. Aty-këtu pati edhe ndonjë mirëpritje dhe u banë premtime për ndihma e për një aksion të përbashkët. Por konfliktet evropiane ndërkaq ishin bamë të pashërueshme, dhe popullsitë tona nuk përfituen asgja nga premtimet e thata.

Gjysma e parë e shekullit të XVII-të shënon për Evropën shpërthimin e luftës së tridhetë vjetëve që do të marrë fund me paqen e Vestfaljes më 1648. Gjatë kësaj lufte, e cila veç tjerash do të shënojë edhe ramjen e Papatit nga pozita që kish fitue në mesjetë si fuqi botnore, Vatikani, për të vu në vend humbjet e pësue me në vise të ndryshme, themeloi Kongregacionin e Propagandës (1622). Me këtë institucion Roma, e detyrueme të lëshojë terren në vendet veriore t'Evropës, mori në dorë jo vetëm shtrimjen e influencës së vet në vendet e kolonizueme pas zbulimeve gjeografike të shekujve XV-XVI, por edhe luftën kundër islamizimit në vendet e pushtueme prej perandorisë osmane.

Për kuptimin e drejtë të materialeve dokumentare të vëllimeve tona, asht e nevojshme prandej të merren parasysh etapet dhe taktikat e këtij aksioni që zhvilloi Vatikani në vendin tonë:

1) Etapa e parë: asht periudha përgatitore për veprimin e ardhshëm të Kongregacionit të Propagandës. Na kemi bindjen se relacioni i Marin Bicit më 1610 dhe ai i Bolicës më 1614 janë paralajmuesit e këtij veprimi. Në këto dy relacione e kemi paraqitun pëllamë për pëllamë terrenin ku do të zhvillohet veprimi misionar si edhe shoqinë shqiptare, në gjendjen e saj

² I. Z. – Bashkimi i Maleve Shqiptare në fillim të shek. XVII, në [BULETINI etj., 1957, Nr. 3 (1), fq. 63-94].

ekonomike e politike mbi të cilën do të zhvillohet ai veprim. Krahas tyne qëndron edhe relacioni i Gjec Bardhit mbi gjendjen kishtare të Zadrimës më 1621, që na paraqet njeën nga krahinat ma të randësishme, bile krahinën kryesore, në të cilën u themeluen ma vonë misionet françeskane (Vëll.I, Dokum. 2, 3, 4). Së bashku me këto tri relacione, dy letrat-projekte të Mekajshit dhe të Budit janë dëshmitare se, në këtë periudhë, për luftën e shqiptarëve që synonte çlirimin e vendit, vazhdon të merret Vatikani në suazën e koalicionit evropian, por janë dëshmitare gjithashtu se popullsitë tona vazhdonin përpjekjet për koordinimin e luftës së vet me planet e luftës së përgjithshme kundër Turqisë.

2) Më 1622 u themelue pra Kongregacioni i Propagandës dhe, që prej kësaj kohe, veprimi i klerit katolik në vendet e misioneve merret në dorë nga ai. Tash e tēhu relacionet dhe korrespondenca bahen të denduna, sepse Kongregacioni kërkonte përpikni në dhanien e informatave të cilësdo natyrë.

3) Më 1634 u themeluen misionet françeskane në Shqipni. Ardhja e këtyne misionarëve të huej, si edhe vendosja e disa misionarëve vendas që kthenin nga kolegjet e Italisë dhe mbaheshin me subsidet (rrogat) vjetore prej Kongregacionit, asht një shkak tjetër që shumësoi dërgimin e relacioneve dhe të korrespondencës në Romë, sepse dërgimi i subsidëve ishte i lidhun ngusht me redaktimin e rregullt të relacioneve.

Përveç prelatëve që ishin në krye të dioçezeve, përveç misionarëve që dërgonin në Romë çdo informatë me randësi, kohë pas kohe qenë nisë në vendin tonë edhe vizitatorë ose inspektues apostolikë me detyrën e një inspektimi të përgjithshëm. Krahas vizitatorëve, qenë ngarkue për ndonjë rasë të veçantë edhe disa komisarë ose të deleguem, si qe p.sh. rasa e grindjes për jurisdiksionin kishtar.

Dhe tash t'u hedhim një sy rrugëve që ndoq Vatikani për të zhvillue veprimin e vet në vendin tonë, qoftë me synim të zhvillimit të luftës kundër Turqisë, qoftë me synim të rivendosjes së pronës kishtare të shkatërrueme.

Në kalimin prej shekullit të XVI-të në të XVII-tin, Vatikani kish veprue edhe në Shqipni, sikurse gjetiu, tue u pështetë në koalicionin evropian që ishte nën hegjemoninë e Spanjës, mbreti i së cilës cilësohej me atributin "katoliku". Kleri shqiptar në përgjithësi, ashtu edhe si shumë krenë të tjerë të lëvizjeve, kishte marrë anën e këtij koalicioni. Krenët dhe kleri përpiqeshin ta fusnin gatishmërinë e popullsisë tona për luftë në kuadrin e këtij koalicioni evropian. Bashkëpunimi me këtë koalicion paraqiste rrugën ma të drejtë, aq ma tepër sepse lëvizjeve tona t'armatosuna, veç ndihmave materiale, u nevojitej edhe një pështetje e fortë në një kohë kur dihej qëndrimi anmiqsor i Republikës së Venedikut kundrejt tyne. Edhe projekti i Nikollë Mekajshit më 1610, edhe ai i Pjetër Budit më 1621, janë shtrur në suazën e këtij koalicioni.

Evropa kristiane pati interes në çdo kohë të sigurate krahun e shqiptarëve që qëndronin me armë në dorë në zonat malore. Vatikani, tue e dendësue veprimin misionar në shekullin e XVII-të, synoi t'ia sigurate koalicionit këtë forcë të madhe luftarake, në mos në mënyrë aktive tue zbatue projektet e luftës çlirimtare, së paku tue mos e lanë të merrte anën e turqve. Për këtë arësyë edhe prelatët shqiptarë çuen zanin dhe kërkuen interesim për këto popullsi: për t'i mbajtë të gatshme në mprojtjen e Evropës ata kërkuen sidomos të hapeshin shkolla për rritjen e klerit vendas që do të punonte për t'i rrujtë popullsitë në kristianizëm dhe rrjedhimisht të lidhuna me luftën kundër Turqisë. Turqit, thotë relatori Pjetër Mazrreku, kur flet për malësorët shqiptarë, "tash 30 vjetë e këndeje kanë nisë ta shtypin ma shumë këtë komb se sa [kombet] tjera, tue i tërheqë [malësorët shqiptarë] edhe në sektin muhamedan, ndoshta për

ndonjë shestim politik". Prandej, vazhdon relatori n'atë relacion të vjetit 1633, i duhet dhanë ndihmë popullit shqiptar me shkolla e me mjete të tjera, për ta mbajtur në besimin e krishtenë "sepse, ashtu sikurse, sa të jenë të krishtenë, mund t'ishin shumë të vlefshëm në rasë të ndonjë ndërmarrje lufte, ashtu, po të bahen myslimanë, do t'ishin për dam shumë të madh të krishtenimit, për të mos thanë të vetë Italisë, mbasi asgja s'ka ndërmjet veçse pak det që e ndan Shqipninë nga Italia" (Vëll. I, Dokum. Nr. 37, fl. 274).

Kështu, në sintezën ma të qartën, shprehet veprimi politik turk e kristian në terrenin e besimit për të sigurue krahun e luftarëve shqiptarë.

Por, krahas këtij veprimi politik, Vatikani synonte njëkohësisht edhe rimëkambjen e kishëve në Shqipni, së bashku me fuqinë e tyne ekonomike, për të fitue pozitat e privilegueme që dikur kishte pasë kisha dhe që kishin humbë nga shkaku i shkatërrimit dhe rrenimit që pësoi me pushtimin turk të vendit.

Ky veprim nuk mund të zhvillohej me luftë t'armatosun, por në një rrugë të qetë e paqësore; për këtë duhej sigurue toleranca e autoriteteve turke në vend, dhe kjo tolerancë kishte vetëm një rrugë: bashkëpunimin e klerit me venedikasit me të cilët turqit ishin në raporte miqësore që më 1574. Kështu Vatikani, megjithësi vazhdoi bashkëpunimin me spanjolët në frontin e luftës s'armatosun (dhe disa klerikë që u dërguen në vendin tonë qenë persekutue si agjentë të Spanjës), nga ana tjetër bashkëpunoi me venedikasit në frontin e penetrimit paqësor. Na mund të sigurohemi për këtë, veç tjerash, me këto dy copëza që po nxjerrim nga relacioni i Marin Bicit: Kadiu i Tivarit "më thonte të shkoja [në Tivar] kur të doja, sepse sulltani më numuronte për besnik e sidomos sepse unë isha nënshtetas i zotnijve venedikas" (Vëll. I, Dokum. Nr. 2, fq. 65), dhe: "Isuf beu, sanxhakbei i Shkodrës, që aso kohe qeveriste të gjitha ato vende, mbasi më njohu për nënshtetas të Republikës së Venedikut, më numuroi si besnik të vetin ..." (Po aty, fq. 66-67). Në kuadrin e bashkëpunimit të Vatikanit me Venedik, në këtë veprim, hyn edhe vepra e kotorrasit, Françesk Bolicës, kalorës venedikas, që na do ta njohim ma mirë nga relacionet dhe korrespondenca e tij të kësaj kohe.

Megjithatë, deri më 1634, vjet në të cilin u themeluen misionet françeskane në Shqipni, bashkëpunimi me venedikasit qe i rasëshëm. Pas vjetit 1634, gjendja e misioneve në veçanti dhe e kishës katolike në Shqipni përgjithësisht asht e qetë deri më 1644, kur nis lufta veneto-turke që zgjati deri më 1669. Gjatë kohës së qetësisë, u ripërtërinë shumë prona të kishëve famullitare e ipeshkvnore, u rregulluen detyrimet e besimtarëve ndaj klerit. Në këtë rrugë u ngjallën edhe shumë grindje e konflikte midis titullarëve të dioçezeve e të famullive për të sigurue secili për vehte t'ardhuna sa ma të mëdha e ma të sigurta. Disa nga këto aspekte na do t'i analizojmë këtu ma poshtë. Do të shënojmë veç, se në këtë konflikt për jurisdikcion, ndërhyen shpesh edhe konflikti i vjetër midis klerit vendas dhe klerit të huej. Ky i fundit, pikërisht tue synue përvetsimin e privilegjeve ma të majme, përçmonte klerin shqiptar dhe shpifte mbi te në njëmijë mënyrë. Për këtë konflikt na do të flasim ma tutje, kur të shtrojmë disa çashtje të lidhuna me kombësinë. Në çdo kohë kleri shqiptar e ka çue zanin kundër klerikëve të huej që dërgonte Roma në postet ma të mira në krye të dioçezeve dhe t'abacive të vendit, sepse ata vinin vetëm për të mbledhë t'ardhunat nga kishët e manastiret dhe pastaj shkonin dhe i hanin me familjet e veta sidomos në qytetet dalmatine. Në materialet tona dokumentare do të ndeshemi në këtë konflikt kamba-kambës: ose kur ipeshkvi i Shkodrës, i hueji DomenikoAndreas, do të na flasë për rrjedhimet e sinodit që kish bamë Pjetër Budi për të mos pranue ipeshkvij të huej, ose kur dalmatini Benedikt Orsini, për të sigurue për vehte sa ma shumë t'ardhuna, shkakton konfliktet për jurisdikcionin kishtar në të katër anët e dioçezit

të vet të Lezhës në grindje me dioçezet kufitare. Edhe misionarët, të cilët në fillim erdhën të mirëpritur, gjetën pastaj kundërshtim e luftë në klerin vendas, sepse popullsitë tona të vorfna nuk qenë në gjendje dhe refuzonin të paguenin detyrimet e kishëve famullitare kur qenë të detyrueme t'ushqenin edhe misionarët: ose famullitarit, thonin besimtarët, ose misionarëve, por edhe këtyne edhe atij, jo. Përbalë një qëndrimi të tillë, kleri vendoste sanksione mbi besimtarët, dhe një nga sanksionet ka qenë edhe të lesheshin besimtarët pa shërbimin shpirtnor. Kur malësorët e Pukës ia mohojnë detyrimin famullitarit të tyre, sepse ai nuk qëndron në famulli ku janë vendosë misionarët që mbahen me ushqim nga populli, atëherë "imzoti i Zadrimës ka urdhënue që derisa mos t'ia japin të dhetën priftit, as prift as frat mos të qëndrojnë pranë tyre as mos t'u jepen sakramendet" (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 95).

Nuk ka dyshim se në lidhje me përvetsimin e t'ardhunave sa ma të majme, konflikti u zhvillue edhe ndërmjet vetë klerit vendas, por ashpërsimi ma i madh qe me të huejt, sepse aty ndërhyenin edhe elemente të tjera, sikurse do të shohim ma tutje. Në të gjitha larmitë e këtij konflikti hyjnë natyrisht edhe përpjekjet e fshatarëve për t'u lehtësue nga detyrimet, përpjekjet e sundimtarëve dhe të feudalëve për të nxjerrë përfitime tue ndërhy për zgjidhjen e konflikteve etj.

Na do të shënojmë se, për sa i përket administratës kishtare, kleri katolik zyrtarisht kishte liri të plotë veprimi. Ai njihte autoritetin vendas dhe, me forma të ndryshme dhuratash e shpërblimesh, mbante lidhje me feudalët e fuqishëm dhe siguronte përkrahjen e tyre. Kështu vërtetohen shumë rasë ndërhyrje të feudalëve, qoftë për zgjidhjen e disa çashtjeve besimtare ose juridiksionale që interesojnë disa persona (fetarë ose laikë), qoftë kur midis vetë klerit ka grindje. Ndihma që kërkonin t'interesuemit prej feudalëve vendas ka qenë shoqnie me pagesa të randa. Në këtë praktikë na hetojmë se regjimi i shfrytëzimit feudal kishte gjetë edhe këtë rrugë të veçantë përfitimi dhe shpërdorimi. Kur p.sh. konflikti midis ipeshkvit të Lezhës dhe arqipeshkvit të Tivarit kishte arritë kulmin për çashtjen e juridiksionit të kishës së Barbullushit, u ba një takim i këtyne dy prelatëve po n'atë fshat, tue qenë ndërmjetës e arbitër misionari Kerubino. Ishte dita e festës s'asaj kishe, dhe populli kishte ardhë me shumicë dhe po priste si do të përfundonte grindja: "ishte aty edhe Mema zot dhe Omer aga, zotnij me shumë turq të tjerë, të cilët kishin ardhë si njeni si tjetri për të pa çka po ngjiste dhe për të mbajtë krah sepse u kishin bamë dhurata njeni njenit dhe tjetri tjetrit për të qenë ndihmue. Por ata turq ishin marrë vesh: kap ti se po kapi edhe unë" (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 99-99v).

Kush e ndiente ma keq peshën e këtyne konflikteve ishte fshatarësia që ngarkohej me detyrime. Në këtë rrugë shfrytëzimi e pasunimi ishte krijue edhe zakoni i dënuem që ipeshkvi i vendit të shënonte famullitë tue u marrë një shpërblim famullitarëve. Ky zakon, që konsiderohet *simoni*, ka qenë një tjetër plagë që ushqi të tilla konflikte. Në këtë mes, shpesh herë hetohet mosbindja e fshatarësisë për të mos ia dhanë klerit disa detyrime të tepërta, si ndodhi në Zadrimë pas vdekjes së Frang Bardhit, kur ungji i tij, Gjergj Bardhi, deshi të mblidhte detyrimet ipeshkvnore (Vëll. II, Dokum. Nr. 43, 45).

Për rivendosjen e autoritetit kishtar mbi besimtarët, prelatët dhe sidomos misionarët kërkuen prandej një nënshtrim të besimtarëve ndaj gjendjes në të cilën tashma duhej të jetonin: sapo arriti në Tivar, Marin Bici ia nisi predikimeve në kishë, sikurse kishte veprue ma parë në Budue (ku sundonin venedikasit), por tivarasve u shton diçka tjetër: "i drejtova fjalën popullit, ashtu si në Budue, tue shtue nxitjen që ta barin me duresë robninë në të cilën ai kishte ra ..." (Vëll. I, Dokum. Nr. 2, fq. 66). Dhe po ky prelat pastaj, në zemër të zonës fushore shqiptare, detyroi besimtarët t'ia paguenin gjobat për çashtje besimi beut të Rodonit i cili e

kishte përkrahë dhe e përkrahte në veprën kishtare. Kështu edhe misionarët, të pështetun e të porositun nga zyrtari venedikas i Kotorrit, predikonin qetësinë, nënshtrimin dhe bindjen për të pague haraçin e detyrimet tjera ndaj feudalëve. Ata bile kërkonin të pushonte krejtësisht lufta e rezistencës në zonat e lira malore, sepse luftat e mosbindja e malësorëve u shkaktonin randim dhe persekutim edhe zonave fushore që mbanin lidhje me malet: “Njëmijë herë do t’ishite ma mirë me u përlulë, me pague ndopak haraç e me jetue krishtenisht”, shkruente më 1638 fra Kerubino pikërisht për malësorët tanë që n’atë vjetë kishin thye ushtritë e Vuço Pashës në Kelmend (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 95v). Misionarët merrnin letra porosie nga sundimtarët turq për të mos qenë pengue në ushtrimin e misionit. Këto letra u lëshoheshin atyne nga pashallarët e bejlerët turq me ndërhyrjen dhe porosinë e venedikasve të cilët baheshin dorëzanë faqe turqve për misionarët. Turqit, thotë kalorsi Bolica, “menduen ... t’u lejohet etënve misionarë të hyjnë ndër hospicet e tyne të maparshme dhe të ndihmohen, por tue u detyrue unë se ata [misionarët] nuk do të merren me punë të tjera” (Vëll. II, Dokum. Nr. 79, fl. 59).

Klasa feudale turke, tue pa se kleri dhe misionarët predikonin bindjen dhe se po rivendosnin sistemin e detyrimeve kishtare, shikoi tek ata aleatët e vet, sepse në këtë mënyrë merrnin edhe vulën e përligjes besimtare detyrimet që fshatarësia kishte ndaj feudalëve.

Në goftë se në lamën e luftës s’armatosun politika dhe aksioni i Vatikanit në Shqipni, në kuadrin e koalicionit evropian, kontribuoi të zgjaste rezistencën e popullsisë që rënkonin nën pushtimin turk, nga ana tjetër, në direktivat e dhana për rimëkambjen e pronës dhe të detyrimeve ndaj kishëve, me predikimin e nënshtrimit ndaj gjendjes dhe me bashkëpunimin me feudalët, politika e Vatikanit nuk qe e favorshme. Kjo politikë bani që prelatët (dhe jo vetëm të huejt) t’ishin aleatët e feudalëve dhe, ma në fund, ata vetë synuen krijimin e feudeve të reja kishtare dhe sigurimin e titujve feudalë në suazën e pushtimit turk: kjo na dëshmohet qartë nga prona e madhe e arqipeshkvit të Durrësit, Gerard Gallatës, në gjysmën e dytë të shekullit të XVII-të, dhe nga titulli i tij: Princi i Kurbinut.

Një tjetër rrymë e damshme, sidomos në veprën e misionarëve të huej, ka qenë përpjekja për t’u zbatue në terrenin shoqnor shkëputja e plotë e marrëdhanieve midis elementëve besimesh të ndryshme por që ishin të një kombësie e të një vendi. Për misionarët çdo e keqe që kishte ndër të krishtenët: bestytni, shregullime në martesat, kamatat etj. i detyrohej bashkëjetesës që ata banin me myslimanët ose me ortodoksit. Por jeta e përditshme që ndiqte rrjedhën e vet pavarësisht nga ato pikëpamje, ua kish hapë sytë klerikëve vendas që danin me fshatarët të mirën e të keqen. Kleri i ultë sidomos edhe çashtjet doktrinale të besimit ua kish përshtatë kushteve konkrete të jetesës së përditshme. Ata e shihnin me sy se n’atë gjendje bashkëjetesa me elementë besimesh të ndryshme ishte një gja krejt normale dhe nuk kishte shkaktue ndonjë ndryshim në marrëdhانيت shoqnore. Kjo kuptohet kur të kemi parasysh se edhe vetë një familje ishte e përbame me pjesëtarë të krishtenë e myslimanë. Kjo bashkëjetesë nuk kishte si të zhdukej dhe klerikët vendas kërkonin edhe disa rrugë kundër normave besimtare katolike për ta legalizue: si ai prifti që kungonte myslimanët me oste të pashugurueme etj. Kjo përpjekje hetohet edhe në relacionet e prelatëve të cilët, përballë disa problemeve që nuk mund t’i zgjidhnin me normat e kishës katolike, rrjeshtonin një seri çashtjesh specifike dhe kërkonin nga Roma udhëzime se si të vepronin: kështu kërkesat për zgjidhjen e çashtjes së martesave mikste, për dhanien e sakramendeve myslimanëve që i kërkonin etj. Tue folë për gratë e krishtena që janë martue me myslimanë dhe megjithatë kërkojnë të marrin sakramendet në kishë, Frang Bardhi i shkruen Kongregacionit më 1637: “...

po bij ndër kambë me përvujtninë ma të madhe, së bashku me këto të krishtena të shkreta, gra të turqve, dhe po e lus lumëninë e tij [Papën] të denjohet të zgjidhë e të lejojë që të munden me marrë sakramendet e shenjta, me qenë se kjo martesë deri tash asht bamë përdhuni e nga padija” (Vëll. II, Dokum. Nr. 24, fl. 199). Kjo punë që ban kleri vendas shkaktonte skandal në të huejt. I peshkvijt e vendit, thotë relatori dalmatin, Françesk Leonardis, më 1638, i lejojnë vehtes shumë punë jashtë mase dhe “nxjerrin përfundime në praktikë, jo vetëm të gabueme e skandaloze, por disa herë edhe kundra besimit” tue lejue martesë të paligjshme etj. Dhe relatori vazhdon tue numëruet aktet e paligjshme në shumë fusha (Vëll. II, Dokum. Nr. 33, fq. 278/54). Tue u krenue për veprën e vet misionare dhe tue qitë në dritë se si ai dhe shokët e vet po zbatonin doktrinën e krishtenë, fra Kerubino padit klerin vendas që nuk i ka zbatue mësimet e doktrinës, dhe këtë vrejti ue ven në gojë fshatarëve e malësorëve tanë, të cilët thonë: “Si? Përherë kanë qenë ndër ne ipeshkvijt dhe priftën e nuk na i kanë thanë keto sende as nuk na kanë shtërngue kaq fort sa ju, bile na kanë lejue shumë sende” (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 92v).

Lexusi i këtyne materialeve do të ndeshet në përpjekjet që bajnë klerikët për të gjetë rrugën se si me përligjë bashkëjetesën në kushtet konkrete në të cilat gjendeshin besimtarët katolikë. Ne na mjafton të përmendim se qenë dy prelatë shqiptarë që nuk u topitën në projektet e veta drejtue Papës, ta thonin shkoqun se për luftën çlirimtare shqiptarët ishin të bashkuem pavarësisht nga besimi dhe se jo vetëm ortodoksit do të bashkëpunonin me katolikët, por edhe myslimanët e vendit, disa prej të cilëve ishin edhe farefis i vetë prelatëve që shkruajnë të tilla projekte (Vëll. I, Dokum. Nr. 1 dhe Nr. 5).

Në shekullin e XVII-të, sidomos me themelimin e misioneve, Propaganda e dendësoi dhanien e subsidive ose rrogave klerit shekullar dhe rregulltar. Në materialet tona dokumentare hetohet përpjekja e të gjithëve për të sigurue subsidin për vehte e sa ma të madh. Për të kuptue çashtjen e subsidive në përgjithësi dhe rrjedhimet e damshme që solli një praktikë e tillë mendojmë se asht e nevojshme t’i bajmë një analizë çashtjes ekonomike të kishës katolike në Shqipni në shekullin e XVII-të.

Me pushtimin e vendeve tona nga Turqia kisha katolike u gjet pa një organ qëndror mbrenda perandorisë, ashtu sikurse e pati kisha ortodokse Patrikanën në Stamboll. Kishët dhe pronat kishitare katolike pësuen një rrenim ma të madh se sa pësuen kishët dhe pronat kishitare ortodokse. Kjo u ndodhi kishëve katolike në Shqipni edhe nga fakti se popullsitë tona, edhe kur u shtruen nën regjimin e timarit, vazhduen marrëdhانيت dhe morën pjesë në përpjekjet për çlirim që u organizuen në vatrat e rezistencës. Për këtë arsye, kohë pas kohe, kishët dhe komunitetet katolike pësuen, në Shqipninë e Veriut dhe në Shqipninë e Mesme, edhe presionet ma të randa nga ana e feudalëve dhe ekspeditave turke. Në këto rasë ngjishnin edhe rrenime të matejshme të kishëve dhe grabitje në pronat e tyne të dikurshme. Edhe paksimi gradual i popullsisë besimtare që islamizohej, edhe paksimi i klerit që shkaktoi braktisjen e kishëve, kontribuen për ramjen e kishëve dhe përvetsimin e pronave të tyne, qoftë nga vetë besimtarët, qoftë nga të tjerët.

Në historinë kishitare katolike të shekullit të XVII-të në Shqipni, me dendësimin e veprës së Propagandës, vihen re disa fenomene të reja në lidhje me pronën e kishëve dhe me gjendjen ekonomike të klerit.

a) Pasunitë minimale që kishin mbetë ndër kishët shkojnë gradualisht tue u rritë me anë blemjesh dhe sidomos me anë dhuratash që banin besimtarët. Në këtë kohë u nxit kjo praktikë që ka dhanë kurdo fryt shumë të mirë: “Me nxitjen e ipeshkvijt e të priftëve – thotë

Frang Bardhi për Zadrimën më 1641 – çdo vjet, ata që janë tue vdekë, shkojnë tue u lanë diçka kishëve: kush vneshta, kush ara, kush meshë [lexo: të holla për thanien e meshëve – I.Z.], dhe gratë sofrabeza e këmisha ...” (Vëll. II, Dokum. Nr. 35, fl. 167v). Në fermanin që lëshon Sulltani më 20 Xhemal ahâr 1018 (1610) për ushtrimin e lirë të zyrës arqipeshkvnore të Marin Bicit në dioçezet e Shqipnisë, thuhet edhe: “Dhe çdo gja që fetarët kur vdesin ua lanë me testament të vobektëve të kishës, sipas ritit e zakoneve, të pranohet e t’aprovohet, dhe asgja mos të pengohet” (Vëll. I, Dokum. Nr. 2, fq. 64). Edhe për ndërtimin e shtëpive të famullitarëve e t’ipeshkvijve shtihet në punë ndihma e besimtarëve. Kur Frang Bardhi tregon se paraardhësi i tij në dioçezin e Sapës ka ndërtue dy shtëpi për selinë ipeshkvnore, e sheh t’udhës të shtojë: “por me ndihmën e shpenzimeve e të mundit të popullit të Zadrimës” (Vëll. II, Dokum. Nr. 35, fl. 157v). Shumë prona të kishëve, sikurse thamë, i kishin shti në dorë vetë besimtarët kur fshati kish mbetë pa prift ose kur prifti i vdekun kishte lanë trashëgimtarë. Në Hot, më 1634, Gjergj Bardhi gjen se pronat e kishës “i kishin shtimë në dorë disa bij të një farë prifti të vdekun që u kish lanë në trashëgim pasunitë e kishës. Tash asht e vështirë me ua heqë duersh me që ata ka shumë kohë që i zotnojnë” (Vëll. I, Dokum. Nr. 39, fl. 66). Megjithatë ky asht një përjashtim: si rregull na do të hetojmë në materialet tona dokumentare se jo vetëm besimtarët katolikë detyrohen t’i kthejnë ose t’i shpërblejnë pronat e përvetsueme të kishëve, por edhe vetë fshatarët myslimanë. Tue përshkrue e tue llogaritë pasunitë e kishës abaciale të Kabashit të Pukës, Frang Bardhi, më 1637, shkruen: “Këto i kishin pushtue të krishtenët dhe turqit [lexo: myslimanët – I.Z.] dhe tash, tue veprue me zell, ua kam heqë duerve të tyne, dhe kështu i gëzon kisha dhe famullitari” (Vëll. II, Dokum. Nr. 24, fl. 195v).

b) Rritja, sado e ngadalshme dhe graduale, e pasunive kishtare ua shtoi t’ardhunat klerikëve që gëzonin privilegjet në vend, dhe pak nga pak shkuen tue u fuqizue ekonomikisht, derisa arrijmë pastaj te pronat e mëdha e te titulli feudal i arqipeshkvit të Durrësit, si thamë ma parë.

c) Megjithatë, na duhet të shënojmë se as në shekullin e XVII-të, as n’ata të pastajmit, nuk ndeshemi në ndonjë formë tributi që kleri katolik i Shqipnisë i detyron Romës. Kjo duhet spjegue me faktin se pronat e kishëve dhe detyrimet e besimtarëve nuk arritën n’atë shkallë fuqizimi sa ta lejonin një praktikë të tillë. Por ka edhe shkaqe të tjera, si do ta themi ma poshtë. Këtu na duket me vend të bajmë një krahasim. Tue folë për ortodoksit e kishës sllave, relatori Pjetër Mazrreku, më 1633, thotë se ata kanë një patriarkë me seli në Deçan. Dhe vazhdon: “Të gjithë ipeshkvijt me gjuhë serbe e bullgare këtij i sjellin bindje, dhe ky Patriarkës së Stambollit të cilit i paguen dhetëmijë skudë në vjetë që kontribuojnë ipeshkvijt kush njëqind, kush dyqind skudë në vjetë” (Vëll. I, Dokum. Nr. 37, fl. 266v). Na mund të shënojmë pra se asht pikërisht e kundërt gjendja në klerin katolik të kohës: 100-200 skudë vjetorë prelatët katolikë, jo se ia çonin Papës në Romë si vepronin peshkopët ortodoksë kundrejt Stambollit, por i merrnin nga Roma në formë subsidi.

ç) Subsidet u banë një nga format dhe praktikat për mbajtjen e klerikëve katolikë në Shqipni. Vendi i ynë u konsiderue kurdo nga Vatikani si vend misionesh, prandej si vend propagande dhe jo shfrytëzimi të drejtpërdrejtë me anë tributesh. Sistemi i subsideve nuk ka pushue asnjëherë dhe, natyrisht, nuk kishte si t’u merrej tribut në të holla atyne që shtrinin dorën për të kërkue ndihmë. Tributi që u muer prandej qe i një natyre tjetër.

d) Me rimëkambjen e pasunive të kishëve shumë prej këtyne arritën të fitonin autonomi ekonomike dhe të mjaftonin për mbajtjen e famullitarëve e për pajisjet relative. Ky ishte synimi imediat i një aksioni të gjanë që u zhvillue në këtë shekull. Më 1634 Gjergj Bardhi propozon t’emnohet një ipeshkev vendas me 3-4 meshtarë për të shërbye në malësinë e

Mbishkodrës, dhe thotë: “për tri vjetë t’u jepet ndonjë rrogë derisa ata të krishtenë të fillojnë me u ndihmue “ (Vëll. I, Dokum. Nr. 39, fl. 66v).

dh) Edhe kur pasunitë e kishëve u rritën aq sa jetesa e klerit mund t’ ishte autonome, sistemi i subsidive vazhdoi, sepse kaloi nga dora e Vatikanit në duert e fuqive të mëdha. Ky ka qenë përfundimi i kësaj praktike dhe tributi moral që i pagoi Vatikanit kleri katolik kaloi në terrenin politik imperialist: kleri iu nënshtrua Austro-Hungarisë ma parë dhe pastaj Italisë.

Kleri i huej misionar dhe kleri i naltë shqiptar i pregatitun në kolegjet e Italisë vinin në vendin tonë me udhëzime për zbatimin e normave kishtare sipas teologjisë dogmatike që kish dalë e reformueme nga Koncili i Trentit. Lexuesi i dokumentave të kësaj kohe do të ndeshet vazhdimisht te një kontradiktë e madhe: nga njena anë qëndronte ngurosja dogmatike universale e kishës, e cila kërkonte me çdo kusht e në çdo vend të zbatonte të njëjtën ligjë, nga ana tjetër qëndronte realiteti që n’asnjë mënyrë nuk lejonte një zbatim rigoroz të tillë. Prandej do të na dalin gjatë leximit çashtje pas çashtjesh, të gjitha specifike për vendin e për popullin tonë në kushtet e rrethimit feudal (si ishin zonat malore), ose të shfrytëzimit feudal turk (si ishin zonat fushore), dhe përballë tyne pamundësia e klerit me zbatue normat kishtare: si të veprohet me gratë e krishtena që kanë shkue nuse në shtëpitë myslimane? si t’u jepen sakramendet atyne dhe fëmijëve të tyne, sikurse kërkojnë ato vetë? si të rregullohet çashtja e vrasjeve, e grabitjeve, e shitjeve të çunave e të çikave, e martesave pa kunorë, e kamatave etj.? N’asnjë mënyrë shoqnia që ushtronte këto zakone nuk e lejonte zbatimin rigoroz të moralit katolik. Na e thamë se kohë pas kohe prelatët dërgonin në Romë pyetjet e veta për zgjidhjen e këtyne çashtjeve. Por Roma u përgjegj kurdo se nuk mund të cenohej norma kishtare. Na mund të sjellim për shëmbull dy dekrete të këtij shekulli që po i nxjerrim nga aktet e Koncilit t’Arbënit të vjetit 1703. Në këto akte riprodhohet dekreti i 6 shtatorit 1625 me të cilin Kongregacioni i Riteve ndalon pagëzimin e fëmijëve të grave që kanë burrat myslimanë, dhe ndalesa bahej në përgjegje të një kërkese që kishte bamë arqipeshkvi i Tivarit (aso kohe Pjetër Mazrreku). Dekreti tjetër asht i datës 4 maj 1641, lëshue sipas kërkesës s’ipeshkvit të Sapës (aso kohe Frang Bardhi) po mbi çashtjen e pagëzimit.³

Përveç çashtjeve që na prekëm kalimthi, të cilat nuk kanë nevojë të paraqiten me një analizë, sepse me to janë të mbushuna të gjitha relacionet dhe shkresat, na do të ndalemi te një çashtje tjetër, për ta sjellë si shëmbull se si kushtet konkrete të bashkëjetesës së katolikeve me bashkëvendas myslimanë e ortodoksë nuk e lejonin zbatimin rigoroz të disa normave dhe reformave kishtare. E kemi fjalën te kalendarit gregorian. Popullsitë katolike vazhdonin në kalendarin e vjetër, dhe relatorët e ngrehin vazhdimisht këtë çashtje, dhe e numëronin fitore të madhe kur ia arrinin në ndonjë rasë të detyronin zbatimin e kalendarit të ri, i cili n’atë kohë kishte marrë edhe formën e një lufte ndërmjet kishës së lindjes dhe asaj të perëndimit.

Vështirsia e madhe për zbatimin e kalendarit gregorian (përveç pamundësisë së masave fshatare për ta kuptue ndryshimin dhe përveç talljes që i banin reformës popullsitë jo katolike) qëndronte në faktin se çashtja e kalendarit ishin e lidhun me afatet e tregjeve, të panairëve, të të korrave etj. Tue qenë se bashkëvendasit jo katolikë qëndronin në zakonin e vjetër, katolikët që kishin marrëdhanie të përditëshme me ta nuk mund ta thyenin lehtësisht kalendarin. Frang Bardhi raporton më 1637 se në Kabash të Shën Palit dita e këtij

³ CONCILIUM Albanum Provinciale sive Nationale habitum anno MDCCII Clemente XI. Pont. Max. Alban. Editio Secunda etc. Apendice ditata, Romae. Typis S. C. de Pr. Fide etc. MDCCCLXVIII, fq. 34.

shenji nuk festohej sipas kalendarit gregorian dhe vendasit duen ta festojnë 11 ditë ma vonë sepse thonë se ditën e Shën Palit duhet të dalë buka e re (Vëll. II, Dokum. Nr. 24, fl. 198).

Për këto arsye kishte rasë kur edhe vetë prelati-relator kërkonte lejen nga Roma që mos t'i detyronte besimtarët në këtë pikë. Në vjetin 1625 ipeshkvi i Arbënisë, Gjon Kolesi, raporton se ka sjellë në bindje të kishës latine 12 katunde ortodokse dhe pohon se nuk do ta kishte të vështirë të sillte edhe shumë të tjera sikur mos t'ishte pengesa e kalendarit. Kjo asht pengesa kryesore, vazhdon relatori, bile ven në dukje se, edhe ata që janë pajtue me kishën, tregjet i bajnë sipas zakonit të vjetër megjithëse ndër shtëpitë festat i kremtojnë sipas kalendarit të ri.

Kur na të kemi parasysh se, fundi i fundit, çashtja e kalendarit (sado që ishte një çashtje e pështetun në një llogaritje ma të saktë se sa të përparshmet) ishte një çashtje që s'kishte të bante me normën dogmatike, dhe megjithatë kërkohet zbatimi i plotë, çka do të themi për çashtjet tjera të lidhuna me ato institute kishtare, sikurse janë sakramendet, zbatimi i të cilave shikohej nga kisha si një çashtje teologjike e pacenueshme? E pra, sikurse patëm rasën ta çekim aty-këtu, edhe për dhanien e ushtrimin e sakramendeve, në popullsitë tona gjendeshin kundërshtime disa herë të pakapërcyeshme. Na mund të përmendim për të gjitha çashtjen e martesave: për treqind vjet t'aksionit misionar nuk ka qenë e mujtun (e kemi fjalën te popullsitë malore që jetonin sipas Kanunit) që martesat të konsideroheshin një ekskluzivë kishtare, si pretendonte riti; malësori ka vazhdue ta konsiderojë përherë martesën sipas kanunit: një kontratë shoqnore që perfeksionohet me lindjen e trashëgimtarëve, kurse kisha ngul kambë se ajo gjen perfeksionin te kunora e kishës pavarësisht nga lindja e trashëgimtarëve.

* * *

Për të zbatue aksionin e vet në vendet e misioneve, Kongregacioni i Propagandës kërkonte që kleri misionar ta mbante vazhdimisht në dijeni mbi gjendjen ekonomike, shoqnore e politike. Edhe relacionet e korrespondenca që nisej nga Shqipëria janë të ndërtueme sipas këtyne kërkesave, edhe pse në disa rasë autorët e tyne ose nuk kanë qenë në gjendje ose nuk kanë dashtë t'u përmbahen.

Na kemi parasysh një letër-qarkore të shekullit të XVII-të me të cilën Kongregacioni u jep instruksione klerikëve mbi çashtjet që ata duhet të trajtonin ndër relacionet e veta. Letra përmban 27 pika.⁴ Një paraqitje e shkurtë e këtyne 27 pikave mendojmë se do të na ndihmojë të shohim cilat qenë interesat e shumta që konvergonin për të njohtë vendet e misioneve, vendet që qëndronin – sikurse qe vendi ynë – nën një pushtim të cilin fuqitë evropiane synonin ta dëbonin dhe të vinin me e zevendësue.

Në këto udhëzime pra relatori porositet ma parë të japë hollësina për historinë e lashtë të vendit (pika 1). Me këtë nxiteshin nga njena anë interesat e shkencës që merrej me studimin e prejardhjes së popujve dhe, nga ana tjetër, për sa na intereson ne, nxitej edhe interesi i intelektualëve vendas për të hulumtue mbi të kaluemen e popullit tonë. Disa pika janë caktue në këtë letër-qarkore për të tregue vendosjen gjeografike të vendeve. Asht fare e qartë se këto të dhana viheshin pastaj në shërbim t'atyne që hartonin planet për penetrimin ushtarak ose ekonomik të shteteve të mëdha që kërkonin ekspansion (pikat 3, 4, 5, 25). Lidhun me këto synime, edhe ma të qarta bahen kërkesat për komunikacionin tokësor si edhe për lundrimin

⁴ SRCG, vl. I, fl. 379 – E boton E. Schmourlo në [ROMA e l'Oriente, v. I, A. I, N. 2, fq. 108-110].

lumor e detar (6, 22). Katër pika interesojnë drejtpërdrejt prodhimet e tokës dhe tregtinë (7, 8, 9, 10), tri mjeksinë popullore (10, 16, 17), tri kafshët (11, 12, 13), një peshqit (14), dy gurët dhe mineralet (15, 20), të tjera zejet, veglat e punës, gjahun, peshkimin (21, 23, 24), dy për njerëzit dhe zakonet e tyne (18, 19), një për bestytinitë dhe çdogja të jetës shpirtnore (26) dhe pika e fundit intereson librat dhe dorëshkrimet e vjetra eventuale (27).

Bie në sy një veçanti: nga këto 27 pika e dyta porosit relatorët mos të merren me hollësinat politike. Me të vërtetë, në se relatori do të kishte qenë i përpikët në përmbushjen e kërkesave të pikave të tjera, ç'nevojë tjetër do të kishte të hynte në hollësinat politike? Në se do të mblihdeshin bashkë të gjitha hollësinat e atyne 26 pikave të tjera, a nuk ishte dhanë njëkohësisht edhe informata ma e plotë politike? Por norma e shprehun për lanien jashtë të hollësive politike synonte te mos acarimi i marrëdhanieve të relatorëve me sundimtarët e vendeve me të cilët kishin interes të qëndronin në raporte të mira. Sikurse e thamë, kjo porosi ka qenë diktue nga nevoja që misionet dhe veprimi misionar të zhvilloheshin pa trazim. Kjo taktikë ka qenë zbatue edhe në vendin tonë. Veç shëmbujve që kemi dhanë ma nalt, lexuesi i këtyne materialeve do të ndeshet në shumë rasë konkrete të zbatimit të kësaj vije. Por, pavarësisht nga sa porosiste Roma, në disa relacione të klerikëve shqiptarë na do të gjejmë të dhana të randësishme edhe me karakter thjesht politik. Për pikat tjera, të gjitha relacionet kanë material të shpërndamë dhe me një analizë të mirë studiuesi mund ta mbledhë e ta sistemojë. Na, me të dhanat e këtyne relacioneve, do të përpiqemi ma tutje të japim një pasqyrë të shoqnisë sonë të shekullit të XVII-të.

* * *

Materialet dokumentare që kemi grumbullue në këto dy vëllimet tona janë pra në përgjithësi relacione ose korrespondencë që nisej për Romë nga klerikët e ndryshëm që vepronin në Shqipni: qofshin klerikë vendas, qofshin të huej; qofshin misionarë rregulltarë ose kler shekullar. Ka, sikurse e kemi thanë, edhe ndonjë relacion ose shkresë personash që s'janë klerikë, por që merren me çashtje të lidhuna me veprimin kishtar.

Janë pikë së pari relacionet vjetore që cilido prelat e kishte për detyrë të dërgonte për të tregue gjendjen e kishëve famullitare dhe të shërbimit shpirtnor ndër dioçezet përkatse. Këto relacione duhej t'ishin vjetore, por hetohet ndër autorët vështirsia që shpesh kanë për t'i redaktue, sepse efektivisht e kishin të pamundun t'i kryenin vjet për vjet vizitat nga pengesat e shumta që u dilnin, sidomos në zonat malore. E themi për zonat malore, sepse aty qëndronin popullsitë e armatosuna, në luftë me sundimtarët turq, dhe prandej çdo udhtim n'ato zona shikohej me sy të keq nga autoritetet e vendit. Këndej bahen edhe ma të çmueshme materialet dokumentare që na flasin për këto zona. Ka disa rasë në të cilat mund të hetohet se relatori nuk ka bamë tjetër veçse ka ndryshue rendin dhe disa të dhana numerike në krye të 4-5 vjetëve, dhe pothuej ka përsëritë një relacion të përparshëm. Këtë na duket se e hetojmë në dy relacionet e Mark Skurës për Shqipninë e Mesme, njeni i vjetit 1641 dhe tjetri pas vjetit 1644 (Vëll. II, Dokum. Nr. 36, 63). Me këtë na nuk themi se nuk ka objektivitet në ndryshimet që relatori ban në të dhanat numerike, sidomos n'ato që kanë karakter demografik dhe ekonomik, sepse ato ndryshime efektivisht pasqyrojnë realitetin për atë fazë kur procesi i islamizimit gjendet në veprim. Ka rasë pastaj kur i njëjti relacion asht i riprodhuem dy heresh, pikë për pikë, pa asnjë ndryshim, as në datë, as në të dhanat, as në renditjen, as në kaligrafinë. Mendojmë se kjo bahej për sigurinë që relacioni të mbërrinte domosdo në Romë, me qenë se

aso kohe kishte rrezik humbjesh dhe grabitjesh. Relatorët kishin interes që shkresat e tyre të mbërrinin me çdo kusht në Romë sepse, sikurse thamë ma parë, nga dërgimi i rregullt ose jo i tyre mvarej dërgimi ose jo i subsideve nga ana e Propagandës. Një relacion i tillë, të përsëritun fjalë për fjalë, e kemi ndeshë n'atë të Benedikt Orsinit mbi dioçezin e Shkodrës më 1629, të cilin e kemi gjetë qoftë në fletët 158-159, qoftë në fletët 179-180 të v. 262 të fondit SRCG (vëll. I, Dokum. Nr. 30).

Disa relacione rezultojnë të bame me kujdes e me imtësi të dhanash e informatash, kurse disa të tjera u bijnë punëve ma për së shkurti. Disa nga relatorët kufizohen vetëm me shënimet e thata që kërkoheshin rigorozisht: emërtimi i secilës famulli me kishën relative, me shenjtin, me famullitarin që shërben aty, me kushtet e jetesës së tij dhe me numrin e të krishtenëve. Të tilla janë në përgjithësi relacionet e ipeshkvit të Sapës dhe pastaj arqipeshkev i Tivarit, Gjergj Bardhit. Disa relatorë të tjerë shtojnë aty-këtu edhe ndonjë të dhanë me karakter ma të përgjithshëm ekonomik e historik. Të tilla janë relacionet e Mark Skurës për Shqipninë e Mesme. Disa relatorë përkundra (dhe shihet se duen t'u rrijnë sa ma me përpikni porosive që jepte Propaganda për ndërtimin e relacioneve) u hyjnë në thellësi problemeve ekonomike e shoqnore të dioçezeve të veta, kur asht fjala për prelatë titullarë, ose të gjithë vendit, kur asht fjala për vizitorë apostolikë ose misionarë. Tue përfitue nga etja që kishte në botën e perëndimit për të njoftë sa ma mirë vendet e popujt që gjendeshin nën sundimin otoman, dhe tue e vazhdue traditën e Mekajshit, të Budit e të tjerëve, disa relatorë shqiptarë, si Pjetër Mazrreku e Frang Bardhi, nuk lanë rasë me kalue pa folë gjanë e gjatë për vetitë fizike e intelektuale të shqiptarëve dhe për nevojën që t'u vihet atyne në ndihmë sidomos me themelimin e shkollave në vend dhe me themelimin e kolegeve për ta n'Itali.

Pavarësisht nga porositi që vente Roma, nuk ka dyshim se mbrendia e relacioneve dhe e korrespondencës së këtyne prelatëve e misionarëve pasqyron synimin e autorëve, shkallën e kulturës së tyre dhe karakterin e tyre individual.

Në lidhje pikërisht me synimet që kishte secili relator, na mund të bajmë një vrejthe të përgjithshme: misionarët kishin çdo interes që të paraqitej në Romë sa ma i vështirë misioni i tyre. Prandej ata e pëshkruejnë me ngjyra t'errta gjendjen dhe mundohen të venë në dukje mundimet që janë tue heqë në vend. Këtë e bajnë përgjithësisht të huejt, tek të cilët, sikurse dihet, len mbresa elementi ezotik, por as relatorët vendas nuk shpëtojnë në disa rasë nga kjo rrymë, sepse edhe ata kishin interes të ngacmohej mëshira e kardinajve të Romës për t'u nxjerrë ndihma e subside. Lexuesi prandej duhet t'i marrë me synin kritik disa shprehje dhe disa situata, dhe do të dijë të dallojë kur këto janë dhanë në mënyrë subjektive nga autorët.

Shënimet e pakta biografike që kemi mujtë të mbledhim për autorët kryesorë të relacioneve e të korrespondencës që kemi përfshimë në dy vëllimet tona, nuk na lejojnë të ndërmarrim ndonjë ndërtim për biografitë e tyre. Për sa u përket ipeshkvijve dhe arqipeshkvijve titullarë të dioçezeve tona, gjendja mbetet pak a shumë ajo e dhanun në veprën e citueme të Farlati-Koletit, tek e cila na po drejtojmë lexuesit tanë. Nuk ka dyshim se edhe në materialet që sot po shohin dritën e botimit, lexuesi e studiuesi do të gjejnë elemente biografike të reja për autorët.

Terreni, mbi të cilin u zhvillue në shekullin e XVII-të veprimi misionar i drejtuem nga Kongregacioni i Propagandës, asht fshatarësia jonë fushore e malore e Shqipnisë së Veriut e të Mesme ku kish mbetë në kambë ende katolicizmi.

Kushtet në të cilat jetonte kjo fshatarësi ishin të ndryshme: mbi shumicën e fshatarësisë fushore ish vendosë regjimi feudal ushtarak turk, kurse fshatarësia malore jetonte në përgjithësi jashta sistemit të timarit, në gjendje mosbindje dhe lufte me pushtuesin.

Bejlerë e spahillarë sundonin ndër feudet e veta në të cilat përfshiheshin fshatet fushore, dhe kishin dorë të lirë të randonin veprën e shfrytëzimit tue shti në punë të gjitha keqpërdorimet që lejonte sistemi. Si kudo gjetiu nëpër perandorinë otomane, edhe në Shqipni, në shekullin e XVII-të, keqpërdorimet ishin shumëfishue. Në këto kushte, ishin vërtetue në fshatarësinë tonë disa fenomene, të cilat i ndeshim në veprim edhe gjatë leximit të dokumentave që kemi parasysh.

Në radhë të parë, fshatarësia që rënkonte nën regjimin e timarit, kishte arrijtë në vorfnimin ma të madh aq sa, aty-këtu, ndeshemi edhe në fshatarë të zhveshun nga çdo formë pronësie mbi tokën e bukës e mbi shtëpitë e banimit: janë fshatarë të shndërruem në bujq që punojnë tokët e feudalëve dhe banojnë në shtëpitë e tyne. Kjo gjendje na pasqyrohet në relacionin e fra Kerubinit të vjetit 1638 kur flet për fshatarët e pesë fshateve që formojnë famullinë e Barbullushit, dhe përfundon tue thanë: "Shumë prej këtyne i kishin arat dhe shtëpitë e veta, por, nga shtypjet e randa të turqve, kanë shitë çdogja dhe janë bamë punëtorë ... Në këtë mënyrë pra janë vetëm 42 shtëpi që kanë pronat e veta, kurse të tjerat janë punëtorë të turqve" (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 98). Në lidhje me randimin e padurueshëm të shfrytëzimit ishte krijuë në fshatarësinë tonë dhe kishte shkue tue u dendësue fenomeni i islamizimit: "Shumë vetë, për mos me pague haraç, janë bamë turq, disa të tjerë për t'u pasunue e disa të tjerë për të jetue lirisht" (po aty, fl. 93). Në këtë copëz na hetojmë tri arsyet për të cilat fshatarësia kalonte në islamizëm:

a) Për të mos pague gjizjen, që ishte haraçi i vumë përmbi kokën e të krishtenëve. Si mund të kuptohet nga disa të dhana të këtyne materialeve, ndoshta islamizimi mund t'ishte mjet për të shpëtue edhe nga ndonjë haraç tjetër lidhun me tokën etj. Kjo taktikë dha ndonjë fryt përkohësisht por, sikurse dihet, arkat e Sulltanit i kishin të llogarituna t'ardhunat fikse nga haraçet dhe nuk donin të dinin kush u islamizue ose jo. Prandej, shpëtimi nga kjo pagesë tek i cili synonte fshatari i islamizuem randoi në një kohë të parë mbi bashkëfshatarët e tij të krishtenë dhe pastaj u kthye rishtas edhe mbi te: "... kur në një fshat ndonjeni bahet turk, e lirojnë nga haraçi, e pjesën e tij duhet ta paguejnë të tjerët, dhe kështu pak nga pak, e pastaj, si të bahen të gjithë turq, prap e vendosin haraçin përmbi të gjithë" (po aty, fl. 88).

b) Arsyeja tjetër e islamizimit ishte se, tue përqafulë besimin zyrtar të pushtuesit, njerëzit kishin mundësi të gëzonin diferencimin e privilegjuem me anën e të cilit mund të ndiqej rruga që të çonte në pasunim. Mendohet se këtë rrugë e ndiqnin ata fshatarë që kishin pasuni dhe duhej të zgjidhnin: ose ta humbisnin pak nga pak, ose, tue u islamizue, ta ruenin dhe të kishin mundësi me e shtue. Asht i njoftun procesi i islamizimit të klasës feudale vendase e cila, me t'u vendosë pushtimi turk, i dha dorë këtij dhe siguroi pozitën e vet zotnuese. Islamizimi i klasës feudale vendase, përveçse siguroi pozitën e pushtimit turk, siguroi edhe vazhdimin e shfrytëzimit t'asaj klase mbi fshatarësinë tonë. Edhe në shekullin e XVII-të pra ndonjë element i pasun fshatar, që e shihte të kërcnueme pozitën e vet, ndoqi rrugën e islamizimit.

c) E treta arsye përse islamizoheshin, ishte sepse padyshim, në marrëdhëniet e përditshme, ata që shpallnin besimin zyrtar të pushtuesit, kishin ma pak kokëçamje dhe domosdo shikoheshin me sy tjetër. Pozita e rajes së krishtenë ka qenë kurdo në një shkallë diskriminacioni përballë nënshtetasve myslimanë. Kështu e kuptojmë shprehjen e relatorit: "për të jetue lirisht", d.m.th. pa atë diskriminacion.

Këto aspekte t'islamizimit të fshatarësisë në shekullin e XVII-të pasqyrohen në materialet tona dokumentare, të cilat padyshim na japin sot një landë të re për ta studiue ma në thellësi këtë proces.

Na mund të hetojmë në këto materiale edhe fajet e vetë prelatëve që duhej të luftonin për riejtjen e besimit. Më 1649 në një letër proteste që dërgohet në Romë kundër arqipeshkvit të Tivarit, Bonaldit, kështu nënshkruen një tivaras: “Unë, Askan Paskuali, tashti Mustafa me dhunë, për të mbajtur dhetë frymë të krishtena te shtëpia, dhe kjo nga persekutimi i të përnderueshmit Bonaldi” (Vëll. II, Dokum. Nr. 74). Po ky Bonaldi, aso kohe n’arrati, fajoset në një shkresë tjetër veç tjerash se ka qenë shkaktar që “u plaçkit dhe u rrenue metropoli i tij me gjithë dioçez ...” (Vëll. II, Dokum. Nr. 78).

Në të gjithë këtë zonë të veprimit misionar në shekullin e XVII-të, ne na paraqitet edhe një krahinë në të cilën fshatarësia fushore jetonte jashta regjimit të timarit. E kemi fjalën për Zadrimën e privilegueme. Për gjendjen politike të kësaj krahine na flet gjanë e gjatë Frang Bardhi në relacionin e tij të vjetit 1614 (Vëll. II, Dokum. Nr. 35 në përgjithësi dhe sidomos te fl. 159-160). Sikurse del nga tregimi i relatorit, Zadrima nuk kishte feudalë ushtarakë, por detyrimet i mblidhte një zyrtar i dërguem nergut nga Stambolli: xhabia. Fshatarësia qeverisej nga një këshill i përbashkët në krye të cilit qëndronte ipeshkvi. Nga ky relacion dhe nga të gjitha të tjerat që na flasin për Zadrimën, na do të shohim nga ana tjetër se në gjirin e fshatarësisë së krishtenë t’atjeshme vazhdonte të kishte diferencim në pasuni e në fuqi. Kështu na do të ndeshemi në fshatarë të pasun që ndërtojnë e pasunojnë kishët, do të ndeshemi në dyer të vjetra që e kanë bamë të trashëgueshme parësinë: vetë dera e Bardhejve, veç pjesëtarëve të tjerë laikë e klerikë, në pak kohë i dha Zadrimës tre ipeshkvij, dhe kjo donte me thanë: tre kryetarë të këshillit ose të kuvendit të përbashkët.

Krahas fshatarësisë fushore ishte edhe fshatarësia malore: strumbullari i rezistencës dhe lëvizjeve t’armatosuna shqiptare gjatë pushtimit turk. Fshatarësia malore jetonte në kushte të tjera politike dhe ekonomike. Për të parën herë, sikurse e vumë në dukje ma parë, me materialet tona dokumentare, sidomos me relacionet e Frang Bardhit, të Pjetër Mazrrekut, të Gjergj Bardhit, të Gjon Kolesit, të Mark Skurës, të Benedikt Orsinit etj., na jemi në gjendje të hyjmë në zemrën e zonave malore. Të pështetun në këto relacione na sot jemi në gjendje të ndërmarrim një studim mbi strukturën shoqnore të kësaj shoqnie që mbahej e rregullueme në kanunet e veta tradicionale, pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të ligjës dhe të gjykatësve turq. Konfliktet shoqnore të fshatarësisë fushore ma në fund gjenin zgjidhje edhe pranë gjykatave të Sherisë në të cilat kadiu zbatonte ligjën e Sheriatit; vetë Zadrima e privilegueme kishte edhe kadiun e vet. Në zonat malore, përkundra, këto institute nuk kanë qenë në veprim, po ashtu sikurse nuk kishte aty as feudalë që të qeverisnin vendin. Nuk ka dyshim se sistemi feudal-ushtarak otoman përpiquej të depërtonte edhe nëpër këto male, tue hymë ma parë nëpër luginat e tyne: kohë pas kohe baheshin përpjekje të tilla, por ma në fund fshatarësia malore kishte fitue dhe mpronte me armë Kanunin e vet.

* * *

Gjysma e parë e shekullit të XVII-të karakterizohet nga ashpërsimi ma i madh i konfliktit midis fshatarësisë së lirë malore dhe feudalëve që i rrinin rreth e përçark për ta zotnue. Sikurse e thamë në krye, në fillim të shekullit të XVII-të u copëzue njeni nga unitetet ma të mëdha, Dukagjini. Mbas dhetëvjetorit të parë të këtij shekulli, ndoqën vjetë të një bashkëjetese të detyrueme: nga njena anë malësorët, të ngushtuem edhe ma shumë se përpara në territorin e ashpër malor, me jetën e tyne të lirë por shumë të keqe ekonomikisht; nga ana tjetër feudalët (në shumicë vendas t’islamizuem) që kishin hymë me fortesat e tyne deri në gjiun e luginave malore. Për të nxjerrë mjetet e jetesës që nuk ua qitëte mali, malësorët ishin të detyruem ta

shpërthenin herë pas here në drejtime të ndryshme rrethimin feudal; dhe feudalët, me ekspeditat e tyre përpiqeshin t'i likuidonin një herë e mirë këto zona malore kaq të rrezikshme për zotnimet e tyre, dhe t'i futnin nën sundimin e vet.

Materialet tona dokumentare na flasin për këto përpjekje. Na mund të përmendim këtu veprën e shtëpisë së Kukejve që ishin vendosë në vaun e Drinit (te Kukësi i sotëm) dhe, në shpërblim të zyreve e të titujve që u jepte Sulltani, e kishin për detyrë të mbanin nën presion pikërisht Dukagjinin. Për këtë na flet Pjetër Mazrreku në relacionin e tij të vjetit 1633 (Vëll. I, Dokum. Nr. 37, fl. 272). Do të përmendim edhe ekspeditën e madhe që kreu në fillim të vjetit 1638 Vuço Pasha i Bosnies përmbi Kelmend. Me të dhanat e hollësishme që na jep për këtë ekspeditë Frang Bardhi, i cili i shihte me sytë e vet ushtritë dhe kishte çdo mjet për të dëjtë nga goja e dëshmitarëve rrjedhjen e ngjarjeve, na sot jemi në gjendje të trajtojmë ma drejtë një ngjarje të madhe që, përveçse intereson vendin tonë, ka interesue edhe historinë e përgjithshme të Turqisë. Të dhanave të Frang Bardhit u shtohet edhe relacioni që jep për këtë ekspeditë fra Kerubino (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 95-96; Dokum. Nr. 30, fl. 159-161).⁵

Me të vërtetë shumë e vështirë na paraqitet jeta e këtyne malësorëve në materialet tona në periudhën që kemi marrë në studim.⁶ Ngushtica e madhe ekonomike, vorfnia e atyne malësorëve, asht rrjedhim i logjikshëm i ngushticës së vendit dhe i luftave të pandërpreme të shekujve të maparshëm, dhe ma në fund rrjedhim i rrethimit feudal të cilin pushtuesit arritën ta vendosnin në këtë zonë.

N'ato male faktori kryesor që e bante të vështirë jetën ishte padyshim se toka ishte e pamjaftueshme, e ashpër dhe shterpë, mbi të cilën veglat primitive të punës nuk mund të nxirnin prodhime të bollshme. Së dyti, nga luftat e nga vrasjet, nga shitja e njerëzve – çuna e çika që vazhdimisht u jepeshin feudalëve të rretheve për të shue pangopësinë e tyre – njerëzia nuk shtohet, bile shkonte tue u paksue; kështu krahu i punës ishte i pamjaftueshëm për të luftue me natyrën e pagrat.

S'ka dyshim se edhe në malësitë janë luginat me blerimet dhe me rrjedhat e shumta; ato kishin edhe aso kohe, sikurse sot, atë bukuri piktoreske që të rrëmben: “Këto male, edhe pse t'ashpra e të thepisuna, megjithatë natyra nuk i ka lanë pa i pajisë me lugina shumë të pllëshme, të përshkueme me lumej të kandshëm që qesin atë lloj peshku që edhe në shqipe ... quhet troftë. Lindin edhe venëna shumë të shkëlqyeshme...” (Vëll. I, Dokum: Nr. 37, fl. 271). Këto fjalë u shkruen nga relatori në një kohë kur ai kërkonte nga Roma të ngriheshin kolegje për shqiptarët dhe kur i bante thirrje Evropës kristiane mos të liheshin me ra në zotnimin e plotë të turqve ata malësorë që kaq shumë lufta kishin zhvillue. Natyrisht prandej edhe natyra e vendit duhej paraqitë në këtë rasë me ngjyra sa ma të bukura, përndryshej si do t'ishin ngacmue princat e Evropës? Kjo ishte një taktikë që e ndeshim vazhdimisht në relacionet e kohës, por tashma Evropa i kishte lanë në harresë këto male me rrezik që kjo zonë e këta banorë, që për qinda vjetë luftuen për çlirimin e vendit, mund të kalonin n'anën e turqve. Relatori, në këtë rasë, e fsheh të vërtetën tjetër: luginat e pllëshme e troftat e lumejve me vneshtat, tashma në vendet ma të mirat, ishin nën kontrollin e feudalëve që qëndronin në Qytezën e Re e në vende të tjera, kurse shumica malësore jetonte pikërisht në vendet e vështira që relatori i mbulon me fjalët “t'ashpra e të thepisuna”.

⁵ Të shihet punimi ynë: “Bashkimi i Maleve Shqiptare etj.” në [BULETINI Shk. Shoq. 1957, Nr. 3(1), fq. 63-85].

⁶ Fletët që ndjekin mbi gjendjen ekonomike e shoqërore të zonave malore i kemi nxjerrë nga punimi ynë: “Dukagjini dhe Pulti në gjysmën e parë të shek. XVII” [BULETINI, 1959, Nr. 1, fq. 3-22].

Toka në përgjithësi, toka që mund të shfrytëzohet nga malësorët pa rrezik se u merrej prodhimi nga feudalët apor t'u digjej n'arë nga ekspeditat ndeshkuese, nuk e jepte bukën e mjaftueshme për jetesë: "... këta t'Iballës janë ashtu si ata të Mirditës, por të gjithë shumë të vorfën, qoftë nga plaçkitjet e pësimeve, qoftë edhe sepse janë vende shterpe ku s'bahet tjetër veçse thekna mbas shumë mundimesh: presin pemët, i djegin ato dru dhe n'atë vend të djegun mbjellin një herë ose dy" (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 94v).

Vendi pra nuk e qitëte bukën: "kurr nuk e bajnë bukën sa me u mjaftue" (Vëll. II, Dokum. Nr. 24, fl. 198). Për ta zëvendësue bukën ata malësorë kërkonin fryte të tjera në natyrë. Tue na folë për Iballen, Gjergj Bardhi thotë: "shumë rrallë mund të nxjerrin bukën prej drithnave të tyne dhe jetojnë vetëm me frytet e kështenjave" (Vëll. I, Dokum. Nr. 34, fl. 252v). Por ajo që ma shpesh na del në këto materiale dokumentare asht se ushqehen me frytet e kaçubave (*roveti*). Na mendojmë se asht fjala për boronica. Kështu, kush zotnon shumë nga këto kaçuba, mbahej se kishte pasuni: abacia e Shën Palit të Pukës, na tregon Frang Bardhi, "ka nën sundimin e vet shumë male fort të nalta të mbushuna me landë të mëdha e të trasha për çdo lloj druje, dhe aty bahen boronica që i sjellin shumë t'ardhuna kishës" (Vëll. II, Dokum. Nr. 24, fl. 195v).

Me gjithë mungesën e drithnave vendi, përveç vneshtave nga të cilat nxirte venën, kishte kullosë të mira dhe gja të gjallë. Blegtoaria ishte dega kryesore ekonomike me anën e së cilës malësorët mund ta siguronin jetën. Por edhe për këtë aktivitet mungonin krahët e punës që të rritej e të përmirësohej gjaja e gjallë dhe të përpunoheshin me shumicë prodhimet e saja. Nuk duhet harrue edhe se pikërisht gjaja e gjallë pësonte shfarosjen ma të madhe kur ekspeditat e feudalëve hynin nëpër fshatet malore.

Me armë në dorë malësorët kishin qëndruar kundër pushtuesve dhe me armë i kishin sigurue vehtes lirinë n'ato male, dhe me armë e ruenin atë liri. Por, si thamë, ishte tashma një liri e sigurueme në një vend shumë të ngushtë ku s'kishte mundësi të sigurohej jetesa me anën e punës prodhuese. Të katandisun në ngushticën ma të madhe, këta malësorë ishin detyruar t'i nxirnin mjetet e domosdoshme të jetesës me anë të plaçkitjes ndër zotnimet feudale ose të karvaneve tregtare. Por këto plaçkitje sillnin raprezaljet e feudalëve të damtuem, të cilat shkaktonte vrasje, djegie e rrenime në katundet që sulmoheshin me ushtri. Malësorët, tregon relatori, "disa herë shkojnë për të grabitur turqit e këta, t'idhënuem nga kjo, mbledhin ushtri dhe shkojnë për t'i plaçkitë" (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 92).

Pasi feudalët kryenin ekspeditat, në katundet e shkretueme krijohej një mjerim i tillë sa që banorët ishin të detyruem të kërkonin të merrnin me dhunë kudo që të gjenin për kafshatën e gojës; këta "për ta marrë vehten, shkojnë kundër të krishtenëve o turqve të tjerë të pafaj" (po aty).

Në mesin e gjithë kësaj vorfënie, malësorët kishin edhe disa detyrime për t'i pague.

Me luftën e armatosun dhe tue mbajtë gjithnjë armën në krah, malësorët – kur u gjetën të detyruem të bashkëjetonin me feudalët e luginave – e kishin sigurue privilegjin e mospagesës së të dhetës, por një sasi sado minimale haraçi duhet ta paguenin. Megjithatë, për të shpëtue edhe nga ajo pagesë e parandësi, por që për ta ishte e madhe pikërisht sepse ishin katandisë n'atë vorfni të pashembullt, disa malësorë të luginave – dhe këtu e kemi fjalën për ata të Pukës – kishin nisë t'islamizoheshin. Turqit, thotë relatori, "atyne nuk u marrin të dhetën, veçse paguejnë pak o aspak haraç, dhe nga ky shkak shumë bahen turq" (po aty, fl. 96v).

Ajo që e ban të qartë edhe ma mirë vorfninë e madhe të malësorëve asht pamundësia që ata kishin të mbanin në një zonë të haptë, të përbame prej shumë katundesh, ma shumë se një prift. Në të gjitha katundet e Pukës p.sh. nuk kishte veçse një famullitar.

Por, përveç shfrytëzimit në formën e këtyne detyrimeve ndaj feudalëve, në gjiun e kësaj malësie vemë re se vepron edhe një shfrytëzim nga mbrenda me format specifike për atë shoqni.

Diferencimi shoqnor që vepron në këtë kohë në gjirin e shoqnisë sonë malësore⁷ shprehet në disa forma specifike për malësinë. Në radhë të parë janë krenët e të pasunit që, nga pozita e tyre drejtuese, përfitojnë me ushtrinë shfrytëzimin me anë të kamatave dhe të shitjes së çunave dhe çikave ndër turq: “përherë u kanë shitë turqve skllavë të krishtenë, deri fëmijët e gratë e veta. Mund të jetë ndonjë njeri që ka mujtë me shitë deri në 70” (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 91v-92). Kështu na flet fra Kerubino më 1638 dhe Frang Bardhi përsaktëson: “të krishtenët e pasun e të fuqishëm, këta skllavë që ua japin turqve, ua marrin të krishtenëve të vobekët” (Vëll. II, Dokum. Nr. 30, fl. 157v). Në këto kushte diferencimi shpesh ushtroheshin edhe akte të dhunës për përvetsimin e pasunive. Në Shosh, Benedikt Orsini gjeti një burrë që kishte marrë dhe mbante te shtëpia 9 gra dhe “një djalë i këtij kishte vra kumbarin e vet dhe kishte marrë për vehte gruen e tij me të gjitha tokët e pasunitë e tija dhe dy çuna të tij ua kishte shitë turqve” (Vëll. I, Dokum. Nr. 29, fl. 171v).

Por lexuesi i këtyne materialeve ka për t’u familjarizue vetë me të dhanat e shumta që na pasqyrojnë këtë diferencim shoqnor në gjirin e shoqnisë malësore. Na do të konstatojmë vetëm se ky diferencim ashpërsohet n’ato periudha kohe kur krijohet një lloj qetësie dhe kur nisnin marrëdhëniet e përditshme edhe me zonat e rrethit ku sundojnë feudalët. Në këto rasë janë pikërisht krenët malësorë që lidhin kontakte me sundimtarët turq qoftë edhe tue u paraqitë faqe tyre me armë në brez: shenj i një bashkëjetese t’armatosun, të gatshme kurdo me kalie në konflikt: “Kombet e tjera nuk guxojnë me i bartë [armët] e shqiptari, sidomos krenët e thanun qefalij flasin

t’armatosun me sanxhakbejlerët turq” (Vëll. I, Dokum. Nr. 37, fl. 273). Në rasë lufte, përkundra, konfliktet e mbrendshme paqësosheshin dhe të gjithë mbërthesheshin n’armë për të luftue kundër anmikut. Dhe, me qenë se gjatë pushtimit turk zonat tona malore kanë qenë në një gjendje lufte të përhershme, dhe bashkëjetesa me feudalët në dy shekujt e parë qe e rasëshme, diferencimi shoqnor nuk gjeti atë acarim që do të kishte marrë sikur bashkëjetesa me feudalët e rrethit të kishte qenë e vazhdueshme dhe normale.

Nuk ka dyshim pra se tash, me leximin e këtyne materialeve, na e njohim ma mirë fshtarësinë tonë malore dhe kushtet në të cilat ajo e vazhdoi luftën e rezistencës kohën e pushtimit turk.

* * *

Kurdo udhëtarët kanë qenë tërheqë edhe nga çfaqjet e veçanta të jetës së përditshme të popullive të vendeve të panjohuna. Edhe relatorët tanë, qofshin vendas ose të huej, dhe jo vetëm për të përmbushë një nevojë të kureshtjes, por edhe për t’u ndejë porosive, nuk e lanë pa i paraqitë aspektet e veçanta: zakonet, bestytnitë, mjeksinë popullore etj. Kështuqë të dhanat e shumta të kësaj natyre mendojmë se do të jenë material i vlefshëm për studimet tona etnografike dhe folkloristike. Vlera ma e madhe e këtyne të dhanave mendojmë se qëndron në mundësinë që do të kenë etnografët dhe folkloristët tanë të ndjekin me metodën e krahasimit

⁷ Për një analizë të të dhanave, lexuesi mund të shohë punimin tonë të thanun te shënimi i masipërm (te shën. 6.).

evolucionin që kanë bamë doket e zakonet dhe të hetojnë forcat që kanë veprue pozitivisht ose negativisht në këtë zhvillim.

Natyrisht, përsa u përket të dhanave të kësaj natyre të shpërndame nëpër këto materiale dokumentare, ato bahen ma interesante për zonat malore, pikërisht sepse këto zona ishin në një gjendje të veçantë dhe në kushte ma të mira për t'i rrujtë dhe për t'i zhvillue. Por lexuesi do të shohë se nuk mungojnë të tilla të dhana edhe për fshatarësinë e fushës, bile për studiuesin bahen edhe ma t'interesantshme sepse pikërisht në fushë fshatarësia jonë ka qenë e detyrueme pak nga pak me ia përshtatë doket e zakonet njëj bashkëjetese të detyrueme me pushtuesit feudalë.

Interesi i këtyne të dhanave asht prandej shumë i madh. Tue u nisë prej bestytnive dhe besimeve të shtrembta të një fanatizmi e konservatorizmi fetar, tue kalue nëpër padijen e vetë klerit që udhëhiqte shpirtnisht këto popullsi, pasqyrohet jeta shoqnore e tyne dhe bashkëjetesa e fshatarësisë së krishtenë me vendasit myslimanë me të cilët ruenin marrëdhaniet farefisnore dhe të jetës së përditshme kundra çdo përpjekje të klerit misionar për t'i largue nga kjo rrugë. Lexuesi do të familjarizohet me jetesën e familjes fshatare t'asaj kohe ashtu si paraqitet nga kujdesi që kishte kleri për moralin katolik: jo bigamia e konkubinati, jo hakmarrja ose vrasjet me larmitë e tyne, jo plaçkitja, jo shitja e robëve të shtëpisë etj. Në mesin e zijës së madhe në të cilën asht e detyrueme të jetojë fshatarësia jonë fushore e malore, ajo ka gjetë edhe rrugën për ta vazhdue traditën e vet të kangës, të dasmave, të festave me miqësi dhe të vdekjeve me gjamët, vajtimet dhe me drekët përkatëse.

* * *

Në shekullin e XVII-të, për të cilin na thamë që në krye se shënon ringjalljen shqiptare në një masë të papame deri n'atë herë, si rezultat i luftave t'armatosuna, i kuvendeve, i projekteve për çlirim, në të cilat shqiptarët kishin shkëlqye, doli në skenë me të madhe edhe interesi për kombësinë. Kjo çashtje mori rritje dhe u zhvillue në formë luftime në terrenin ideologjik dhe nga fakti se në këtë kohë kleri i huej që dërgohej me shërbim nga Roma në Shqipni përçmoi dhe shpifi rreth luftave të shqiptarëve dhe aftësive të tyne praktike dhe intelektuale. Mendojmë se u bajmë edhe këtu një shërbim lexuesve tanë tue paraqitë një kuadër të konfliktit që u zhvillue midis klerit të huej që dërgohej në Shqipni dhe klerit vendas. Në këtë mënyrë lexuesi do të jetë në gjendje të vlerësojë ma drejt elementet e këtij konflikti që dalin vazhdimisht në materialet dokumentare të këtyne dy vëllimeve tona, dhe elementet tjera që kanë të bajnë me kombësinë shqiptare.

Aty nga fundi i relacionit që bani Marin Bici, pas vizitës së tij nëpër Shqipni dhe Serbi, thotë kështu: "mendohet se, në qoftë se Shqipnia dhe Serbia nuk do të kenë ndonjë ndihmë ma të madhe, në ma pak se 7 vjetë do të shkojë dam gati i gjithë krishtenimi i atyshëm, nga numri i paktë i ipeshkvijve dhe i meshtarëve që të kenë ndopak dije" (Vëll. I, Dokum. Nr. 2, fq. 139).

Me të vërtetë, në këtë kohë në Shqipni kishte vetëm dy ipeshkvij, por edhe këta gjendeshin n'arrati. Njeni prej të dyve, Nikollë Mekajshi, ipeshkvi titullar i Stefanisë (Shqipni e Mesme) që nga fundi i shekullit të XVI-të po merrej me organizimin e lëvizjeve t'armatosuna shqiptare për çlirim. Edhe ipeshkvi i Sapës, Nikollë Bardhi, kishte qenë aktiv, së bashku me të parin, sidomos gjatë kuvendit të madh të Dukagjinit më 1601-1602. Që të dy këta ipeshkvij, nga veprimtaria e tyne në këtë fushë, kishin qenë detyrue të merrnin arratinë. Ishte edhe ipeshkvi i Lezhës, një raguzian i cili banonte në qytetin e vet dalmatin tue shpenzue t'ardhunat që, herë pas here, vinte të vilte në Lezhë. Me kohë, Nikollë Bardhi mujti të vinte e të qëndronte në Sapë, dhe

Marin Bici e gjen aty kur ban vizitën e vet më 1610; por Nikollë Mekajshi nuk kishte ma vend se ku të vinte. Pikërisht në këtë vjet ai u gjet në Romë dhe shtroi relacionin ose projektin e vet (Vëll. I, Dokum. Nr. 1).

Jo për shtatë vjetë, si parashihte Marin Bici, por pas 11-12 vjetësh ma në fund Roma i siguroi Shqipnisë 4 ipeshkvij: në Shkodër, Sapë, Lezhë dhe Arbëni. Por nuk qe kaq e lehtë vendosja e tyre në seli sepse tashma vetë kleri vendas ishte mësue të vepronte sipas zakoneve të vjetra dhe çdogja që vinin të reformonin të huejt (sepse Shkodra dhe Lezha patën ipeshkvij të huej) randonte keq. Kënde marrin spjegim konfliktet e shumta që reflektohen në relacionet dhe korrespondencën e gjysmës së parë të shekullit të XVII-të.

Marin Bici e shikon drejt realitetin jo vetëm nga pikëpamja kishtare, por edhe nga një pikëpamje tjetër: ipeshkvi i huej vinte, merrte atë që kishte për të marrë, thonte atë që kishte për të thanë, linte një vikar (zevendës) dhe ... lamtumirë. Kurse vendasi, përkundra, me interesat e veta të lidhuna me rrethin e vet familjar etj. ishte i detyruem të qëndronte vazhdimisht në seli, dhe kështu u rrinte punëve përherë mbi krye. Ai pra, tue këshillue që ipeshkvijt duhej të qëndronin vazhdimisht në seli, thotë: “Përherë do t’ishin ma të qëndrueshëm në seli ipeshkvijt vendas se sa të huejt” (po aty, fq. 140). Dhe, tue mendue se kleri vendas në përgjithësi ban punë ma të frytshme, shton: “Në se do të jepet mundësia që një sasi klerikësh t’atyne anëve të stërviten në dituni, duhet të merren vendas, të cilët të jenë t’interesuem me pasuni dhe me farefis, që pas studimeve të shkojnë e të qëndrojnë në vend tue shpenzue talentin në të mirë t’atyne shpirtnave” (po aty). Nuk duhet harrue me këtë rasë se Marin Bici, megjithëse ishte nga vendet veriore adriatike, kishte prejardhje shqiptare.

Konflikti i klerit vendas kundër prelatëve të huej që vinin tek ne asht i lashtë. Na do të shënojmë vetëm se ky konflikt arriti në një ashpërsim ma të madh në vjetët e para të shekullit të XVII-të, kur eksponent i klerit vendas ishte Nikollë Mekajshi: “Na – i shkruajnë më 1602 shqiptarët Papës – po shohim se pa lutjen tonë dhe pa kërkesën tonë po vijnë në këto anë tona ipeshkvij, abatë dhe të tjerë, të huej me komb, të huej me gjuhë, të huej me zakone dhe të huej për çdogja që asht në vend” dhe, tue e krahasue ardhjen e tyre me skenën biblike të fundosjes në ferr t’engujve kryengritës, thërrasin me shprehjen e psalmit: “Mjer ju, o detna e tokë, sepse po zbret djalli në ju!” (HORVATH: Glasnik Zemaljskog Muzeja u Bosni i Hercegovini etj., XXI-1909, Dokum. Nr. 83, fq. 90-94).

Veç përdhunimesh të tjera që veprojnë këta klerikë të huej në vendin tonë, vazhdon protesta, ata na përçmojnë dhe thonë se “shqiptarët nuk janë për asgja, të gjithë të padijtun”. Dhe, mos të qenkesh friga e Zotit që e ndalon të keqen, ipeshkvin e Lezhës t’atyne ditëve, që ishte dalmatin, “jo vetëm do t a kishim dëbue atë prej nesh, por bile me idhënim të popullit do t’i kishim lëshue qejt mbë shpinë”. Por, edhepse tregohen t’urtë dhe presin të merren masa që këta të huej të largohen nga vendi dhe në t’ardhmen mos të dërgohen ma, shqiptarët e thonë shkoqun: “ne jemi të shtërnguem t’i shkelim ligjët dhe të procedojmë kundër atyne n’atë mënyrë e n’atë rrugë si do të na duket mirë” (po aty).

Dhe prap sinodi shqiptar, tue ia paraqitë çashtjen kardinalit Mafej, e shtron me të madhe protestën kundër përçmimit që u bahet shqiptarëve nga prelatët dalmatinë të cilët dërgohen nga Roma në disa seli të Shqipnisë. Sinodi reklamon të drejtën që ka vetë kleri vendas për t’emnuë pjesëtarët e vet n’ato seli, sepse “ nuk kanë qenë sllavët ata që e kanë mbajtë e ruejtë të gjallë besimin” në vendin tonë (HORVATH, po aty, Dokum. Nr. 84, fq. 95-100). Prelatët dalmatinë, thotë ankesa e sinodit, arrijnë të pohojnë “se asnjëri nuk din të shkrujë në këto anë, veçse dy ose tre vetë nga Lezha: gja krejt e gënjeshtërt dhe një rrenë e plotë, sepse në të

gjithë vendin ka shumë vetë që dijnë të shkruajnë”: Na pra, vazhdon protesta, “të bashkuem në një mbledhje provincjale kemi vendosë” të hiqet ipeshkvi i Lezhës ma parë dhe “të na shënohen ipeshkvij e krenë njerëz t’atdheut tonë, sepse kështu, tue dijtë ata gjuhën e zakonet”, do të jenë të dobishëm etj. (po aty).

Tue i vazhdue këto tradita kaq të mira të mprojtjes s’interesave të shqiptarëve përballë lakmive dhe synimeve të të huejve, edhe Pjetër Budi, me t’ardhë në selinë e Sapës, bani sinodin ndër dioçezan në të cilin gjithë kleri vendas u betue të mos pranonte prelatë të huej. Rrjedhimet e këtij sinodi të fundit na dalin sidomos në korrespondencën e Domeniko Andreasit të vjetit 1623.

Gjuha shqipe, nevoja e arësimit dhe çdogja që vlen për të shpëtue kombin shqiptar nga kërcnimi i asimilimit që i vjen nga çdo anë, janë argumenta që interesojnë një pjesë të këtyne materialeve. Me të vërtetë, përpjekje të tilla na kanë qenë dëshmue edhe nga vetë fakti se në këtë shekull u botuen në gjuhën shqipe librat e njohun, të gjithë, sikurse e thonë shkoqun autorët, për dashuni të popullit dhe të vetë gjuhës shqipe, ashtu sikurse kish qenë dhanë filli nga Gjon Buzuku i shekullit të maparshëm.

Qoftë nga misionarët françeskanë që lajmojnë për hapjen e shkollave në qëndrat e misionit të tyne, qoftë nga prelatët vendas, çashtja e arësimit shtrohet me të madhe. Hetohet ndër këto materiale dokumentare se bahen përpjekje kudo që famullitarët ma të ditun t’u mësojnë këndim e shkrim çunave dhe pastaj, si të shihet fryti, të dërgohen ndër kolegjet e Italisë: “asht dhanë urdhni që famullitarët, secili prej tyne në famullinë e vet, të kujdesen me u mësue këndimin fëmijve dhe me i bamë të nxanë përmendsh doktrinën e krishtenë, dhe kështu janë tue bamë. Në rasë pastaj se do të themelohej kolegji i thanun, do të jepet urdhni që të rrisin subjekte [djelm] për t’i bamë nxanës. Unë masë tjetër nuk gjej për këta popuj veçse me ngrehë një koleg]” (Vëll. I, Dokum. Nr. 37, fl. 275). Ky problem shtrohet për të gjetë rrugën e shërimit nga padija e madhe ku kishte ra vetë kleri n’ato kohë. Për dioçezin e vet t’Arbënisë, Gjon Kolesi propozon, më 1625, të ndërtohen dy shkolla në vend me nga 10-12 nxanës secila, për t’i përgatitë pastaj për kolegjin e Loretos “sepse kështu do të nxirrej fryt i mrekullueshëm n’ato vende ku s’ka as shkolla as mësues që të mësojnë farë gjaje” (Vëll. I, Dokum. Nr. 24, fl. 66v, pika 2).

Ka shenja se në këtë periudhë rritet interesi për historinë e popullit tonë. Në shekullin e XVII-të prap nëpër Evropë ishin përhapë fjalët se shqiptarët na qenkeshin t’ardhun në kohë të vona nga Albani i Kaukazit. Kemi përshtypjen se termat “lingua epirotica” ose “lingua macedonica”, po ashtu si edhe termat “Epiro” dhe “Macedonia”, që në këtë kohë përdoren n’italishten e në latinishten prej autorësh tanë në botimet e tyne për të tregue “gjuhën shqipe” dhe “Shqipninë”, përveçse nga një traditë e lashtë e lanun trashëgim nga ndamja administrative pas pushtimit romak, e kanë arsyen edhe në shmangien e ndërjegjeshme që autorët tanë e bajnë me qëllim nga fjalet “albanese” dhe “Albania”, për të mos dhanë rasë dyshimi sa kohë që çashtja ishte tue u rrahë nga të dishmit. Përveç kësaj, termat e thanun përdoreshin pikërisht prej autorëve tanë për të provue të kundërtën e “teorive” të reja që i binin shqiptarët banorë të rij të Ballkanit, dhe për të provue pra edhe me ata terma të lashtë se shqiptarët ishin me të vërtetë pasardhësit e epirotëve dhe të maqedonëve, dhe nuk ishin të rij në vendin e vet. Duhet shënue se termat “Iliri” dhe “ilirike” kishin hymë në përdorim për të tregue vendet sllave dalmatine dhe gjuhën e tyne. Në shqipe, përkundra, autorët përdorin fjalët: “arbëresh” dhe “Arbëni”.

Kështu, edhe pas botimit të polemikës së Frang Bardhit me Tomkon për çashtjen e Skanderbeut, çohet shpesh zani ndër këto relacione për të vumë në dukje vetitë e popullit shqiptar dhe të drejtat e tija për të qenë numërue pjesëtar i të mirave kulturele dhe materiale në Ballkan, ashtu sikurse popujt e tjerë fqinj.

Problemin e autoktonisë e trajton edhe Pjetër Mazrreku në relacionin e vjetit 1633, tue mohue kategorikisht thanien e autorëve modernë t'atëhershëm se shqiptarët qenkan aziatikë t'ardhun në kohë të vona. Ekstraktin relativ nga ky relacion, që asht i përfshimë në materialet tona, e botoi edhe M. Rok më 1932.⁸

Kudo pra, në relacionet sikurse në korrespondencën private, pasqyrohet lufta që vazhdon të zhvillohet e ashpër kundër klerit të huej që dërgohej në Shqipni në postet drejtuese.

* * *

Qysh kur u dha më 1610 relacioni i vizitës së Marin Bicit dhe relacioni i Bolicës më 1614, u pa qartë se aksioni i ardhshëm i Propagandës në Shqipni – përveç krahut jugor të zonës së Himarës ku u zhvillue një tjetër aksion misionar me murgët bazilianë – do të kishte interesue të gjithë Shqipninë e Veriut si edhe Shqipninë e Mesme ku kishte popullsi të ritit latin me klerin relativ. Së bashku me këtë shtrimje tokësore nëpër Shqipninë e sotme, materialet tona dokumentare përfshijnë edhe viset veriore e veri-lindore që sot nuk përfshihen mbrenda kufijve politikë të shtetit shqiptar dhe që kanë pasë e kanë popullsi shqiptare.

Në lidhje me çashtjen e shqiptarëve të Kosovës, na do të vrejme se materialet dokumentare të dy vëllimeve tona na dëshmojnë në mënyrë të kjartë dhe të pakundërshtueshme se shumica dërmuese e banorëve në rrethet e Prizrendit e të Jakovës (Gjakovës) ka qenë shqiptare qysh në fillim të shekullit të XVII-të. Nuk bahet fjalë për ndonjë jehonë t'ardhjes së shqiptarëve në këto krahina, as në kohë t'afërta as të largta. Të kishin ngjajtë të tilla shpërngulje masive, relatorët tanë pa tjetër duhet ta kishin thanë, po ashtu sikurse nuk e lanë pa thanë për grupet e shqiptarëve të rij katolike që kanë zanë vend në Novobrdo, Kratovo, Trepçe, Prokopje etj.

Rrethet e Prizrendit dhe të Jakovës, që jurisdiksioni kishtar katolik i përfshinte në dioçezin e Serbisë së Poshtme, janë konsiderue nga relatorët tanë vende shqiptare. Më 1638 fra Kerubini, pasi na flet për gjendjen e rretheve të Jakovës e të Prizrendit, thotë: “Po të shkohet ma tutje dhe të kalohet një mal, gjendet Shkupi, ku nuk kemi shkue sepse asht jashta Shqipnisë” (Vëll. II, Dokum. Nr. 28, fl. 87v). Me fjalë të tjera: krahina e maparshme deri te ai mal konsiderohej dhe ishte Shqipni. Po për këto rrethe të Jakovës e të Prizrendit, Gjergj Bardhi na thotë në një nga relacionet e veta: “Të gjitha këto vende të sipërpërmenduna janë shqiptare dhe flasin po këtë gjuhë. Prej këndeje u nisëm herët dhe u rruguem drejt Serbisë s'Epër” (Vëll. II, Dokum. Nr. 27, fl. 242). Dëshmi të tilla ka vazhdimisht në të gjitha relacionet e këtyne dy vëllimeve tona.

Nxjerrim prandej dy konkluzione me randësi rreth kësaj çashtje që ka qenë shtrua gabimisht nga disa studiozë të cilët kanë mprojtë pikëpamjen se shqiptarët e Kosovës qenkan të shpërngulun nga viset e mbrendshme shqiptare në kohë të vona, dhe pikërisht në fundin e shekullit të XVII-të.

Konkluzioni i parë asht se, me dëshmitë e këtyne materialeve, dhe së paku për rrethet e Jakovës e të Prizrendit, rrëzohet pikëpamja dhe “prova” kryesore e këtyne

⁸ Mario Roques: Le Dictionnaire albanais de 1635 etc. Paris. Libr. Or. F. Gëuthner, 1932, fq., 50.

studiozëve të cilët elementin shqiptar të Kosovës e datojnë vetëm në fundin e shekullit të XVII-të, kurse na po e dëshmojmë që në fillim të këtij shekulli.

Konkluzioni i dytë asht se as në fillim të këtij shekulli nuk kanë ndodhë të tilla shpërngulje, as edhe në kohët e maparshme, sepse shumica dërmuese shqiptare-myslimane asht fshatarësia vendase e islamizuese gjatë pushtimit turk. Dhe ky konstatim vlen të na çojë ma në lindje të dy zonave të Jakovës e të Prizrendit. Kështu në Kosovë elementi shqiptar nuk do të kërkohet vetëm ndër katolikët, por sidomos ndër myslimanët e fushës e të qyteteve. Kur ne p.sh. na dëshmohet se në Has të Prizrendit kanë mbetë vetëm 5 fshate katolike shqiptare dhe 45 të tjera (po ish-katolike shqiptare) kanë qenë islamizue (Vëll. I, Dokum. Nr. 37, fl. 280), dhe po ky autor na thotë: “Asht i banuem prej shqiptarësh” (po aty, fl. 277v), na kemi bindjen se katolikët dhe myslimanët e Kosovës janë shqiptarë, sepse islamizimi (me gjithë termën “turk” që përdorin relatorët dhe që ndokujt i pëlqen ta marrë me vështrim kombësie) nuk ua ndryshon kombësinë atyne që ishin dhe mbetën shqiptarë. Dhe kështu me radhë.

Në qoftë se Kosova, në këto materiale dokumentare, përfshihet nën emërtimin e dioçezit të Serbisë, nuk do të thotë asgja. Kisha katolike përfshinte aso kohe nën dioçezin e Serbisë edhe të gjithë Bullgarinë, me Sofjen, Çiprovacin etj.

Në lidhje pastaj me emërtimin dhe vendosjen e administratës kishtarë nëpër dioçezet e Shqipnisë, materialet tona japin landë të çmueshme, por nuk mendojmë se mund të zgjidhet pështjellimi që kishte mbulue n’atë kohë përsaktësimin e kufijve relativë. Në disa rasë relatorët tanë nuk bajnë veçse ta shtojnë pështjellimin. Na mund të qesim shëmbullin e vendosjes që i ban më 1625 Gjon Kolesi dioçezit t’Arbënisë n’afërsitë e Krujës (Vëll. I, Dokum. Nr. 24) dhe vendosjen që i ban po këtij dioçezi më 1641 dhe pas 1644 Mark Skura i cili e çon në rrethe t’Elbasanit (Vëll. II Dokum. Nr. 36 dhe Nr. 63). Edhe vetë konfliktet për juridiksionin kishtar e kanë burimin te pasaktësia që kishte aso kohe për kufijt dioçezanë, dhe kush ishte i zoti dinte të përfitonte nga ky pështjellim. Dioçezi i Sapës kishte hymë thellë ndër male në luginën e Drinit tue përfshimë zonat e dioçezit të humbun të Sardanjës (Sarda). Dioçezi i Lezhës, tue përfitue nga emërtimi ngjashëm i ish dioçezit Lisiens (në Lis të Matit), ngrehu në këtë zonë pretendimet se i përkisnin atij katundet malore të Mirditës etj. Vetë Farlati-Koleti dioçezin e Lezhës e bajnë njësh me atë të Lisit. Asht punë e vështirë prandej të përsaktësohen kufijt dioçezanë t’asaj kohe. Na mendojmë se, krahas një studimi të veçantë që duhet krye për toponiminë e këtyne relacioneve, për të cilin studim do të flasim ma poshtë, edhe vendosja e juridiksionit të dioçezeve asht objekt për një studim të veçantë.

Edhe vetëm nga relacionet që kanë qenë botue nga studiuesit e ndryshëm, ka qenë dhanë një pasqyrë e zonave ku zhvillohej aksioni i Propagandës, bile disa autorë janë marrë me studimin e toponimisë së kësaj zone.⁹ Por tash, me materialet e reja, ka një pasunim të ndieshëm të dhanash toponomastike, që në shumë rasë plotësojnë dhe sqarojnë njohuni të mbetuna deri tash pezull ose të paqarta. Pavarësisht se të dhanat e reja duhen marrë me synin kritik, gjithnjë ato na hapin rrugën e kërkimeve e të studimeve, pikërisht për t’i marrë në mënyrë kritike. Si nga ana e numrit të toponimave, ashtu dhe nga të dhanat informative mbi ta, materialet e reja janë plotësuese të mira t’atyne që kemi njohun deri sot.

⁹ Na mund të përmendim librin e F. Kordinjanos: “Geogr. Eccl. etc” që merret me gjeografinë kishtarë të Shqipnisë në shek. XVII. Gjithashtu këtë zonë e ka pasqyrue në disa harta gjeografi Coronelli, dhe mbi njenën nga këto harta asht pështetë kryesisht Armao në librin e vet: “Località, chiese etc.”, Roma, Ist. Eur., MCMXXXIII. Në revistat tona pastaj ka pasë aty-këtu ndonjë përsaktësim.

Në lidhje me identifikimin e toponimave, botuesi i perifrazăs së relacionit të Marin Bicit më 1917, tregonte vështirësitë që ka ndeshë (ZANI I SHNA NDOUT, 1917, fq. 52) dhe po të tilla vështirësi shprehte edhe botuesi i relacionit të Pjetër Budit (PËRPARIMI, 1914). Kur të mendojmë se të dy këta botues kanë në qenë në gjendjen ma të mirë për të mbledhë informata mbi toponiminë, dhe megjithatë kanë ngurrue, aq ma tepër bindemi se asht nevoja të kryhet një studim i veçantë në këtë fushë.

Për sa i përket punës sonë, do të rrëfejme se nuk e kemi bamë çashtjen e identifikimit të toponimave objekt të një studimi të veçantë. Pas bindjes sonë, kjo asht një çashtje që lyp specializim, që kërkon t'i kushtohesh për vjetë e vjetë, të bash kërkime të kujdesshme në terren etj.; të gjitha këto na nuk i zotnojmë as nuk i kemi zbatue. Ja çka na rezulton nga një provë që kami bamë në zonën e Ishmit ku kemi pyetë për t'identifikue disa toponima që na dalin në relacionin e Mark Skurës të vjetit 1644, mbi të cilin ka punue edhe F. Kordinjano dhe ka ndërtue indekset e veta:

Chiulesi, i paidentifikuem nga Kordinjano, asht Qullëzi në famullinë e Bizës ndërmjet Drraçit dhe Bizës; sot një kodër si lagje e Bizës.

Derales, *Deralssi*, edhe ky i paidentifikuem; asht Drraçi, Dërraçi, të cilin populli për asimilim të zakonshëm në këtë të folme e thotë ma fort Darraç.

Lalemi, ku përmendet kisha e Shna Prendes, sot asht një tokë e punueme ndërmjet Hamallës, Perlatit, Kullasit e Armathit.

Masagni, që Kordinjano e shkapërcen, asht Mazhja, ndërmjet Mallkuçit e Prezës: Mazhja e madhe e Mazhja e vogël.

Molecuci, *Molacuci*, asht Mallkuçi, si e shqiptojnë vendasit, afër Mazhjes.

Museli, që ka kishën e Shna Krygjes, asht fshati i sotëm Shetaj; ma vonë ky emën i u shtri krejt bishtit që hyn në det, në mënyrë që sot nuk ka ndonjë fshat Muzhël, por me këtë emën thirret krejt bishti që hyn në det deri te kepi i Rodonit (Bishti i Muzhlit).

S. Veneranda sopra la terra d'Argenta, asht Juba e sotme afër Erzenit.

Buitula, nuk asht vetëm afluente i lumit t'Ishmit, si thotë Kordinjano, por edhe një fshat që asht ende sot, afër Prezës. Trajta e sotme asht Butullë, Budull për të dy ...

Pas një vjeti e gjysëm kërkimesh, na u dhanë edhe këto shënime:

Kalvaçe, sot asht një fushë ndërmjet Bubçit dhe Blajit në krye të Merçinës për fund të Butullës.

Sporaj, sot asht Dardha e Sporit afër Shën Lliut, ndërmjet fshatit Gjyricaj dhe Mallkuçit ...

Sollëm sa ma nalt si shëmbull të një pune të madhe që duhet bamë për identifikimin e toponimave që gjenden në materialet tona dokumentare të shekullit të XVII-të.

Se si kemi veprue na me toponiminë dhe me onomastikën e këtyne relacioneve, e themi në parathanie.

* * *

Dëshiroj të kërkoj ndjesë nga lexuesi në se kam gabue në komentet dhe n'interpretimet e mija, dhe do të jem përherë i kënaqun të pranoj sugjerime dhe korrigjime.

I
(1610 - 1634)

INDEKSI

1. **1610, 15 korrik – 1610, 15 luglio**
Letër e Nikollë Mekajshit drejtue Papës për organizimin e luftës çlirimtare në Shqipni.
Lettera di Nicola Mecainsi diretta al Papa per l'organizzazione della guerra di liberazione in Albania.
2. **1610 - 1610**
Relacion i Marin Bicit mbi vizitën e kryeme në dioçezet e Shqipninë dhe të Serbisë.
Relazione di Marino Bizzi in merito alla visita svolta nelle diocesi d'Albania e di Serbia.
3. **1614 - 1614**
Relacion i Mariano Bolicës mbi gjendjen në sanxhakun e Shkodrës.
Relazione di Mariano Bolizza sulla situazione nel sangiacato di Scutari.
4. **1621, 15 maj – 1621, 15 maggio**
Relacion i Gjec Bardhit mbi gjendjen e dioçezit të Sapës (Zadrimë).
Relazione di Giezzi Bianco sulla situazione della diocesi di Sappa (Zadrima).
5. **1621, 15 shtator – 1621, 15 settembre**
Letër e Pjetër Budit drejtue kardinalit Gocadino për organizimin e luftës çlirimtare në Shqipni.
Lettera di Pietro Budi diretta al cardinale Gozzadino per l'organizzazione della guerra di liberazione in Albania.
6. **1623, 1 shkurt – 1623, 1 febbraio**
Letër e D. Andreasit drejtue kardinalit Barberino mbi vdekjen e Pjetër Budit etj.
Lettera di D. Andreassi diretta al cardinale Barberino sulla morte di Pietro Budi ecc.
7. **1623, 28 shkurt – 1623, 28 febbraio**
Letër e B. Orsinit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi vdekjen e Pjetër Budit dhe porosin emnimit e ipeshkvit të ri.
Lettera di B. Orsini diretta alla Congregazione di Propaganda sulla morte di Pietro Budi e raccomanda la nomina di un nuovo vescovo.
8. **1623, 8 mars – 1623, 8 marzo**
Letër e D. Andreasit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi vdekjen e Pjetër Budit dhe porosin emnimit e ipeshkvit të ri.
Lettera di D. Andreassi diretta alla Congregazione di Propaganda sulla morte di Pietro Budi e raccomanda la nomina di un nuovo vescovo.
9. **1623, mars – 1623, marzo**
Letër e B. Orsinit drejtue Kongregacionit të Propagandës po mbi vdekjen e Pjetër Budit dhe mbi nevojën që të emnohet ipeshkvi i ri.
Lettera di B. Orsini diretta alla Congregazione di Propaganda ancora sulla morte di Pietro Budi e sulla necessità della nomina del nuovo vescovo.
10. **1623, 21 prill – 1623, 21 aprile**
Informacion i kardinalit Pjetër Valerio për cilësitë e Gjec Bardhit në lidhje me emnimit e tij ipeshkëv në Sapë.
Informazione del cardinale Pietro Valerio sulle qualità di Giezzi Bianco in riferimento alla sua nomina a vescovo di Sappa.
11. **1623, 4 qershor – 1623, 4 giugno**
Letër e D. Andreasit drejtue në Romë për të përcjellë një relacion dhe për të kërkuar subsid.
Lettera di D. Andreassi diretta a Roma per accompagnare una relazione e per domandare un sussidio.
12. **1623, 4 qershor – 1623, 4 giugno**
Relacion i D. Andreasit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezin e Shkodrës.

Relazione di D. Andreassi diretta alla Congregazione di Propaganda sulla visita svolta nella diocesi di Scutari.

13. 1623, 1 korrik – 1623, 1 luglio

Letër e Pjetër Mazrrekut drejtue në Romë mbi vizitën që ai ka krye në Bullgari etj. dhe mbi vdekjen e ipeshkvit të Sofjes.

Lettera di Pietro Maserecco diretta a Roma sulla visita da lui svolta in Bulgaria ecc. e sulla morte del vescovo di Sofia.

14. 1623, 25 tetor – 1623, 25 ottobre

Letër e D. Andreasit drejtue Kongregacionit të Propagandës me të cilën tregon për vështirësitë që ka gjetë n'administrimin e dioçezit të Shkodrës.

Lettera di D. Andreassi diretta alla Congregazione di Propaganda con cui narra le difficoltà incontrate nell'amministrazione della diocesi di Scutari.

15. 1623, 26 tetor – 1623, 26 ottobre

Dëshmi e tetë priftëve të dioçezit të Shkodrës për të mprojtë ipeshkvin e tyne, D. Andreasin.

Testimonianza di otto preti della diocesi di Scutari per difendere il loro vescovo, D. Andreassi.

16. 1623/1624 – 1623/1624

Pjesë të relacionit të Pjetër Mazrrekut rreth vizitës së tij në dioçezet e Ballkanit.

Estratto dalla relazione di Pietro Maserecco sulla sua visita nelle diocesi dei Balcani.

17. 1624, 20 janar – 1624, 20 gennaio

Letër e arqipeshkvit të Raguzës (Dubrovnikut) drejtue kardinal Ludovizit në lidhje me të hollat e dërgueme për Pjetër Mazrrekun.

Lettera dell'arcivescovo di Ragusa diretta al cardinale Ludovisi in merito al denaro inviato per Pietro Maserecco.

18. 1624, 13 tetor – 1624, 13 ottobre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi çashtje personale dhe për nevojën të hapet një shkollë në Shqipni.

Lettera di Giorgio (Giezzi) Bianco diretta al monsignor Ingoli su questioni personali e sulla necessità di aprire una scuola in Albania.

19. 1624 – 1624

Pjesë e relacionit të B. Orsinit mbi vrasjen e priftit shqiptar Don Markut prej Kishaj (Shkodër).

Estratto della relazione di B. Orsini circa l'uccisione del prete albanese Don Marco da Chisagni (Scutari).

20. 1625, 20 prill – 1625, 20 aprile

Letër e B. Orsinit drejtue në Romë me të cilën ankohet se i ka humbë rrugës relacioni i dërguem, dhe dërgon një tjetër.

Lettera di B. Orsini diretta a Roma con la quale si lamenta per lo smarrimento della relazione inviata, ed invia un'altra.

21. 1625, 15 maj – 1625, 15 maggio

Letër e Pjetër Mazrrekut drejtue në Romë me të cilën justifikon kërkesat e tij për të holla.

Lettera di Pietro Maserecco diretta a Roma con la quale giustifica le sue richieste di denaro.

22. 1625, 24 maj – 1625, 24 maggio

Letër e B. Orsinit drejtue në Romë për disa çashtje të dioçezit të Lezhës dhe ankohet për sjelljen e Gjon Kolesit, ipeshkvit të Arbënisë.

Lettera di B. Orsini diretta a Roma su alcune questioni della diocesi di Alessio e si lamenta della condotta di Giovanni Colessio, vescovo Albanense.

23. 1625, 15 korrik – 1625, 15 luglio

Letër e Pjetër Mazrrekut drejtue Kongregacionit të Propagandës me të cilën lyp të holla për të mujtë me bamë vizitën në dioçezin e Tivarit.

Lettera di Pietro Maserecco diretta alla Congregazione di Propaganda con cui fa richiesta di sussidio per poter svolgere la visita nella diocesi di Antivari.

24. 1625 – 1625

Relacion i Gjon Kolesit mbi dioçezin e Arbënisë.
Relazione di Giovanni Colessio sulla diocesi Albanense.

25. 1628, 27 prill – 1628, 27 aprile

Letër-protestë e klerit të Shkodrës drejtue në Romë kundër arqipeshkvit të Tivarit dhe ipeshkvit të Sapës në lidhje me juridiksionin kishtar.

Lettera di protesta del clero di Scutari diretta a Roma contro l'arcivescovo di Antivari e il vescovo di Sappa in merito alla giurisdizione ecclesiastica.

26. 1628, 20 qershor – 1628, 20 giugno

Relacion i klerit të Shkodrës dhe popullit të famullisë së Barbullushit drejtue Papës dhe Kongregacionit të Propagandës për çashtjen e kishës së Barbullushit.

Relazione del clero di Scutari e dei parrochiani di Barbullusci diretta al Papa e alla Congregazione di Propaganda sulla questione della chiesa di Barbullusci.

27. 1628, 20 qershor – 1628, 20 giugno

Letër e B. Orsinit drejtue Kongregacionit të Propagandës në lidhje me konfliktin për kishën e Barbullushit.

Lettera di B. Orsini diretta alla Congregazione di Propaganda in merito al conflitto sulla chiesa di Barbullusci.

28. 1628, 20 qershor – 1628, 20 giugno

Relacion i klerit të Shkodrës drejtue në Romë në lidhje me konfliktin për kishën e Barbullushit.

Relazione del clero di Scutari diretta a Roma in merito al conflitto sulla chiesa di Barbullusci.

29. 1628, 31 gusht – 1628, 31 agosto

Relacion i Don Vincentit mbi vizitën e B. Orsinit nëpër malësinë e Shkodrës.

Relazione di Don Vincenzo sulla visita di B. Orsini nelle montagne di Scutari.

30. 1629 – 1629

Relacion i B. Orsinit mbi vizitën e bame në dioçezin e Shkodrës.

Relazione di B. Orsini sulla visita svolta nella diocesi di Scutari.

31. 1629 – 1629

Relacion i B. Orsinit mbi vizitën e bame në dioçezin e Lezhës.

Relazioni di B. Orsini sulla visita svolta nella diocesi di Alessio.

32. para 1630 – prima del 1630

Pasqyrë e vendeve shqiptare që nuk i janë nënshtrur sundimit turk dhe numri relativ i shtëpive.

Tabella delle località albanesi non soggette al dominio turco ed il relativo numero delle case.

33. 1630(?) – 1630 (?)

Tetë dëshmi kundër vikarit të Tivarit, Don Pjetër Samuelit, për grindjet që ka me shtëpinë Paskuali.

Otto testimonianze contro il vicario d'Antivari, Don Pietro Samuelli, connesse ai conflitti da lui avuti con la famiglia Pasquali.

34. 1632, 24 shkurt – 1632, 24 febbraio

Relacion i Gjergj Bardhit mbi disa vizita dioçezane të tija.

Relazione di Giorgio Bianchi su alcune sue visite diocesane.

35. 1632, 20 mars – 1632, 20 marzo

Pjesë e letrës së B. Orsinit mbi ankimet e popullit të Pultit kundër një prifti.

Estratto della lettera di B. Orsini per le querele della popolazione di Pulati contro un prete.

36. 1632, 20 mars – 1632, 20 marzo

Përmbledhje e relacionit të B. Orsinit mbi keqpërdorimet e kryeme kundrejt priftit të Pëdhanës.

Riassunto della relazione di B. Orsini sulle persecuzioni compiute contro il prete di Pedana.

37. 1633 – 1633

Relacione të Pjetër Mazrreikut mbi gjendjen e dioçezeve të Shqipnisë dhe të Serbisë dhe veçanërisht mbi nevojët kulturele të popullit shqiptar.

Relazioni di Pietro Maserecco sulla situazioni delle diocesi d'Albania e Serbia e specialmente sui bisogni culturali del popolo albanese.

38. 1634, 25 tetor – 1634, 25 ottobre

Letër e Nikollë Nazakit drejtue në Romë për t'u ankue kundër vikarit të Tivarit.

Lettera di Nicola Nasachi diretta a Roma con cui si lamenta contro il vicario d'Antivari.

39. 1634 – 1634

Relacion i Gjergj Bardhit mbi vizitën e kryeme në malet e Dukagjinit, të Pultit e të Kelmendit.

Relazione di Giorgio Bianchi sulla visita svolta nelle montagne di Ducagini, di Pulati e di Clementi.

Romë, 15 korrik 1610 – Letër e ipeshkvit të Stefanisë, Nikollë Mekajshit, drejtue papës Palit të V-të, në lidhje me luftën e çlirimit në Shqipni.

Roma, 15 luglio 1610 – Lettera del vescovo di Stefania, Nicola Mecainsi, diretta al papa Paolo V° in riferimento alla guerra di liberazione da svolgere in Albania.

(THENIER, Vetera Monum. Slav. Mer., v. II, Dok./Doc. CXXXIV, fq./p. 111)

Alla Santità di Nostro Signore Papa Paolo V.

Beatissimo padre! I principali errori delli principi d'hoggi di è il poco ardimento e gran paura di mettersi a far cosa degna di loro; onde avviene, che una gran felicità, che havreben a godere, non giova a loro, a punto come un letto d'oro non giovaria ad un ammalato. Con tutto ciò, beatissimo padre, io in questa lettera non pretendo di consigliare, nè persuader V.S. regola e legge di tutto 'l mondo; solo le propongo un negotio, che ancor ch'è ricerca gran discorsi, non di meno le parole, ch' escono dalla bocca d'un huomo, devono sommariamente pervenire all'orechie d'un vicario di Christo.

È pur assai noto a V. Beat. che 'l regno d'Albania e della Macedonia è soggetto alla tiranide Turchesca, et in sì misera maniera trattato e governato, che non si può spiegar con parole, quanto sia il desiderio di quei popoli di liberarsi. E di ciò mossi s'unirono insieme i più principali di quel paese, et mi mandaron da V.S. che si degnasse come padre universale, et che desidera l'augumento della christiana religione, volesse et con braccio suo, con aiuto di S.M. ces. se così pero l'haverebe piaciuto, dar loro qualche aiuto a fin che si potessero una volta liberar da quel crudel giogo.

E questo con facilità grande si potrebbe eseguire, essendo che vi si trovano in poco spatio di loco in quei regni più di cinquanta milla huomini d'arme, i quali se bene sono di rito differenti, cioè greco e latino, non di meno d'un linguaggio e parenti di sangue e per matrimonio. Et la virtù loro nelle armi e nelle zuffe è stata tale più volte, che s'è visto per esperienza haver cinque e seicento Albanesi messo

Shenjtisë së Zotit Tonë Papës Palit të V-të.

Atë i lum! Gabimet kryesore të princave të sotëm janë guximi i pakët dhe friga e madhe që të vihen të bajnë një punë të denjë për ta; prandaj ngjan se një lumni e madhe, të cilën mund ta gëzonin, atyne nuk u vlen, po sikurse një krevat florini që nuk do t'i vlenë një të sëmundi. Megjithkëtë, atë i lum, unë me këtë letër s'kem mendën të këshilloj as të bind Sh. Tuej – rregull dhe ligjë e gjithë botës – vetëm po ju propozoj një marrëveshje që, edhe pse kërkon fjalime të mëdha, asgjamangut fjalët që dalin nga goja e një njeriu, duhet t'arrijnë përmbledhtas ndër veshë të një zevendësi të Krishtit.

Mirë e din Lumnia Juej se mbretëria e Shqipnisë dhe e Maqedonisë i asht shtrure tiranisë turke, dhe trajtohet e qeveriset në mënyrë kaq të mjerë, sa nuk mund të thuhet me fjalë cila asht dëshira e atyne popujve për t'u çlirue. Dhe, të nxitun nga kjo, u bashkuen ma kryesorët e atij vendi, dhe më dërguen te Sh. Juej që me krahun me krahun tuej e me ndihmën e M.T. ces.¹, në se ju pëlqen, të denjoheni të dueni si atë i përgjithshëm që dëshiron shtimin e besimit të krishtenë, t'u jepni atyne ndonjë ndihmë që të mund të çlirohen një herë nga ajo zgjedhë mizore.

Dhe kjo do të mund të zbatohet me lehtësi të madhe, tue qenë se, në pak hapësinë vendi, gjenden n'ato mbretëni ma shumë se pesëdhjetë mijë burra armësh të cilët, megjithë-se janë rithesh të ndryshme, d.m.th. grek e latin, megjithatë janë njëj gjuhe dhe t'afërt në gjak e në gjini. Dhe ma shumë se një herë ka qenë e tillë trimnia e tyne n'armë e në përleshje, saqë asht pa me sy si pesë e

¹ Madhnia e tij cesare: perandori i perandorisë së shenjtë romake.

misero in anzi che ho mutatto la mia uera et iusta fede con tutti di mia casa perche non poso piu softiirlio(sic) perche lui soborna li turchi contra di me et io som(sic) pouero non poso piu pattire ne mancho pagarne per le sue bugie non altro resti fellize et bazio le sue sachratte mani azi(sic) sapiatte che som uiuo di collara(sic) ui scriuo in presa (?) Di Vostra Signoria Molto Illustre per seruiria Nicollio Nasachi Di Antiuari 25 8bro 1634.

vërtetë e të drejtë me të gjithë [pjesëtarët] e shtëpisë sime, sepse nuk mund ta duroj ma me që ai ngacmon turqit kundër meje e unë jam i vobektë e nuk mund të vuej ma as të paguej gënjeshtat e tija. Nuk kam tjetër. Të jeni i lum dhe ju puth duert e shenjta. Ta dini se jam mbushë me idhnm (?). Po ju shkruaj me ngut.
I Z. S. etj. etj.
Prej Tivarit, 25 tetor 1634.

39

Relacion i ipeshkvit të Sapës, Gjergj Bardhit, mbi vizitën e kryeme në malet e Dukagjinit, të Pultit e të Kelmendit.

Relazione del vescovo di Sappa, Giorgio Bianchi, sulla visita svolta nelle montagne di Ducagini, di Pulati e di Clementi.

Vjeti 1634

(Arch. Prop. F., Vis. Coll., v. 13, f° 64-67) Anno 1634

f° 64

Alli 8 di Julio 1634

Habbiamo incominciato la Visita delli monti Ducagini Pulati et Clenti(sic)

1. Vila chiamata Calcina ho celebrato messa solene fatto sermone coreto li erori chrismato Anime n° 80, case sarano n° 15. Anime christiane sarano in tutto n° 120. nel qual luogo è la chiesa di San Todoro ruinata per terra, hora lo habiamo fatto di nouo fabricato et coperto ha Possessioni chiesa senza spolie nissuna.

2. Vila chiamata Dusci, in quella è la capela di Santa Maria magdalena coperta senza spolie senza Possessioni nella qualle ho celebrato predicato, chrismato Anime n° 130. case sono n° 42. Anime christiane Sarano in tutto n° 380.

3. Parochia di San Nicolo, in luogo chimato(sic) Dalmatia Residentia del Vescouo (?) cossi si dice per la traditione delli Antichi. Vile son tre cioe Senactu (?) Comani, Buttuci, in quella chiesa alli 9 di Magio ho solenizato quella festa di San Nicolo Predicato chrismato Anime n°. 86 case sono 45. Anime christiane sarano in tutto n° 383 chiesa sotto la nostra cura coperta aueua possessioni et luogo per le cose (case ?) pratti orti fontane pomi, doue si uedeuano gli segni di eser statto per auanti luogo eminente fra tutti quel Mont.

4. Vila di San Paulo chiesa del istesso nome,

fl. 64

Më 8 të korrikut 1634

E kemi fillue vizitën e maleve të Dukagjinit, Pultit e Kelmendit.

1. Katundi i quejtun Këçirë. Kam thanë meshën e madhe e kam bamë predk, kam ndreqë gabimet, kam krezmue 80 frymë. Mund të jenë 15 shtëpi e frymë të krishtena mund të jenë gjithësejt 120. Në këtë vend asht kisha e Shën Teodorit e rrëzue me për dhë; tash e kemi bamë rishtas, ndërtesë e pullaz; kisha ka prona, nuk ka asnjë petk (veshje).

2. Katundi i quejtun Dush. Aty asht kapela e Shën Mërisë Magdalenë, e mbulueme, pa petka, pa prona; aty kam meshue, kam predikue, kam krezmue 130 frymë. Janë 42 shtëpi; mund të jenë gjithësejt 380 frymë të krishtena.

3. Famullia e Shën Kollit në vendin e quejtun Delmace, seli e ipeshkvit, ashtu si thuhet nga tradita e të moçëmve. Janë tri katunde, d.m.th. Senaktu (?), Komani, Bytyçi. N'atë kishë, më 9 të majit, kremtova festën e Shën Kollit, predikova e krezmova 86 shpirtën. Janë 45 shtëpi dhe frymë të krishtena mund të jenë gjithësejt 383. Kisha, e mbulueme nën kujdesin tonë, kishte prona dhe vend për shtëpitë (?); ka livadhe, kopshtije, burime, molla; dhe shiheshin shenjet se përpara kish qenë vend i dalluem ndër të gjitha vendet e atyne maleve.

4. Katundi i Shën Palit e kisha po me atë emën, e

*ruinata cascata per terra che per auanti è statta Abbazia rica con larghe entrade et possessioni orti pratti Arbori frutiferi, hora si troua spoliata di ogni bene parochie di quella chiesa sono restatte pochi christiani la magior parte sono renegati et ano usurpato gli detti beni di detta chiesa in detta chiesa ho coperto la Altare con tapeto ho celebra**(sic)** fatto sermone chrismato Anime n° 85. case sarano n° 38. Anime christiane in tutto sarano n° 320.*

5. Vila chiamata chielesa, ho chrismato Anime n° 25. case sarano n° 8 Anime sono n° 40.

f° 64v

6. Vila chiamata Leuossa, doue ho celebrato, chrismato Anime n° 86 case sono n° 23 Anime christiane in tuto sarano n° 182 aueua chiesa di santa Veneranda coperta senza spolie senza possessioni.

7. Sopagni Vila nel qual luogo era chiesa di Santa Maria Nattiuita coperta in quella ho celebrato predicato et chrismato Anime n° 160 case sarano n° 42 Anime christiane sono n° 386, chiese senza spolie, senza possessioni.

8. Vila chiamata haresta, doue è capela di Santa Veneranda coperta senza spolie senza possessioni ho celebrato chrismato Anime n° 50, case sono 10 Anime christiane sarano n° 86.

9, la Vila chiamata Alscichie era chiesa da Santa Maria scopertaa nella qualle ho celebrato predicato chrismato Anime n° 63 case sono n° 20 Anime christiane n° 192 chiesa con poche possessioni et Vigne.

*10. Vila chiamata Tebruna**(sic)** chiesa di san Giorgio scopertaa con poche possessioni ho celebrato fatto sermone chrismato Anime n° 90 case sono n° 24. Anime christiane sarano n° 220.*

11. La Vila che si chiama Marturi, era chiesa di Santa Maria Asumptio nella qualle ho celebrato predicato et chrismato Anime n° 100 case sono n° 26. Anime christiane sarano n° 230. Chiesa coperta solo sopra la Altare aueua possessioni et poco di Vigne.

12. Gralisti Vila era chiesa di San Giorgio parochiale et capella di San Nicolo et di Santa Veneranda coperte, chiesa Parochiale aueua possessioni Vigne senza spolie in quel luogo ho celebrato predicato chrismato Anime n° 80 case sono 20 Anime christiane n° sono 220.

13. Vila chiamata Aesta chiesa di san Nicolo scopertoa in quella ho celebrato predicato chrismato

rrenueme dhe e rrëzueme për tokë; dhe ma parë ka qenë abaci e pasun, me t'ardhuna të mëdha dhe prona, kopshtije, livadhe, pemë frytore. Tash asht e zveshun nga çdo e mirë. Si famulli e asaj kishe kanë mbetë pak të krishtenë; shumica janë felëshues dhe kanë vumë dorë në pasunitë e thanuna t'asaj kishe. Në këtë kishë mbulovaltarin me një shtroje (tapet), meshova, mbajta fjalim, krezmova 85 vetë. Mund të jenë 38 shtëpi dhe gjithësejt 320 frymë të krishtena.

5. Katundi i quejtun Qelëza. Krezmova 25 vetë. Mund të jenë 8 shtëpi dhe ka 40 frymë.

f. 64v

6. Katundi i quejtun Levosa. Këtu meshova dhe krezmova 86 vetë. Janë 23 shtëpi e gjithësejt mund të jenë 182 frymë të krishtena. Kishte kishën e Shna Prendes të mbulueme, pa petka e pa prona.

7. Sopanji, katund në të cilin ishte kisha e të Lemit të Zojës, e mbulueme. Aty meshova, predikova dhe krezmova 160 vetë. Mund të jenë 42 shtëpi dhe janë 386 frymë të krishtena. Kisha asht pa petka dhe pa prona.

8. Katundi i quejtun Arësta, ku gjendet kapela e Shna Prendes, e mbulueme, pa petka, pa prona. Meshova dhe krezmova 50 vetë. Janë 10 shtëpi e mund të jenë 86 frymë të krishtena.

9. Katundi i quejtun Alshiqe. Ishte kisha e Shën Mërisë, e zbulueme, në të cilën meshova, predikova e krezmova 63 vetë. Janë 20 shtëpi e 192 frymë të krishtena. Kisha [asht] me pak prona e vneshta.

10. Katundi i quejtun Tebruna. Kisha e Shën Gjergjit, e zbulueme, me pak prona. Meshova, mbajta fjalim, krezmova 90 vetë. Janë 24 shtëpi e mund të jenë 220 frymë të krishtena.

11. Katundi që quhet Merturi. Ishte kisha e të Ngjitunit të Zojës në Qiell në të cilën meshova, predikova e krezmova 100 vetë. Janë 26 shtëpi e mund të jenë 230 frymë të krishtena. Kisha asht e mbulueme vetëm mbi altar; kishte prona dhe pak vneshta.

12. Gralista, katund. Ishte kisha famullitare e Shën Gjergjit dhe kapela e Shën Kollit dhe e Shna Prendes, të mbulueme. Kisha famullitare kishte prona e vneshta, por pa petka. N'atë vend kam meshue, predikue dhe krezmue 80 vetë. Janë 20 shtëpi; 220 frymë të krishtena.

13. Katundi i quejtun Aesta. Kisha e Shën Kollit e zbulueme. Në të meshova, predikova dhe

Anime n° 120 case sono n° 25. Anime cristiane sarano n° 210 chiesa senza spolie con poche possessioni.

14. Vila chiamata fiersa era capela di Santa Maria scoperta chiesa di San Micael scoperta ho celebrato chrismato Anime n° 40 case sono n° 8 chiesa con poche possessioni Anime cristiane n° 62.

f° 65

Negli sopra nominati luoghi non ho potuto fondar et colocar altro che un sacerdote che ha cura di sopra scrite Anime cristiane in spiritualibus. &

Hora si ua cominciando la Visita delli Monti di Pulati che la diuide il fiume Drino.

15. Vila chiamata Crastenichie aueua la chiesa di San Giorgio scoperto senza possessioni senza spolie in quella ho celebrato predicato et crismato Anime n° 180 case sono n° 50 Anime cristiane n° 450.

16. Vila Manechiti in detto luogo è la chiesa di San Detrio (sic = Demetrio ?) coperta con possessioni Vigne orti, con un par di Paramenti et altre cose necesarie con che si puo dir la Messa doi capane (sic = campane) rotte qui doi Anni sono che ho stabilito un sacerdote, che ha cura de Anime in detto luogo ho celebrato Predicato chrismato Anime n° 100 case sono n° 20. Anime cristiane in tutto son 210.

17. Vila chiamata Blachee doue era la chiesa di Santa Caterina coperta haueua Una Vigna con poche possessioni numero de Arbori di castagne doue ho celebrato predicato chrismato Anime n° 89 case son 20 Anime cristiane n° 230.

18. Palci Vila, era chiesa di santa Veneranda scoperta senza spolie et senza possessioni, qui ho celebrato predicato chrismato Anime n° 50 case son 10 Anime cristiane n° 83.

19. Vila chiamata Susi, senza chiesa qui ho chrismato Anime n° 50 case sono 10 Anime cristiane n° 90.

20. Lusagni Vila, in quella era la chiesa di santa Soffia poco coperta anticamente Residentia del Vesouo con dotte et Possesioni Vigne et altre cose tutte erano diuentate terre Sauatiche (sic = saluatiche) come cose deserte, qui ho celebrato chrismato Anime n° 23 case erano 9 Anime cristiane n° 40.

f° 65v

21. Vila chiamata Gasci aueuano la chiesa Parochiale San Giorgio coperto capela di San Nicolo

krezmova 120 vetë. Janë 25 shtëpi e mund të jenë 210 frymë të krishtena. Kisha pa petka, me pak prona.

14. Katundi i quejtun Fierza. Ishte kapela e Shën Mërisë e zbulueme, kisha e Shën Mëhillit e zbulueme. Meshova dhe krezmova 40 vetë. Janë 8 shtëpi. Kisha me pak prona. Janë 62 frymë të krishtena.

f. 65

Ndër vendet e sipërthanuna nuk mujta të themeloj (?) e të vendos tjetër veç një meshtar që ka kujdesin shpirtnor të të sipërthanunave frymë të krishtena.

Tashti po shkojmë me nisë vizitën e maleve të Pultit që i ndan lumi i Drinit.

15. Katundi i quejtun Krasniqe. Kishte kishën e Shën Gjergjit të zbulueme, pa prona, pa petka; në të meshova, predikova dhe krezmova 180 vetë. Janë 50 shtëpi dhe 450 frymë të krishtena.

16. Katundi Manekiti (Ançiti). Në këtë vend asht kisha e Shën Demetrit (?) e mbulueme, me prona, vneshta, kopshtije, me një palë petka dhe sende të tjera të nevojshme me të cilat mund të thuhet mesha, me dy kumbonë të thyeme. Ka dy vjetë që këtu kam vendosë një meshtar që ka kujdesin e shpirtnave. Në këtë vend meshova, predikova e krezmova 100 vetë. Janë 20 shtëpi e gjithësejt janë 210 frymë.

17. Katundi i quejtun Blake ku ishte kisha e Shën katrinës e mbulueme; kishte një vneshtë me pak prona, disa rranjë kështenja. Aty meshova, predikova e krezmova 89 vetë. Ishin 20 shtëpi dhe janë 230 frymë të krishtena.

18. Palçi, katund. Ishte kisha e Shna Prendes, e zbulueme, pa petka e pa prona. Këtu meshova, predikova e krezmova 50 vetë. Janë 10 shtëpi dhe 83 frymë të krishtena.

19. Katundi i quejtun Suzi, pa kishë. Këtu krezmova 50 vetë. Janë 10 shtëpi dhe 90 frymë të krishtena.

20. Lushaj, katund. Aty ishte kisha e Shën Sofisë pak e mbulueme, motit seli e ipeshkvit me pajisje e prona, vneshta e sende të tjera. Të gjitha ishin bamë tokë t'egra si gjana të shkretueme. Këtu meshova dhe krezmova 23 vetë. Ishin 8 shtëpi; 40 frymë të krishtena.

f. 65v

21. Katundi i quejtun Gash. Kishin kishën famullitare të Shën Gjergjit të mbulueme, kapelën

coperto capela di Santa Maria coperto, in quella Vila semo trattenuto quatro giorni continuemante celebrando Predicando ogni giorno, le dette chiese senza Possessioni un par de Paramenti calice de Argento doi campane grandi, in quella Vila ho chrismato Anime n° 250, case sono n° 85 Anime christiane n° 820 qui ho trouato tutti usurai alcuni teneuano concubine erano in molti erori et per le continuationi delle Prediche et Scomuniche che ho fatto fra loro molti sono emendati alla uera Penitenza uenuti.

22. Vila chiamata Ripa (?) doue era la chiesa di Santa Veneranda scoperta senza spolie senza Possessioni ho celebrato chrismato Anime n° 50 case sono n° 10 Anime christiane n° 110.

23. Villa chiamata Sciala chiesa di San Nicolo con poche Possessioni senza spolie scoperto, in quella chiesa ho chrismato Anime n° 200 case sono 40 Anime christiane n° 420.

24. Vila chiamata Maurichi chiesa di Santa Veneranda scoperta qui ho celebrato predicato et chrismato Anime n° 160 case sarano n° 36 Anime christiane sono 320.

25. Toplana Vila chiesa di san Nicolo coperto con poche possessioni campane doi una rotta senza spolie in detto luogo ho celebrato predicato, et chrismato Anime n° 40 case sono n° 20 Anime christiane n° 220.

26. Arteuioia Vila, chiesa di Santo mical, con possessioni doi campane scoperta senza spolie senza Possessioni ho celebrato chrismato Anime n° 62 case sono 25 Anime christiane n° 250.

f. 66

27. Vila chiamata Plaia, case erano n° 25 haueua la chiesa di San Giorgio coperto aueua poche possessioni senza spolie ho celebrato et Predicato chrismato Anime n° 86, Anime erano in tutto n° 220.

28. Grada Vila sono case n° 80 era chiesa di san Mertino (?) posesioni uigne erano usurpate, campane una un par di paramenti, calice d'Argento pala d'Altare qui tre giorni ho celebrato predicato et chrismato Anime n° 500 Anime in tutto saranno christiani n. 840.

29. Vila chiamata Castrati case erano n° 70 (?) chiesa di san Nicolo coperto senza spolie, poche possessioni ... chrismato Anime n° 200 Anime in tutto sono 660, Battezzato Anime n° 86.

30. Vila chiamata Zamarati, case sono n° 32 chiesa di santa Veneranda ho celebrato chrismato Anime

e Shën Kollit të mbulueme, kapelën e Shën Mërisë të mbulueme. Në këtë katund jemi ndalë katër ditë, vazhdimisht tue meshue e tue predikue çdo ditë. Kishët e sipërthanuna [janë] pa prona, [kanë] një palë petka, kelq argjanti, dy kumbonë të mëdha. Në këtë katund krezmova 250 vetë. Janë 85 shtëpi; 820 frymë të krishtena. Këtu i gjeta të gjithë fajdexhij, disa mbanin konkubina. Ishin me shumë gabime dhe, me predikime të vazhdueshme e me çkishërime që bana ndër ta, shumë janë ndreqë dhe kanë kthye në pendesën e vërtetë.

22. Katundi i quejtun Ripa (?) ku ishte kisha e Shna Prendes e zbulueme, pa petka, pa prona. Meshova e krezmova 50 vetë. Janë 10 shtëpi dhe 110 frymë të krishtena.

23. Katundi i quejtun Shalë. Kisha e Shën Kollit me pak prona, pa petka, e zbulueme. N'atë kishë krezmova 200 vetë. Janë 40 shtëpi dhe 420 frymë të krishtena.

24. Katundi i quejtun Mauriqi. Kisha e Shna Prendes, e zbulueme. Këtu meshova, predikova e krezmova 160 vetë. Mund të jenë 36 shtëpi dhe 320 frymë të krishtena.

25. Toplana, katund. Kisha e Shën Kollit e mbulueme, me pak prona, me dy kumbonë, njenën të thyeme, pa petka. Në këtë vend meshova, predikova e krezmova 40 vetë. Janë 20 shtëpi me 220 frymë të krishtena.

26. Artivoja, katund. Kisha e Shën Mëhillit që ka dy kumbonë të mëdha, e zbulueme, pa petka, pa prona. Meshova, predikova e krezmova 62 vetë. Janë 25 shtëpi me 250 frymë të krishtena.

f. 66

27. Katundi i quejtun Plaja. Ishin 25 shtëpi. Kishte kishën e Shën Gjergjit të mbulueme. Kishte pak prona, pa petka. Meshova e predikova; krezmova 86 vetë. Ishin gjithësejt 220 frymë.

28. Grada, katund. Janë 80 shtëpi. Ishte kisha e Shën Mertinit. Pronat e vneshtat ia kishin grabitë. Kishte një kumbonë, një palë petka, kelq argjanti, pala altari. Për tri ditë kam meshue këtu, predikova e krezmova 500 vetë. Gjithësejt mund të jenë 840 frymë të krishtena.

29. Katundi i quejtun Kastrat. Ishin 70 (?) shtëpi. Kisha e Shën Kollit e mbulueme, pa petka, me pak prona ... Krezmova 200 vetë. Gjithësejt janë 660 frymë. Pagëzova 86 vetë.

30. Katundi i quejtun Gjamarat. Janë 32 shtëpi. Kisha e Shna Prendes. Meshova e krezmova 265

n° 265, case sono n° 50 Anime cristiane in tutto saranno n° 460. memoria di chiesa santa Veneranda.

31. Vila chiamata Scheriel case sono n° 56 Anime in tutto saranno n° 520, chiesa di san Nicolo con poche possessioni, è quelle erano usurpate la chiesa senza spolie scoperto, in quel luogo ho celebrato chrismato Anime n° 240 ... Battezzato Anime n° 50 &.

32. Vila chiamata Hotti case cristiane erano n° 220 Anime in tutto n° 1100:m. uno cento nissuno non sa di eser mai statto Vescouo in quelle Vile Vechi di 80 che erano chrismati, qui per tre giorni continui ho celebrato predicato chrismato Anime n. 450 Battezzato Anime n° 220 qui era chiesa di santa Veneranda coperto con poche possessioni et Vigne et quelle erano usurpate da alcuni filioli di un certo prete morto et lasciato per heredita gli beni Ecclesiastiche è difficile ora cauarle delle loro mani per eser lori impatroniti tanto tempo
f° 66v

In tutte le sopra nominate Vile et luoghi non si trouano se non doi Sacerdoti gia sopra detti, uno e di 80 Ani inpotente è un altro Zotto li quali malamente possono suplire a quelle Anime in spiritalibus. Et in quelli sopra nominati luoghi si trouano ogni sorte di gente la maggior parte si tenniano per christiani fra quelli erano in alcuni luoghi Turchi renegati le loro moglie erano cristiane, poi si trouano Heretici et scismatici Iddolatri che caminauano uerso sortileghi et indiuationi, et per remediare quelle Anime di tanti damni spirituali era necessario di crear un Vescouo della lingua della Natione et che habia seco almeno quatro ho tre Sacerdoti per suplire le Anime in spiritalibus, et siano prouisti per tre Anni con qualche prouisione fin tanto che incomintiarano eser aiutatti da quelli christiani, et il Vescouo con quelli Sacerdoti doueriano star continuamente fra quelli monti fra quella gente perche come uano il Vescouo et gli Sacerdoti in quelli Monti non possono ritornar di nouo nel loro paise per eser la maggior parte di quella gente rebeli del Turco, et noi altri soggetti Al gran Turco et cossi facendo per poco tempo quella gente hauendo hauto li suoi Aui è Antecessori christiani facilmente diuentarano buoni catholici et per poco tempo si fara grandissi**(sic)** frutto spirituale.

f° 67

Vila chiamata Clementi case sono n° 300. Anime

vetë. Janë 50 shtëpi e gjithësejt mund të jenë 460 frymë të krishtena. Mbahet mend (?) kisha e Shna Prendes.

31. Katundi i quejtun Shkrel. Janë 56 shtëpi e mund të jenë gjithësejt 520 frymë. Kisha e Shën Kollit me pak prona edhe ato të grabituna. Kisha pa petka, e zbulueme. N'atë vend meshova e krezmova 240 vetë ... Pagëzova 50 vetë.

Vëllimi 262: fl. 5-6 – Dok. 21, fl. 10 – 23, fl. 65-67 – 24, fl. 88-89 – 22, fl. 94 – 20, fl. 114 – 26, fl. 116 – 27, fl. 117 – 25, fl. 121 – 28, fl. 128 – 6, fl. 129-131 – 12, fl. 135 – 18, fl. 136 – 15, fl. 139 – 14, fl. 147 – 11, fl. 149 – 13, fl. 161 – 32, fl. 166-167 – 31, fl. 170-173 – 29, fl. 177 – 19, fl. 179-180 – 30, fl. 208 – 17, fl. 222 – 9, fl. 233 – 7, fl. 234 – 8, fl. 288-289 – 33, fl. 465 – 4, fl. 467 – 10.

Vëllimi 263: fl. 232 – 35, fl. 233 – 36, fl. 244-256 – 34, fl. 266-282 – 37, fl. 286 – 38.

b) Fondi Visite e Collegi

Vëllimi 13: fl. 64.67 – 39.

Biblioteka Kombëtare, Tiranë – Dok. 3.

Lenormant – Turcs et Monténégrins, Paris, Didier et C.ie, 1866 – Dok. 3.

Ljubic – shih STARINE XII.

Racki – shih STARINE XX.

STARINE – Starine na sviet izdaje Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti.

Vëllimi XII – Dok. 3.

Vëllimi XX – Dok. 2.

Vëllimi XXXIX – Dok. 16.

Theiner – Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium historiam illustrantia etc. Deprompta et collecta ab Augustino Theiner, Tomus secundus etc. (1524-1800), Edidit Acad. Scient. et Art. Slav. Merid., Zagrabiae etc. 1875. – Dok. 1.

Zamputi – Shih: Buletini për Shk. Shoq., 1958, Nr. 2. – Dok. 5.

AUTORËT E RELACIONEVE E TË KORRESPONDENCËS

Shënim: Numri ma i fortë tregon se asht fjala për një relacion.

ANDREASSI, Domeniko – Ipeshkëv i Shkodrës më 1622. Nuk qëndron në seli veçse pak muej sepse luftohej nga kleri vendas që ka marrë vendim mos të pranojë prelatë të huej. Largohet dhe ia len dioçezin n’administrim Benedikt Orsinit, ipeshkvit të Lezhës – Dok. 6, 8, 11, **12**, 14.

ARQIPESHKVI i Raguzës (Dubrovnikut) – Dok. 17.

BARDHI, Gjec ose Gjergj – Ungji i Frangut. Ipeshkëv i Sapës më 1623, pas vdekjes së Pjetër Budit. Arqipeshkëv i Tivarit më 1636-1643. Pas vdekjes së Frangut (1643) e lëshon selinë e Tivarit dhe kthehet n’atë të Sapës. – Dok. **4**, 18, **34**, **39**.

BIZZI, Marin – Arqipeshkëv i Tivarit dhe vizitator apostolik nëpër Shqipni e Serbi më 1609/1610. – Dok. **2**.

BOLIZZA, Françesk ose Marian – Autori i relacionit të vjetit 1614 njihet Mariani, por ekziston një variant me emnin e Françeskut (shih komentin te teksti i origjinalit). Françesk Bolizza qe nga Kotorri dhe kalorës venedikas. Në gjysmën e parë të shekullit të XVII-të qe kujdestari i misioneve në Shqipni. – Dok. **3**.

BUDI, Pjetër – Nga Guri i Bardhë i Matit, ipeshkëv i Sapës më 1621, vdes i mbytur në lumin e Drinit më 1622 (dhetor). Një nga shkrimtarët e vjetër të shqipes. – Dok. **5**.

KLERI i dioçezit të Shkodrës – Dok. 15, 25, **26**, **28**.

KOLESI, fra Gjon – Nga Shqipnia e Mesme. Ipeshkëv i Arbënisë më 1625-1636. – Dok. **24**.

MAZRREKU, Pjetër – Nga familja e njohun kosovare. Më 1623 vizitator apostolik nëpër Serbi dhe pastaj arqipeshkëv i Tivarit. – Dok. 13, **16**, 21, 23, **37**.

MEKAJSHI, fra Nikolla – Nga Shqipnia e Mesme. Ipeshkëv i Stefanisë dhe një nga eksponentët e lëvizjeve t’armatosuna në kalimin prej shekullit të XVI-të në të XVII-tin. – Dok. **1**.

NAZAKI, Nikolla – Qytetar i Tivarit. – Dok. 38.

ORSINI, Benedikt – Ipeshkëv i Lezhës më 1621. Qëndroi shumë gjatë në këtë seli, deri përtej mesit të shekullit të XVII-të. Administroi për një kohë edhe dioçezin e Shkodrës dhe pastaj edhe atë të Sapës. – Dok. 7, 9, **19**, 20, 22, 27, **30**, **31**, 35, **36**.

VALERIO, kardinal – Dok. 10.

VINCENTI, Don – Sekretari i Benedikt Orsinit. – Dok. **29**.

II
(1634 - 1650)

INDEKSI

11. 1634 - 1634

Pjesë nga relacioni i Bonaventura Palacolos drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi gjendjen në malësinë e Pultit.

Estratto dalla relazione di Bonaventura Palazzolo diretta alla Congregazione di Propaganda sulla situazione nelle montagne di Pulati.

12. 1636, 19 prill - 1636, 19 aprile

Letër e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit rreth grindjeve për juridiksionin kishtar.

Lettera di Marco Scura diretta a monsignor Ingoli sui conflitti per la giurisdizione ecclesiastica.

13. 1636, 4 qershor - 1636, 4 giugno

Letër e Gjergj Bardhit drejtue kardinal Antonit mbi grindjet për juridiksionin kishtar.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al cardinale Antoni sui conflitti per la giurisdizione ecclesiastica.

14. 1636, 7 shtator - 1636, 7 settembre

Letër e Frang Bardhit drejtue imzot Maroldit për t'i tregue pritjen që i ka bamë populli i Zadrimës dhe për t'i shprehë nevojën që ka vendi për njerëz të dijtun.

Lettera di Francesco Bianchi diretta al monsignor Maroldi sull'accoglienza del popolo di Sadrima e sulla necessità che ha il paese d'avere persone colte.

15. 1636, 8 shtator - 1636, 8 settembre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi vizitën në dioçezin e vet, mbi grindjet për juridiksion dhe mbi nevojën për përgatitjen e klerit.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli sulla visita nella propria diocesi, sui conflitti per la giurisdizione e sulla necessità della preparazione del clero.

16. 1636, 8 shtator - 1636, 8 settembre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës në lidhje me grindjet për juridiksionin kishtar ndërmjet dioçezeve të Lezhës e të Arbënisë.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda sui conflitti per la giurisdizione ecclesiastica tra le diocesi di Alessio ed Albanense.

17. 1636, 8 shtator - 1636, 8 settembre

Letër e Frang Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi arritjen në Sapë dhe mbi nevojët e dioçezit.

Lettera di Francesco Bianchi diretta al monsignor Ingoli sul proprio arrivo a Sappa e sulle necessità della diocesi.

18. 1636, 27 tetor - 1636, 27 ottobre

Leter e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit mbi arritjen në seli, mbi pagesat që asht detyrue t'u japë feudalëve dhe mbi grindjet për juridiksionin kishtar.

Lettera di Marco Scura diretta al monsignor Ingoli sul proprio arrivo in sede, sugli sborsi che ha dovuto fare ai feudali e sui conflitti per la giurisdizione ecclesiastica.

19. 1636, nandor-dhetor - 1636, novembre-dicembre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi vizitën që ka krye nëpër dioçezet e veta.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli sulla visita fatta nelle proprie diocesi.

20. 1636, 22 dhetor - 1636, 22 dicembre

Letër e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit për të kërkue subsid dhe për t'u ankue kundër ipeshkvit të Lezhës.

Lettera di Marco Scura diretta al monsignor Ingoli con cui fa richiesta di sussidio e si lamenta contro il vescovo di Alessio.

21. 1636, 22 dhetor - 1636, 22 dicembre

Dëshmi e Mark Skurës për të porositë priftin Gjon Bogdani i cili kërkon ndihma për të ndërtue një kishë.

Certificato di Marco Scura per raccomandare il prete Giovanni Bogdani il quale chiede aiuti per costruire una chiesa.

- 22. 1636, 31 dhjetor – 1636, 31 dicembre**
 Letër e Gjergj Bardhit drejtue në Romë për disa çashtje t'administratës kishtarë.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta in Roma su alcune questioni d'amministrazione ecclesiastica.
- 23. 1636, 31 dhjetor – 1636, 31 dicembre**
 Letër e Gjergj Bardhit drejtue në Romë për disa çashtje t'administratës dhe të jurisdiksionit kishtar.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta in Roma su alcune questioni d'amministrazione e di giurisdizione ecclesiastica.
- 24. 1636, 31 dhjetor – 1636, 31 dicembre**
 Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi vizitën e tij nëpër dioçez të Serbisë.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda sulla sua visita svolta nella diocesi di Serbia.
- 25. 1636, 31 dhjetor – 1636, 31 dicembre**
 Letër-relacion i Gjergj Bardhit mbi konfliktin që ka me ipeshkvin e Lezhës për kishën e Barbullushit.
Lettera-relazione di Giorgio Bianchi sul conflitto con il vescovo di Alessio riguardante la chiesa di Barbulusci.
- 26. 1637, 20 janar – 1637, 20 gennaio**
 Letër e Mark Skurës drejtue në Romë për çashtje t'administratës.
Lettera di Marco Scura diretta in Roma sulle questioni d'amministrazione.
- 27. 1637, 8 shkurt – 1637, 8 febbraio**
 Letër e Frang Bardhit drejtue imzot Ingolit për nevojët e dioçezit të Sapës, për nevojën që të pranohen në kolegji nxanës vendas dhe për një kryengritje të një pashe në jug të Vlonës.
Lettera di Francesco Bianchi diretta al monsignor Ingoli sulle necessità della diocesi di Sappa, sulla necessità che vengano ammessi al collegio degli alunni del paese e su una rivolta di un pascià nel sud di Valona.
- 28. 1637, 8 shkurt – 1637, 8 febbraio**
 Letër-relacion i Frang Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi disa çashtje të dioçezit të Sapës dhe të jurisdiksionit kishtar.
Lettera-relazione di Francesco Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda su alcune questioni della diocesi di Sappa e della giurisdizione ecclesiastica.
- 29. 1637, 7 mars – 1637, 7 marzo**
 Letër e Benedikt Orsinit drejtue në Romë në lidhje me konfliktin për kishën e Barbullushit.
Lettera di Benedetto Orsini diretta in Roma sul conflitto riguardante la chiesa di Barbulusci.
- 30. 1637, 20 prill – 1637, 20 aprile**
 Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi gjendjen e vështirë të dioçezit të Tivarit dhe mbi grindjen për kishën e Barbullushit.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda sulla difficile situazione della diocesi d'Antivari e sul conflitto riguardante la chiesa di Barbulusci.
- 31. 1637, 5 maj – 1637, 5 maggio**
 Letër e Frang Bardhit drejtue në Romë me të cilën porosit D. Pjetër Samuelin dhe shpreh nevojën për dërgimin e nxanësve në kolegji.
Lettera di Francesco Bianchi diretta in Roma con cui raccomanda D. Pietro Samuelli ed esprime la necessità di mandare degli alunni in collegio.
- 32. 1637, 28 maj – 1637, 28 maggio**
 Letër e Frang Bardhit drejtue imzot Ingolit për disa çashtje të dioçezit të Sapës dhe interesohet të futet në kolegji Gjergj Vladanji. Mbi mbledhjen e Blinishtit.
Lettera di Francesco Bianchi diretta al monsignor Ingoli su alcune questioni della diocesi di Sappa e s'interessa di Giorgio Vladagni che venga accolto in collegio. Sulla riunione di Blinisti.

- 33. 1637, 29 maj – 1637, 29 maggio**
 Letër e Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës rreth mbledhjes s'ipeshkvijve në Blinisht.
Lettera di Marco Scura diretta alla Congregazione di Propaganda in merito alla riunione dei vescovi a Blinisti.
- 24. 1637, qershor – 1637, giugno**
 Relacion i Frang Bardhit mbi vizitën e bame në krahinën e Pukës.
Relazione di Francesco Bianchi sulla visita svolta nella regione di Puca.
- 25. 1637, 20 tetor - nandor – 1637, 20 ottobre - novembre**
 Relacion i Gjergj Bardhit mbi vizitën e kryeme në dioçezin e Tivarit.
Relazione di Giorgio Bianchi sulla visita svolta nella diocesi d'Antivari.
- 26. Rreth 1627 – Circa 1637**
 Pasqyrë e bame nga Gjergj Bardhi mbi gjendjen dioçezane në dioçez të Serbisë së poshtme dhe t'epër.
Prospetto compilato da Giorgio Bianchi sulla situazione nella diocesi della Serbia inferiore e superiore.
- 27. 1638, 11-20 shkurt – 1638, 11-20 febbraio**
 Relacion i Gjergj Bardhit mbi vizitën në dioçezin e Serbisë së poshtme.
Relazione di Giorgio Bianchi sulla visita nella diocesi della Serbia inferiore.
- 28. 1638, 27 mars – 1638, 27 marzo**
 Relacion i fra Kerubinit mbi gjendjen e misioneve në Shqipni dhe mbi gjendjen ekonomike, politike e shoqnore të Shqipnisë.
Relazione di fra Cherubino sulla situazione delle missioni in Albania, sulla situazione economica, politica e sociale dell'Albania.
- 29. 1638, maj-gusht – 1638, maggio-agosto**
 Relacion i Gjergj Bardhit mbi vizitën e kryeme në dioçez të Shkodrës, të Sapës e në Lezhë.
Relazione di Giorgio Bianchi sulla visita svolta nelle diocesi si Scutari, di Sappa e in Alessio.
- 30. 1638, qershor – 1638, giugno**
 Relacion i Frang Bardhit mbi vizitën e kryeme në Spas, Iballe, Pult dhe mbi ekspeditën e Vuço pashës në Kelmend.
Relazione di Francesco Bianchi sulla visita svolta in Spassi, Iballeia e Pulati e sulla spedizione di Vuco pascià sui Clementi.
- 31. 1638, qershor – 1638, giugno**
 Letër e Frang Bardhit drejtue Papës për të kërkuar subsid.
Lettera di Francesco Bianchi diretta al Papa con cui chiede sussidio.
- 32. 1638/1639 – 1638/1639**
 Relacione të Gjergj Bardhit mbi vizitat e kryeme në dioçez të Tivarit dhe të Serbisë.
Relazioni di Giorgio Bianchi sulle visite svolte nella diocesi d'Antivari e della Serbia.
- 33. 1638 – 1638**
 Pjesë nga relacioni i Françesk Leonardisit mbi dioçezet e Serbisë dhe të Shqipnisë.
Estratto dalla relazione di Francesco Leonardis sulle diocesi della Serbia e dell'Albania.
- 34. 1641, 19 prill – 1641, 19 aprile**
 Relacion i Frang Bardhit paraqitë Papës mbi gjendjen në Zadrinë.
Relazione di Francesco Bianchi presentata al Papa sulla situazione in Sadrina.
- 35. 1641, 19 prill – 1641, 19 aprile**
 Relacion i Frang Bardhit mbi dioçezin e Zadrinës.
Relazione di Francesco Bianchi sulla diocesi di Sadrina.
- 36. 1641, 20 dhjetor – 1641, 20 dicembre**
 Relacion i Mark Skurës mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezet e Shqipnisë së Mesme.
Relazione di Marco Scura sulla visita svolta nelle diocesi dell'Albania Centrale.
- 37. 1641-1642 – 1641-1642**

Relacion i Gjergj Bardhit mbi vizitat e tija nëpër dioçezet e Serbisë.
Relazione di Giorgio Bianchi sulle sue visite nelle diocesi della Serbia.

38. 1643, 12 janar – 1643, 12 gennaio

Letër e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit për çashtje të subsidit etj.
Lettera di Marco Scura diretta al monsignor Ingoli per questioni di sussidio ecc.

39. 1643, 2 shkurt – 1643, 2 febbraio

Letër e Mark Skurës drejtue në Romë për të kërkue emnimin e fra Simonit ipeshkëv ndihmës.
Lettera di Marco Scura diretta in Roma per chiedere la nomina di fra Simone vescovo coadiutore.

40. 1643, 2 shkurt – 1643, 2 febbraio

Letër e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit mbi nevojën t'ëmnohet një ipeshkëv ndihmës.
Propozon Simon Sumën.
Lettera di Marco Scura diretta al monsignor Ingoli sulla necessità della nomina di un vescovo coadiutore. Propone Simone Suma.

41. 1643, 4 shkurt – 1643, 4 febbraio

Letër e Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës po për të kërkue emnimin e fra Simon Sumës ipeshkëv ndihmës.
Lettera di Marco Scura diretta alla Congregazione di Propaganda in cui lo stesso chiede la nomina di fra Simone Suma vescovo coadiutore.

42. 1643, 10 qershor – 1643, 10 giugno

Letër e Mark Skurës drejtue në Romë për të kërkue subsidin dhe emnimin e një ipeshkvi në Kanovë (Shqipni e Mesme).
Lettera di Marco Scura diretta in Roma per chiedere il sussidio e la nomina di un Vescovo in Canovia (Albania Centrale).

43. 1643, 14 gusht – 1643, 14 agosto

Interdikti që Gjergj Bardhi i ven kishës së Dejës sepse populli nuk paguen detyrimet ndaj ipeshkvit.
Interdetto che Giorgio Bianchi mette alla chiesa di Dagno perché il popolo non paga i debiti verso il vescovo.

44. 1643, 29 gusht – 1643, 29 agosto

Letër e Gjergj Bardhit drejtue në Romë me të cilën kërkon të kthehet në Sapë mbasi ka vdekur Frang Bardhi.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta in Roma con cui chiede di ritornare a Sappa dopo la morte di Francesco Bianchi.

45. 1643, 1 shtator – 1643, 1 settembre

Urdhnesë e Gjergj Bardhit që populli i Zadrimës t'i paguejë detyrimet e drithit për ipeshkvin.
Monitorio di Giorgio Bianchi perché il popolo di Sadrina paghi gli obblighi del cereale per il vescovo.

46. 1643, 15 shtator – 1643, 15 settembre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit me të cilën kërkon të kthehet në selinë e Sapës.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli con cui chiede il ritorno alla sede di Sappa.

47. 1643, 16 tetor – 1643, 16 ottobre

Letër e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit mbi rreziqet që i kërcënohen katedrales së Durrësit. T'ëmnohet ipeshkëv Simon Suma.
Lettera di Marco Scura diretta al monsignor Ingoli sui pericoli che minacciano la cattedrale di Durazzo. Che venga nominato vescovo Simone Suma.

48. 1643, 25 tetor – 1643, 25 ottobre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit për të kërkue emnimin e vet në dioçe të Sapës etj.
Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli in cui chiede la propria nomina nella diocesi di Sappa ecc.

49. 1643, 16 nandor – 1643, 16 novembre

Letër e Mark Skurës drejtue Papës me të cilën kërkon lejen të shugurojë meshtar një frat laik.

Lettera di Marco Scura diretta al Papa con cui chiede il permesso di consacrare sacerdote un frate laico.

50. 1643, 18 dhjetor – 1643, 18 dicembre

Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës për emnimin e vet në Sapë dhe të Leonardisit në Tivar.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda sulla propria nomina in Sappa e di Leonardis in Antivari.

51. 1644, 31 janar – 1644, 31 gjenario

Letër e Gjergj Bardhit drejtue në Romë për kalimin e vet nga selia e Tivarit n'atë të Sapës. Kërkon subsid etj.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta in Roma per il proprio trasferimento dalla sede di Antivari in quella di Sappa. Chiede sussidio ecc.

52. 1644, 2 shkurt – 1644, 2 febreario

Letër e Mark Skurës drejtue imzot Ingolit për emnimin e fra Lekë Luçit ipeshkëv në Pult.

Lettera di Marco Scura diretta al monsignor Ingoli per la nomina di fra Alessandro Lucci vescovo in Pulati.

53. 1644, 29 mars – 1644, 29 mars

Letër e Gjergj Bardhit drejtue vikarit të Shkodrës për çashtje të jurisdiksionit kishtar.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al vicario di Scutari su questioni di giurisdizione ecclesiastica.

54. 1644, 15 prill – 1644, 15 aprile

Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës që të lihet i qetë në Sapë mbasi ka heqë dorë nga selia e Tivarit.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda con cui chiede d'essere lasciato tranquillo in Sappa avendo rinunciato alla sede d'Antivari.

55. 1644, prill – 1644, aprile

Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi nevojët e shërbimit fetar në malet e Dukagjinit.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda in merito alla necessità del servizio religioso nelle montagne di Ducagini.

56. 1644, prill – 1644, aprile

Letër e Gjergj Brdhit drejtue imzot Ingolit mbi administrimin e vet kishtar. Zi buke në Zadrimë. Kërkon subsid.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli sulla sua amministrazione ecclesiastica. Carestia in Sadrima. Chiede sussidio.

57. 1644, 2 maj – 1644, 2 maggio

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi transferimin e vet nga selia e Tivarit n'atë të Sapës.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli sul proprio trasferimento dalla sede d'Antivari in quella di Sappa.

58. 1644, 2 maj – 1644, 2 maggio

Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës për ta falënderue sepse e kanë shënue në dioçez të Sapës.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda con cui ringrazia di averlo destinato alla sede di Sappa.

59. 1644, 2 maj – 1644, 2 maggio

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit për t'ia lëshue Leonardisit selinë e Tivarit.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli per cedere a Leonardis la sede di Antivari.

60. 1644, 10 qershor – 1644, 10 giugno

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi administrimin e vet kishtar.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli sulla sua amministrazione ecclesiastica.

61. 1644, 10 qershor – 1644, 10 giugno

Letër e Gjergj Bardhit drejtue Kongregacionit të Propagandës po mbi administrimin e vet kishtar.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta alla Congregazione di Propaganda lo stesso sulla sua amministrazione ecclesiastica.

62. 1644, 15 korrik – 1644, 15 luglio

Letër e Gjergj Bardhit drejtue imzot Ingolit mbi administrimin e vet, mbi ngushticën në të cilën gjendet, mbi misionarët dhe mbi ipeshkvin e Lezhës.

Lettera di Giorgio Bianchi diretta al monsignor Ingoli sulla sua amministrazione, sulla strettezza in cui si trova, sui missionari e sul vescovo di Alessio.

63. Pas 1644 – Dopo 1644

Relacion i Mark Skurës mbi vizitën e kryeme nëpër dioçezet e Shqipnisë së Mesme.

Relazione di Marco Scura sulla visita svolta nelle diocesi dell'Albania Centrale.

64. 1645 – 1645

Relacion i Mark Skurës mbi vizitën e jashtëzakonshme nëpër dioçezet e Shqipnisë së Mesme.

Relazione di Marco Scura sulla visita straordinaria nelle diocesi dell'Albania Centrale.

65. 1647, 14 nandor – 1647, 14 novembre

Letër e Gjergj Vladanajt me të cilën porositi shqiptarët të mos u besojnë venedikasve.

Lettera di Giorgio Vladagni con cui raccomanda agli albanesi di non prestar fede ai veneziani.

66. 1648, 27 maj – 1648, 27 maggio

Dëshmi e fra Kerubinit mbi pamundësinë e ipeshkvit të Sapës për t'u kthye në selinë e vet.

Certificato di fra Cherubino sull'impossibilità del vescovo di Sappa di far ritorno nella propria sede.

67. 1648, 29 qershor – 1648, 29 giugno

Dëshmi e Mark Skurës mbi pamundësinë e klerikëve të vijnë në Shqipni.

Certificato di Marco Scura sull'impossibilità degli ecclesiastici di venire in Albania.

68. 1649, 10 prill – 1649, 10 aprile

Letër e Mark Kryeziut drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi pamundësinë që të hyjë në Shqipni.

Lettera di Marco Crisio diretta alla Congregazione di Propaganda sull'impossibilità di entrare in Albania.

69. 1649, 1 maj – 1649, 1 maggio

Letër e dy ipeshkvijve të Shqipnisë drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi pamundësinë që të kthejnë në selitë e veta.

Lettera di due vescovi d'Albania diretta alla Congregazione di Propaganda sull'impossibilità di ritornare alle proprie sedi.

70. 1649, 9 maj – 1649, 9 maggio

Letër e vikarit të Budues drejtue kardinal Kaponit me të cilën kërkon leje tëshugurojë meshtarë para afatit të moshës.

Lettera del vicario di Budua diretta al cardinale Capponi con cui chiede il permesso di consacrare preti prima del termine dell'età.

71. 1649, 15 qershor – 1649, 15 giugno

Letër e Françesk Bolicës drejtue sekretarit të Kongregacionit të Propagandës mbi shërbimin që u ka sjellë dhe u sjell misioneve në Shqipni.

Lettera di Francesco Bolizza diretta al segretario della Congregazione di Propaganda sul servizio che ha portato e porta alle missioni in Albania.

72. 1649, 24 qershor – 1649, 24 giugno

Letër e Gjergj Vladanajt drejtue në Romë mbi përpjekjet për të hymë në Shqipni.

Lettera di Giorgio Vladagni diretta in Roma sugli sforzi per entrare in Albania.

73. 1649, 2 korrik – 1649, 2 luglio

Letër e krenëve të Tivarit drejtue Kongregacionit të Propagandës për t'u ankue ndaj veprimeve t'arqipeshkvit Bonaldi.

Lettera dei capi d'Antivari diretta alla Congregazione di Propaganda con cui si lamentano verso le azioni dell'arcivescovo Bonaldi.

74. 1649, 28 gusht – 1649, 28 agosto

Letër e Anton Tomës drejtue Kongregacionit të Propagandës për t'u ankue ndaj arqipeshkvit Bonaldi.

Lettera di Antonio Toma diretta alla Congregazione di Propaganda con cui si lamenta verso l'arcivescovo Bonaldi.

75. 1649, 1 shtator – 1649, 1 settembre

Letër e Jacint Sospelos drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi persekutimet që pësojnë misionet në Shqipni.

Lettera di Giacinto Sospello diretta alla Congregazione di Propaganda sulle persecuzioni che subiscono le missioni in Albania.

76. 1649, 2 shtator – 1649, 2 settembre

Letër e J. Bonaldit drejtue në Romë për të kërkuar lejen të shugurojë meshtarë para afatit të moshës.

Lettera di G. Bonaldi diretta in Roma per ottenere il permesso per consacrare sacerdoti prima del termine dell'età.

77. 1649, 6 shtator – 1649, 6 settembre

Letër e Gjon Paskualit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi veprën e vet ndër besimtarët e ritit grek.

Lettera di Giovanni Pasquali diretta alla Congregazione di Propaganda sulla sua attività fra i fedeli di rito greco.

78. 1649, 20 shtator – 1649, 20 settembre

Letër e fra Donatit drejtue në Romë mbi veprimet e këqija t'arqipeshkvit të Tivarit etj.

Lettera di fra Donato diretta in Roma sulle cattive azioni dell'arcivescovo d'Antivari ecc.

79. 1649, 7 dhjetor – 1649, 7 dicembre

Letër e Françesk Bolicës drejtue kardinal Kaponit rreth një harte të Shqipnisë dhe mbi misionet në Shqipni.

Lettera di Francesco Bolizza diretta al cardinale Capponi in merito ad una carta geografica dell'Albania e sulle missioni in Albania.

80. 1649, 17 dhjetor – 1649, 17 dicembre

Letër e Françesk Bolicës drejtue në Romë për kthimin e misionarëve në Shqipni.

Lettera di Francesco Bolizza diretta in Roma sul ritorno dei missionari in Albania.

81. 1649, 19 dhjetor – 1649, 19 dicembre

Letër e Françesk Bolicës drejtue kardinal Kaponit mbi mënyrën se si mund të kthejnë misionarët në Shqipni.

Lettera di Francesco Bolizza diretta al cardinale Capponi sul modo come possono tornare i missionari in Albania.

82. 1649, 28 dhjetor – 1649, 28 dicembre

Letër Françesk Bolicës drejtue kardinal Kaponit rreth hartës së Shqipnisë dhe propozon Ndre Bogdanin në selinë e Ohrit.

Lettera di Francesco Bolizza diretta al cardinale Capponi in merito alla carta geografica dell'Albania e propone Andrea Bogdani alla sede d'Ocrida.

83. 1649 (?) – 1649 (?)

Letër e Gjergj Vuskoviqit drejtue Kongregacionit të Propagandës me të cilën kërkon ndihmë dhe një vend për nipin e tij në kolegji.

Lettera di Giorgio Vuscovich diretta alla Congregazione di Propaganda con cui chiede aiuto e un posto per suo nipote nel collegio.

84. 1649 (?) – 1649 (?)

Lutje e dy ipeshkvijve të Shqipnisë n'arrati për të nxjerrë subsidet.
Supplica di due vescovi dell'Albania in esilio per ottenere i sussidi.

85. 1649 (?) – 1649 (?)

Lutje e ipeshkvit të Shkodrës për të nxjerrë një tjetër seli.
Supplica del vescovo di Scutari per ottenere un'altra sede.

86. 1650, 8 janar – 1650, 8 gennajo

Letër e komunitetit të Tivarit drejtue Kongregacionit të Propagandës me të cilën ankohen ndaj arqipeshkvit Bonaldi.
Lettera della comunità d'Antivari diretta alla Congregazione di Propaganda con cui si lamentano contro l'arcivescovo Bonaldi.

87. 1650, 10 janar – 1650, 10 gennajo

Letër e fra Donat Jeliq drejtue Kongregacionit të Propagandës për të futë nipin në kolegji dhe ankohet kundër arqipeshkvit Bonaldi.
Lettera di fra Donato Jelich diretta alla Congregazione di Propaganda per sistemare il nipote in collegio e si lamenta contro l'arcivescovo Bonaldi.

88. 1650, 7 mars – 1650, 7 marzo

Relacion i Jacint Sospelos dhe Benedikt Trevizanos mbi gjendjen e misioneve në Shqipni.
Relazione di Giacinto Sospello e di Benedetto Trevisano sulla situazione delle missioni in Albania.

89. 1650, 3 prill – 1650, 3 aprile

Letër e fra Donat Jeliqit drejtue në Romë për transferimin e arqipeshkvit të Tivarit në një seli tjetër.
Lettera di fra Donato Jelich diretta in Roma per il trasferimento dell'arcivescovo d'Antivari in un'altra sede.

90. 1650, 23 prill – 1650, 23 aprile

Letër e Françesk Bolicës drejtue kardinal Kaponit me të cilën propozon emnin e Gjergj Vladanajt n'Ohër.
Lettera di Francesco Bolizza diretta al cardinale Capponi con cui propone la nomina di Giorgio Vladagni in Ocrida.

91. 1650, 10 qershor – 1650, 10 giugno

Dëftesë e fra Sospelos për disa orendi kishtare.
Ricevuta di fra Sospello per alcuni oggetti sacri.

92. 1650, 12 qershor – 1650, 12 giugno

Letër e Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi kërcënimin e turqve për ta shndërrue selinë e Kurbinit në fortesë.
Lettera di Marco Scura diretta alla Congregazione di Propaganda sulla minaccia dei turchi di trasformare la sede di Corbino in fortezza.

93. 1650, 12 qershor – 1650, 12 giugno

Letër e Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës me të cilën propozon D. Nikollë Korpenin për ipeshkëv të Arbënisë.
Lettera di Marco Scura diretta alla Congregazione di Propaganda con cui propone D. Nicola Corpeni come vescovo Albanense.

94. 1650, 4 korrik – 1650, 4 luglio

Pjesë nga letra e fra Donat Jeliqit drejtue në Romë në lidhje me mundësitë për kthimin në Shqipni.
Estratto dalla lettera di fra Donato Jelich diretta in Roma in merito alle possibilità per il ritorno in Albania.

95. 1650, 7 korrik – 1650, 7 luglio

Letër e Gjon Krizostomit nga Gallata dejtue në Romë me të cilën nuk pranon të kthehet në misionin e maparshëm në Shqipni.

Lettera di Giovanni Crisostomo da Gallata diretta in Roma con cui non accetta di ritornare alla primiera missione in Albania.

96. 1650, 8 korrik – 1650, 8 luglio

Letër e Benedikt Orsinit drejtue në Romë mbi shtegtimet e tija nëpër male dhe mbi veprën e keqe të misionarëve.

Lettera di Benedetto Orsini diretta in Roma sulle sue peregrinazioni fra i monti e sul cattivo operato dei missionari.

97. 1650, 23 korrik – 1650, 23 luglio

Letër e arqipeshkvit të Pizës drejtue kardinal Kaponit me të cilën dërgon informacion mbi Gjergj Vladanjin.

Lettera dell'arcivescovo di Pisa al cardinale Capponi con cui invia informazione su Giorgio Vladagni.

98. 1650, 23 korrik – 1650, 23 luglio

Informacion mbi Gjergj Vladanjin.

Informazione su Giorgio Vladagni.

99. 1650, 25 korrik – 1650, 25 luglio

Letër e Françesk Bolicës drejtue kardinal Kaponit me të cilën porosit të ndihmohet Mark Skura.

Lettera di Francesco Bolizza diretta al cardinale Capponi con cui raccomanda di essere aiutato Marco Scura.

100. 1650, 30 korrik – 1650, 30 luglio

Lutje e disa tivarasve për të kërkue emnimin në selinë e arqipeshkvisë fra Donat Jeliqin.

Supplica di alcuni antivarini con cui chiedono la nomina nella sede arcivescovile di fra Donato Jelich.

101. 1650, 24 shtator – 1650, 24 settembre

Letër e Françesk Bolicës drejtue kardinal Kaponit mbi vështirësitë për futjen e misionarëve në Shqipni.

Lettera di Francesco Bolizza diretta al cardinale Capponi sulle difficoltà d'introdurre i missionari in Albania.

102. 1650, 2 tetor – 1650, 2 ottobre

Letër e Jacint Sospelos drejtue në Romë mbi mënyrën se si do të rivendosen misionet në Shqipni.

Lettera di Giacinto Sospello diretta in Roma sul modo in cui si ristabiliranno le missioni in Albania.

103. 1650, 4 nandor – 1650, 4 novembre

Letër e fra Donat Jeliqit drejtue Kongregacionit të Propagandës mbi pamundësinë e misionarëve të huej për të hymë në Shqipni.

Lettera di fra Donato Jelich diretta alla Congregazione di Propaganda sull'impossibilità dei missionari stranieri di entrare in Albania.

104. 1650 (?) – 1650 (?)

Kërkesa të prefektit të misioneve për vazhdimin e veprimit misionar në Shqipni.

Domande del prefetto delle missioni per continuare l'azione missionaria in Albania.

105. 1650 (?) – 1650 (?)

Kërkesa të prefektit të misioneve po për vazhdimin e veprimit misionar në Shqipni.

Domande del prefetto delle missioni lo stesso per continuare l'azione missionaria in Albania.

106. 1650 (?) – 1650 (?)

Lutje e fra Xhuzepe del Akulia për të qenë emnue ipeshkëv i Pultit (?).

Supplica di Giuseppe dell'Aquila per essere nominato vescovo di Pulati (?).

107. 1650 (?) – 1650 (?)

Lutje e Nikollë Korpenit për të kërkue subsid.

Supplica di Nicola Corpeni per chiedere sussidio.

108. 1650 (?) – 1650 (?)

Lutje e Nikollë Korpenit po për të nxjerrë subsid etj.
Supplica di Nicola Corpeni lo stesso per ottenere sussidio ecc.

109. 1650 (?) - 1650 (?)

Lutje e Simon Sumës për t'i lëshue selinë e Zadrimës Ndre Bogdanit dhe ai vetë për të shkue n'Ohër.

Supplica di Simone Suma per cedere la sede di Sadrima ad Andrea Bogdani e lui stesso andare ad Ocrida.

110. 1650 (?) - 1650 (?)

Letër e Mark Skurës drejtue në Romë mbi ngushticën e vet ekonomike.

Lettera di Marco Scura diretta in Roma sulla sua strettezza economica.

111. 1650 (?) - 1650 (?)

Kërkesë e Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës për disa orendi kishtare.

Richesta di Marco Scura diretta alla Congregazione di Propaganda riguardante alcuni oggetti sacri.

112. 1650 (?) - 1650 (?)

Letër e Mark Skurës drejtue Kongregacionit të Propagandës me të cilën kërkon subsid.

Lettera di Marco Scura diretta alla Congregazione di Propaganda con cui richiede sussidio.

113. 1650 (?) - 1650 (?)

Promemorje e Simon Sumës për nxjerrjen e disa fakulteteve.

Pro-memoria di Simone Suma per ottenere alcune facoltà.

114. 1650-1651 - 1650-1651

Relacion i Grigor Mazrrekut mbi gjendjen në famullitë e Prizrendit.

Relazione di Gregorio Massarechi sulla situazione nelle parrocchie di Priseren.

Pjesë nga relacioni i prefektit të misioneve në Shqipni, Bonaventura Palacolo, drejtue Kongregacionit të Propaganda Fide. Mbi gjendjen në malësinë e Pultit.

Estratto dalla relazione del prefetto delle missioni in Albania, Bonaventura Palazzolo, diretta alla Congregazione di Propaganda Fide. Sulla situazione nelle montagne di Pul

(Arch. Prop. F., SRCG, a. 1630-1639, Vjeti 1634
v. 263, f° 16v-17 – CORDIGNANO, G. Anno 1634
Eccl. Alb., p. 245/21)

Li popoli di Pullati sono numerosi et bellicosi per la penuria di preti son alcuni fatti Turchi ma pochissimi questi Pullati fanno più di uintimilla anime cristiane han solo doi sacerdoti uno penso non possa moversi di terra per la vecchieza. Questi Pullati pochi mesi sonno fecero un fatto d'arme con gran lacrime de Turchi. Sendo alcuni anni ch'essi pollati non pagan tributo: Un Sangiaco qual in Constantinopoli era stato spogliato del suo danaro in gran somma, acio si ristorasse fu fatto Sangiacho di Scuttari di Zadrime de Pullati e d'altre parti. Congrego questo Sangiaco una grossa armata, di soldati cristiani, e di soldati Turchi, molto ricusarono li cristiani di non andare a guerreggiare contro cristiani; ma il Sangiaco uolse andassero. Quando il Sangiaco gionse con sua armata nel principi(o) de pullati fece sonar la tromba, o che li pollati dessero 60 persone schiave e tanti denari, o che uoleua rouinarli. E huomini pullati (da)lla casa oue alloggiava il Sangiaco corsero ad aiutare li cristiani capi delle uille de pollati. Onde subito si congregaron li suddetti cappi nella Chiesa di San Pantaleone iui aperto il messale giuraron di andare tutti li cristiani pollati habili a portare arme, contro Turchi e di non perdonarla à qual sfugisse di uenire ad essa guerra contro Turchi, anzi taliarli (in) pezzi bruciarli la casa; subito e grandi e picioi in una notte furono uniti in arme, e uenuti uicin al Sangiaco, gridaron essi pullati ad alta uoce: o Cristiani quali sette nell'armata del Sangiaco separateui dalli Turchi, e quelli cristiani quali non pon separarsi diano qualche segno. Subito molte

Popujt pultjanë janë me shumicë dhe luftarakë. Nga mungesa e priftënve disa janë bamë turq, por shumë pak. Këta, pultjanët, bahen ma shumë se njëzetmijë frymë të krishtena; kanë vetëm dy priftën, por, mendoj, se njeni nuk mund të lëvizë nga vendi prej pleqnie. Këta, pultjanët, pak muej ma parë, banë një përlshje t'armatosun tue u shkaktue shumë lot turqve. Kishte disa vjet që pultjanët nuk po paguenin haraçin. Një sanxhakbe – i cili në Stamboll kish qenë çveshë nga një shumë e madhe të hollash – për të mujtë me u përtri, qe ba sanxhakbe i Shkodrës, i Zadrimes, i Pultit dhe i viseve të tjera. Ky sanxhakbe mblodhi një ushtri të madhe me ushtarë të krishtenë dhe turq. Të krishtenët kundërshtuen shumë që mos të shkonin për të luftue kundër të krishtenëve; por sanxhakbeu desh të shkonin. Kur sanxhakbeu arriti me ushtrinë e vet në hymje të Pultit, bani të binte buria¹: ose pultjanët të jepnin 60 vetë skllavë dhe një shumë të hollash, ose ai do t'i rrenonte. Dhe njerëzit pultjanë², nga shtëpia ku kish zanë vend sanxhabeu, vrapuen për t'u dhanë ndihmë krenëve të krishtenë të katundeve të Pultit. Kështu menjëherë krenët e sipërthanun u mblodhën në kishën e Shën Pantaleonit dhe aty, si hapën ungjillin, u betuen³ të shkonin të gjithë të krishtenët pultjanë, t'afte për armë, kundër turqve dhe të mos i falesh faji atij që do t'ikte e nuk do të shkonte n'atë luftë kundër turqve, bile [dezertorët] do të baheshin copë-copë dhe do t'u digjej shtëpia. Menjëherë, i madh e i vogël për një natë u bashkuen t'armatosun. Si i u afruen pultjanët

¹ Qiti tellallin; bani shpalljen me zanin e kasnecit.

² Duhet kuptue se sanxhakbeu kishte zanë vend në një shtëpi malësorësh pultjanë.

³ Betimi solemn, me ungjill të hapun, ishte ma i madhi për atë kohë në popullsitë e krishtena.

INJAC ZAMPUTTI - THEMUESI I DIPLOMATIKËS DHE I SHKOLLËS HISTORIOGRAFIKE MODERNE SHQIPTARE

Nga Dr. Kastriot Marku

I

Formimi i një dijetari

“La storia si fa, senza dubbio, con documenti scritti. Quando ce n’è. Ma si può fare e si deve fare senza documenti scritti, se non ne esistono.... Quindi con parole. Con segni. Con paesaggi e con mattoni. Con forme di campi e con erbe cattive. Con eclissi lunari e con collari da tiro. Con le ricerche su pietra, eseguite da geologi, e con analisi di spade metalliche, compiute da chimici.” “Historia bëhet me dokumente të shkruara, s’ka dyshim. Kur të tilla ka. Por mund të bëhet, dhe duhet të bëhet pa dokumente të shkruara nëse nuk ekzistojnë. ...Pra me fjalë. Me shenja. Me peisazhe e me tulla. Me trajta fushe dhe me barëra të këqija. Me eklipse hëne dhe me pajime kuajsh. Me ekspertiza gurësh të ndjekura nga gjeologë dhe analiza shpatash metali të plotësuar nga kimistët.”¹ [Lucien Febvre (1878-1956)].

Historiani, shkrimtari, përkthyesi, gjuhëtari, etnologu, paleografi, me një fjalë dijetari i pazakontë Injac Zamputti,² lindi në Shkodër më 12 shkurt të vitit 1910. Gjyshi i Injac Zamputtit quhej Giuseppe Zamputti. Ai ishte mjek në profesion dhe iku nga Italia në vitin 1870 (mbas humbjes së shtetit të Papës në Porta Pia). Fillimisht u vendos si mjek bashkie në Kavajë, ku edhe u martua me Luigjian, nga familja e njohur raguziane Raçiç. Më pas u transferua në Durrës dhe vitet e fundit u vendos në Shkodër, ku edhe vdiq në vitin 1900. I ati i Injacit Romolo, ka lindur në Durrës në vitin 1876, ku edhe u pagëzua më 29 maj të atij viti nga Dom Nikollë Kaçorri. Pasi studioi fillimisht në Seminarin Papnor, më pas punoi si nëpunës poste pranë Konsullatës Italiane në Shkodër. Më pas u martua me Nine (Antonjeta), Temalin, familja e së cilës kishte zbritur nga malet (nga Temali i Malësisë së Dukagjinit), por që kishte mbetur e vejë në moshën njëzetë vjeçare nga martesja e parë në Ulqin, prej se cilës kishte edhe një vajzë. Nga martesja e tyre patën tre fëmijë: dy vajza dhe një djalë (Injacin), i cili ishte i fundit në radhë. Romolo pësoi një aksident në vitin 1911, inskenuar nga bejlerët e Shkodrës teksa shalonin kuajt. Ai u plagos në këmbë, plaga e së cilës më pas u infektua dhe me gjithë shtrimin

¹ FEBVRE, Lucien. *Problemi di metodo storico*. Introduzione di Angelo Torre; traduzione di Corrado Vivanti. Nuova ed. Torino Einaudi, 1992. p. 177.

²Mbiemri i saktë i Injac Zamputtit-t në të gjithë regjistrat e gjendjes civile shkruhet me dy t: Zamputti, sikurse mund të shihet edhe në një nga studimet e tij të para të publikura në *Buletinin e Institutit të Shkenavet*, (“Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të anonimit Elbasanas”, Nr. 1, 1949, f. 55-57), por që nga Injaci dhe familjarët e tij u përdor me një -t, gjatë viteve të diktaturës, për arsye të kuptueshme si një mënyrë “për të hequr dorë” nga origjina e tij italiane, e cila nga regjimi i asaj kohe shihej me dyshim.

për kurim në një spital të Barit, vdiq pas ca kohësh, duke e lënë Injacin jetim në moshën 1 vjeçare së bashku me tre motrat. E ëma, Nine, i rriti fëmijët me shumë mundime, duke endur në pëlhurë, prej së cilës zejë siguronte të ardhurat për të mbajtur familjen. Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, Injaci fillimisht shkoi në shkollën foshnjore në Shkollën e Qelës, dhe më pas me ardhjen e forcave austro-hungareze, duke qenë se kishte shtetësinë italiane dhe Austro-Hungaria ishte në konflikt me Italinë, në moshën 5 vjeçare jetoi në mjediset e Arqipeshkvisë së Shkodrës nën kujdesin e Emzot Jak Serreqit. Më pas në vitin shkollor 1917-1918, kur jezuitët ishin larguar për pak kohë, nisi shkollën fillore me mësues Dom Alfons Trackin. Në *Kolegjën Saveriane* të Etërve Jezuitë në Shkodër, Zamputti u dallua për dhunti të veçanta e për rrjedhojë kjo u shpërblye me rezultate shumë të mira në mësim dhe mbi të gjitha ra në sy për një sjellje fort korrekte. Etërit jezuitë të mbërritur në Shkodër në prillin e vitit 1841, kishin krijuar një qendër të rëndësishme, arsimore, kulturore, artistike dhe shkencore duke filluar me ngritjen në vitin 1859 të *Seminarit Papnuer Shqiptar*. Më 1871 ata themeluan në Shkodër shtypshkronjën: *Typographia Immaculatae Conceptionis B.M.V.*, e njohur si Shtypshkronja “Zoja e Paperlyeme”, enti botues i parë në Shqipërinë e asaj kohe nën sundimin osman, e cila për periudhën 1870 – 1945, ka të regjistruara një numër rekord botimesh prej 725 titujsh.³ Në tetor të vitit 1878 jezuitët hapën *Kolegjën Saveriane* dhe në mars të vitit 1891, filluan botimin e revistës *Elçija e Zemers t’ Jezu Krishtit* (1891-1913), revista e parë kjo në gjuhën shqipe brenda territorit shqiptar, e cila më vonë merr emrin *Lajmëtari i Zemers T’ Jezu Krishtit* (1914-1944), e që u pasua në vitin 1914 me shtojcën historiko-shkencore *Përparimi* (1914-1916). Pas festimeve të 50-vjetorit të themelimit të Kolegjës Saveriane, më 9 dhjetor 1928, me nismën e një grupi të ish-nxënësve të këtij Kolegji të mbështetur nga Etërit Jezuitë, u themelua Shoqata e intelektualëve shkodranë L.E.K.A. (Lidhje – Edukatë – Kulturë – Argtim),⁴ e cila do të kishte si moto programore *Concordia parve res crescunt/Sendet e vogla rriten prej bashkimit* dhe që do të shërbente për të lidhur më ngushtë mjedisin laik katolik shkodran dhe jo vetëm, me Kolegjën Saveriane⁵ dhe me veprimtarinë e saj pedagogjike,

³ PETERS, Markus W. E. *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimin dhe kulturën. "Tipografia e Zojës së Papërlyeme" në Shkodër (1870-1945)*. Përktheu nga origjinali gjermanisht Edmond Malaj. Tiranë, 2016. Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, f. 580-671.

⁴ “Themeluesat e shoqatës L.E.K.A.: 1. Emz. Pjetër Gjura, 2. Atë Lanfrank Steccati S. J., 3. Atë Zef Saraçi, 4. Zot. Gjon Çoba, 5. Zot. Shuk Sereggi, 6. Zot. Simon Doda, 7. Zot. Kolë Kraja, 8. Zot. Gjon Midha, 9. Zot. Luigj Javoviqi, 10. Zot. Ndoc Pistulli, 11. Zot. Zef Bumçi, 12. Zot. Ndoc Çoba, 13. Zot. Cin Lëci, 14. Zot. Ndoc Ronkalli, 15. Zot. Zef Gjon Bushati, 16. Zot. Kolë Gjon Laca, 17. Zot. Shan Koliqi, 18. Zot. Jovan Kastanato, 19. Zot. Zef Haxhija, 20. Zot. Pashko Ashiku, 21. Zot. Pjerin Simoni, 22. Zot. Tush Kakarriqi, 23. Zot. Lin Duka, 24. Zot. Kolë Dëma, 25. Zot. Nush Topalli, 26. Zot. Teofik Bekteshi, 27. Zot. Fadil Beg Bushati, 28. Zot. Ibrahim Hoxha, 29. Zot. Zef Kel Muzhani, 30. Zot. Dr. Gjon Saraçi, 31. Zot. Angjelin Cin Suma, 32. Zot. Zef Harapi, 33. Zot. Kolë Daberdaku, 34. Zot. Tefë Gjinaj, 35. Zot. Ndoc Ashiku, 36. Zot. Cin Sereggi, 37. Zot. Luigj Simoni, 38. Zot. Luigj Çoba”. Shih: “LEKA”, Vjeti I, Nr. i veçantë, Prill 1929, Organ i Shoqatës L.E.K.A., f. 7.

⁵ Shih: “LEKA”, Vjeti I, Nr. i veçantë, Prill 1929, Organ i Shoqatës L.E.K.A., f. 3-8. Po ashtu: Statuti i shoqërisë “Leka”, procesverbalet e themelimit të kësaj shoqërie dhe të mbledhjeve të para të saj. Arkivi Qendror i Shtetit, (AQSh), Fondi 134, Urdhëri jezuit (1189-1954), Dosja 133, Kutia 4, 22 fletë. Fillon me datë 9.12.1928 dhe mbaron me datë 14.12.1930.

artistike e kulturore. Në muajin prill të vitit pasardhës doli revista kulturore *Leka* (1929-1944),⁶ kjo e fundit si nismë pas festimeve me rastin e 50-vjetorit të hapjes së *Kolegjës Saveriane*,⁷ organi i shoqatës së sipërpërmendur, e cila ishte vijim natyral i *Elçisë*, më pas *Lajmëtarit*, dhe veçanërisht vijim i shtojcës *Përparimi* që doli në periudhën 1914-1916, e që u pasua nga *Kalendarit i vjetës* (1912-1927). Në vitin 1937, me nismën e një grupi studiuesish, natyrisht nën kryesinë e Giuseppe Valentinit S. J., dhe Dom Ndre Mjedës u themelua *Akademia Albanologjike Saverjane* (*Academia Albanologicae Xaveriana*), institucioni i parë akademik shqiptar i pavarur, i cili në statutin e tij⁸ do të përcaktonte qartë qëllimin e punës për gjurmimin qëmtimin, mbledhjen, studimin dhe botimin e burimeve dokumentare për Shqipërinë dhe shqiptarët.⁹ Zamputi-i thekson në *Bibliografinë*¹⁰ dhe në *Kujtimet* e veta se ka qenë pikërisht ai që nënshkruar diplomat për anëtarët e Akademisë Saveriane “me cilësinë e

⁶LEKA. E perkohshme muejore e shoqnisë “L. E. K. A” (Lidhje – Edukatë – Kulturë – Argtim) (*Concordia parve res crescunt*. De. B. J. C. X. (SALLUSTIUS, De B. Jug., C. X). Sendet e vogla rriten prej bashkimit. Shtypshkroja “Zoja e Papërlyeme” Shkodër. Revistë muejore kulturore. Gjerehti përgjegjës: z. Kolë Dema. Numri i parë doli në prill të vitit 1929, ndërsa numri i fundit (nr. 9-10, shtatuer-tetuer, 1944). Nga numri 4 i vitit 1931 pati pronar Luigj Simonin dhe drejtues Tush Kakarriqin; nga nr. 10, 1933 e deri në fund pati si drejtor përgjegjës Dr. Zef Pashko Saraçin; në vitin 1943 kryeredaktor i revistës ishte At Zef Valentini S.J. Revista ishte e përmuajshme kulturore, letrare, pedagogjike, folklorike dhe gjuhësore në fillim prej 8 faqesh e që më vonë shkoi në 32 deri në 40 faqe në një format 16 x 23.3 cm. Ngjan i çuditshëm konstatimi i Willy Kamsit se: «...revista Leka, me vullnet të vetin, e pezulloi botimin prej 1939 deri më 1943, duke rifillue mbas këtij vjeti e tue vijue deri kur qe mbyllë në vjetin 1944 prej regjimit antikombtar komunist. Prá dy janë periudhat e botimit të saj: e para 1929-1939, dhe e dyta 1943-1944». Ky konstatim rezulton të jetë i pasaktë, sepse revista doli, por doli, d.m.th. u botua në numra unikë, sikurse kishte dalë numri 8-12, gusht-dhetuer 1937, numër përkujtimur i XXV-vjetorit të Pavarësis Komtare 28. XI; nr. 11-12, tetuer-dhetuer 1938, numër i veçantë, botim i kujtimit të 60-vjetorit të Lidhjes së Prizrendit, dalë në vitin 1939; numri i veçantë, në vazhdim të numrave kujtimorë të XXV-vjetorit të Pavarësis Komtare, numër i vetëm 1942, si dhe dy blejtë «të drejtat e Shqipnisë ethnike, Bleni i parë, nr. 10-12, tetuer-dhetuer 1943 si dhe bleni i dytën. 4-8, prill-gusht 1944. Për më tepër mbi revistën Leka lexuesi mund të konsultojë: KAMSI, Willy., “Leka” në jetën atdhetare, kulturore e shkencore të Shkodrës e të Shqipërisë”, *Kumona e së diellës*, 11 (17) 1993, f. 10-12; KAMSI, Éilly., “Leka”, 1929-1944. *Bibliografi kronologjike*. Biblioteka Françeskane “At Gjergj Fishta”, Serija bibliografike, Bleni III. Botime Françeskane, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Shkodër, 2008. 134 f.

⁷ Për më tej shih: *Kolegja Saverjane nder 50 vjetët e para. 1877-1878 - 1927-1928*. Shtypshkroja “Zoja e Papërlyeme”, Shkodër, 1928. 174 f; *Colegio Saveriano di Scutari d’Albania, nei primi cinquant’anni 1877/78-1927/28*, Chieri, Gaspares Astesano, 1928. 138 f.

⁸ *Statuti i Akademisë Albanologjike Saverjane /Academiae Albanologicae Xaveriana Statuta*. Shkodër, Shtypshkroja “Zoja e Paperlyeme”, 1937. 4 f. Shih po ashtu: Statut i Akademisë Albanologjike Saveriane. Arkivi Qendror i Shtetit, (AQSh), Fondi 134, Urdhëri jezuit (1189-1954), Dosja 229, Kutia 7, 3 fletë.

⁹ “Qëllimi i sái me u dhânë shkas e me u ndihmue n’atë të veten gjithë atyne studimeve qi permblidhen në rreth t’albanologjis, d.m.th. qi i perkasin historís, gjeografís e hulumtimevet e aplikacionevet fizike-natyrore, letërsís, gjuhësís, folklorës e artevet të bukra të vendevet qi janë o kanë këne shqiptare, si atdhë o si koloní, të fisit shqiptár. E prandej synon me mbledhë tok në bashkpunim të gjith ata albanologj shqiptarë e të huej qi kërkajnë me dhânë e me nxjerrë, nder kerkime të veta, ndimen vëllaznore të nierzvet kompetentë të shperdám në qandra kulturore të ndryshme”.

¹⁰ Zamputi është kujdesur vetë të na lërë një bibliografi të tij. Shih: ZAMPUTI, Injac. në: *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi / Documenti per la storia dell’ Albania 1623-1653, Trascritti e tradotti da Injac Zamputi, St. Gallen-Prishtinë 2015, f. 569-577. Në pjesën e parë “Botime e mija të viteve tridhjetë deri në vitin 1944”, (f. 569-571), ka ndonjë pasaktësi tek titujt e disa shkrimeve, ndërkohë që mungojnë pothuajse të gjitha të dhënat e botimit të tyre, sikurse ndonjë artikull apo recension mungon edhe tek pjesa e dytë “Botimet e mija të periudhës kur kam punuar në Institutin e Historisë”, (f. 571- 577).

sekretarit”¹¹ dhe se: “Dom Ndreu, deri në vdekje, ka qenë konsulent kryesor i Valentinit...”¹² duke kthjelluar kështu pamjen e plotë të personalitetit të Dom Ndre Mjedës si albanolog.¹³ Formimi i tij klasik në gjuhët greqishte e vjetër dhe latinisht por edhe në gjuhët moderne si italisht e frëngjisht, rritja dhe edukimi në mjediset të tilla arsimore, kulturore e shkencore të jezuitëve në Shkodër, do të reflektoheshin domosdoshmërisht në profilin e ardhshëm të Injac Zamputti-t. Fillimisht mori pjesë në mjaft shfaqje teatrale si nxënës pranë Shoqërisë “Bogdani Junior”, ndërsa nga viti 1921 (kur nisi klasën e parë të gjimnazit klasik), e mbas, ai do të ishte aktor, përgatitës repertori, drejtues e regjizor i shfaqjeve dhe më pas si mësues dhe si përkthyes i teksteve dramatike.¹⁴ Mori pjesë në shfaqjet e dramave si “Oso Kuka”, apo melodramave “Ora e Shqipnisë” “Hijet e Zeza”, Ruba e Kuqe”, apo komedinë “I ligu për mend” etj, të muzikuara nga Dom Mikel Koliqi. Në shfaqjet muzikore dhe teatrale, traditë kjo e shkollave të asaj kohe në qytetin e Shkodrës, ai ishte mjaft aktiv duke marrë pjesë në pjesën më të madhe të veprimtarive kulturore, artistike e sportive, bile do shënuar se si amator mori pjesë edhe me mandolinën e tij e më pas si violinist, pjestar i orkestrës *Schola Cantorum*. Duhet theksuar se Zamputti që njohim sot, fillimisht nuk shkonte mirë me latinishten që në krye të herës ia jepte At Vincenzo Viezzoli S.J, madje për këtë shkak ai vendosi të studionte jo gjimnazin në drejtimin klasik por në drejtimin tregtar. Mbasi kreu gjimnazin në vitin shkollor 1927-1928, (në Gjimnazin e Shtetit), mbetet në kërkim të një pune, ndërkohë kishte bërë kërkesë për bursë; vijon intensivisht veprimtarinë e rregullt teatrore tek Shoqëria kulturore *Bogdani*. Fiton të drejtën e bursës për të përfunduar dy vitet e fundit të maturës në kolegjin e jezuitëve “Di Cagno Abbrescia” në Bari. Në mbarim të studimeve, në qershor të vitit 1931, përkundrejt ofertave për punë të mirë në Bari, Injaci vendos të kthehet në Shqipëri. Me t’u takuar me ish-profesorët e atyshëm të Kolegjes Saveriane, bazuar në paraqitjen e nxënësit të tyre të mëhershëm, por edhe arsimimin në Itali, ata vendosën që në vitin 1931, t’a mbajnë aty si mësues të gjuhës, letërsisë shqipe dhe matematikës, në gjimnazin e ulët (klasët pas fillores deri në lice), punë të cilën e kryen për gjashtë vite radhazi.¹⁵ Në moshën 21 vjeçare Zamputti do të ishte kështu kolegj me Dom Ndre Mjedjen dhe Atë Zef (Giuseppe) Valentinin S. J, një privilegj i cili pak kujt i qëlloi t’a kishte në atë kohë. Ndryshimi rrënjësor në lidhje me profilimin shkencor në fushën e dijeve humanitare të Zamputti-t e ka luajtur pa asnjë dyshim At Zef Valentini. Ai kishte qenë mësues i tij, që në shkollën e jezuitëve, asokohe kur Valentini kryente vitet e

¹¹ Shih: ZAMPUTI, Injac. në: *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputti / Documenti per la storia dell’ Albania 1623-1653, Trascritti e tradotti da Injac Zamputti, St. Gallen-Prishtinë 2015, f. 569.

¹² ZAMPUTI, Injac. “Kujtime për dom Ndre Mjedjen” në: *Hylli i Dritës*, Vjeti XXXI, Prill-Maj-Qershor, Shkodër, 2011, Nr. 2 (269), f. 131.

¹³ QUKU, Mentor. *Mjeda, 2: Albanologu (1888-1899)*, Tiranë, 2006.

¹⁴ ZAMPUTI, Injac. “Kujtime për dom Ndre Mjedjen”, në: *Hylli i Dritës*, Vjeti XXXI, Prill-Maj-Qershor, Shkodër, 2011, Nr. 2 (269), f. 129.

¹⁵ ZAMPUTI, Injac. “Kujtime për dom Ndre Mjedjen”, në: *Hylli i Dritës*, Vjeti XXXI, Prill-Maj-Qershor, Shkodër, 2011, Nr. 2 (269), f. 129-131.

provës përpara se të shugurohej meshtar. Për dhjete vjet radhazi (1931-1941), Zamputti do të ishte asistenti, kolegu dhe bashkëpunëtori më i rëndësishëm në të gjithë veprimtarinë e Kolegjes Saveriane, Shoqatës dhe revistës “LEKA” si dhe Akademisë Albanologjike Saveriane ku ai mbante detyrën e arkëtarit dhe të sekretarit. Do të ishte Valentini që do të ndikonte tek ish-nxënësi, tashmë kolegj i tij, që dashurinë dhe pasionin për letërsinë dhe artet e bukura t'i plotësonte me përvetësimin e mirë të latinishtes, prej së cilës kishte braktisur drejtimin klasik në gjimnaz. Ndaj në vitin 1933, kohë kur qeveria e Mbretit Zog mbylli shkollat private, Injaci merr edhe maturën e liceut klasik. Ishte pikërisht kjo periudhë e mbylljes së shkollave private, zbrasti sa i takon veprimtarisë pedagogjike, kur Valentini në vijim të “Lekës”, projektoi ngritjen e Akademisë Albanologjike Saveriane, së cilës Zamputti i kushtoi edhe një tingëllimë në njëmbëdhjetërokësh.¹⁶ Është kjo arsyeja që Zamputti vetë do të shprehet se: *Me punën ndihmëse dhjetëvjeçare në Albanologjinë Saveriane, përkrah dhe nën udhëheqjen e Valentinit, arrita të grumbulloja dhe të përvetësoja mjaft shprehi shkencore që formuan bazën e punës sime gjysmëshekullore.*¹⁷ Në lidhje me Dom Ndre Mjedën, Zamputti do të ishte fatlumë që ishte një prej trashëgimtarëve unikë. Shkruan Zamputti në *Kujtimet* e veta: *“Një nga privilegjet që m’u dha, qysh në fillim të profesionit tim, që t’i trokisja, pothuaj çdo ditë në mëngjes te dera e dhomës dhe ta shoqëroja nëpër rruginat e shumta që të çonin te sallat e mësimit në godinën e Seminarit ku xhakonët dhe shekullarët bashkoheshin në orët e mësimit. Veç kësaj, kuptohet se unë kisha edhe raste të tjera të vazhdueshme të piqesha e të rrija me të. Kam pasur pra fatin e lumtur, do të thoja unik, të shtrohesh në bisedë intime me të, qoftë për nevojat intelektuale të mia, qoftë, sidomos për parimet gjuhësore të cilat synonin udhëzimet e tija. Gjashtë vjetët që kalova në hijen dhe shoqërinë e tij më kanë vlejtur më shumë se sa dy universitete sepse ai, përveçse në lëmin gjuhësor dhe letrar, kishte një horizont shumë të gjërë që përfshinte të gjitha fushat humanistike, aq sa, për këto, mund ta quajë enciklopedik.”*¹⁸ I gjendur ndërmjet këtyre dy personaliteteve më në zë të Akademisë Albanologjike Saveriane, pa lënë mënjanë as At Fulvio Cordignano-n S.J., Zamputti përfitoi jashtëzakonisht shumë prej tyre, gjë e cila u reflektua në formimin e tij solid, i cili prodhoi më pas një punë të cilësuar shkencore gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të XX në studimet albanologjike. Injaci Zamputti shkrimet e para i botoi në revistën *Leka*, por edhe në disa organe të tjera të shtypit të kohës si *Cirka*, *Kumbona e së diellës*, *Lajmëtari i Zemers T’Jezu Krishtit*, *Zani i Shna Ndout*, *Hylli i Dritës*, *Tomorri*, *Shkëndija*, kryesisht artikuj kulturorë, letrarë e gjuhësorë, recensionet e kritikë letrare për autorë të tillë si Ndre Mjeda,¹⁹ Filip Shiroka,²⁰ Fulvio Cordignano,²¹ Gjergj Fishta,²² Naim Frashëri, Zef Skiroi,

¹⁶ Kur Valentini inaguroi raftet e reja të librave të bibliotekës Albanologjike Saveriane, Zamputti i kushtoi At Valentinit poezinë me pseudonimin Ales. “Bibliotekarit të Kolegjes Saveriane per raftat shkodranë të bibliotekës së ti”. Vjeta X/1938, Nr. 6-7, qersher-korrik 1938. f. 250-251.

¹⁷ ZAMPUTI, Injac. *Njerëz, fakte, ngjarje-kujtime*. Dorëshkrim. Pjesa e parë titullohet: “Mirazhe-arritje-zhënjime (1910-1944)” dhe pjesa e dytë: “E pakryemja simfoni skëterrre (1945-1992).”

¹⁸ ZAMPUTI, Injac. “Kujtime për dom Ndre Mjedjen”, në: *Hylli i Dritës*, Vjeti XXXI, Prill-Maj-Qershor, Shkodër, 2011, Nr. 2 (269), f. 130.

¹⁹ “Nji pergamenë”, *Leka*, Vjeta VIII/1936. Nr. 11, nanduer 1936. f. 518; *Ales. Zi në familje te “Lekës”*, Dom Ndre

Arshi Pipa,²³ Zef Harapi, Anton Zonari, Gjon Kujxhija,²⁴ Izedin Jashar Kutrulija dhe Mitrush Kuteli²⁵ etj., por edhe poezi, novela, e përkthime etj.,²⁶ duke përdorur, përveç emrit të tij edhe dymbëdhjetë pseudonime të ndryshme²⁷ të tillë si: *Ales, Notarios, Poliglota, Rosea, Sila, Sirena, Stal, Z= i Zeta (j), R. N.*²⁸ Modës së asaj kohe të botimit me pseudonim iu shmangën kryesisht kritikave letrare. Në vitin 1935, nga Konsullata Italiane në Shkodër, ngarkohet të japë mësim në kurset e gjuhës italiane që drejtonte në të gjithë botën asokohe shoqëria "Dante Alighieri", punë të cilën e kryen deri në vitin 1943. Pikërisht në këto vite kaluan përmes duarve të tij një pjesë e mirë e intelektualëve të kohës, të cilët thellonin njohuritë e tyre gramatikore e stilistike, falë përgatitjes së Zamputti-t, i cili mbi të gjitha lexonte, recitonte, shpjegonte imtësisht kryesisht kryeveprën e Dantes "Komedia Hyjnore". Madje atë kurs e pat ndjekur edhe ai që do të bëhej më pas përkthyesi mjeshtëror i saj: Pashko Gjeçi. Në vitin 1937 martohet me Rozën, një vajzë nga familja shkodrane Prela, e cila ishte ngushëllimi më i bukur i mundshëm i jetës familjare, me të cilën pati 6 fëmijë; 5 vajza dhe një djalë. Për dashurinë e thellë që ai kultivoi ndaj familjes, dashuri të cilën ai konsideronte si gjënë

Mjedja 19.XI.1866-1. VIII. 1937. Leka, Vjeta IX/1937. Nr. 7, korrik 1937. f. 327-329. ZAMPUTI, Injac. "Kur flasim për të Mëdhaj", Leka, Vjeta XV/1943, nr. 2, fruer 1943. f. 48-54; I. Z. "Kur flasim për të Mëdhaj – Shtojcë", Leka, Vjeta XV/1943, nr. 4-5, prill-maj 1943. f. 117-122.

²⁰ Ales. "Kangatarit të dallëndyshes (në dekë të Filip Shirokës)", Leka, Vjeta VII/1935, Nr. 12, dhjetor 1935. f. 515.

²¹ Ales. *Fjalori italisht-shqip i Cordignanos*. Leka, Vjeta XI/1939, nr. 1-2, kallnduer-fruer 1939. f. 38-40.

²² ZAMPUTI, Injac. "Atë Gjergj Fishta – gjeni shqiptare, gjeni botnore", Në: *At Gjergj Fishta 1871-1940: numër përkujtimuer botue nëpër kujdes t'At Benedikt Dema OFM*. Tiranë, "Distapur", 1943, f. 533-538. Ribotuar në "Jeta e Re!", nr. 11-12, Prishtinë, 1990. f. 1698-1703; "Vdiq At Gjergj Fishta", në: *Tomori*, nr. 1, janar 1941, f. 3. përfshirë në: Në *At Gjergj Fishta 1871-1940: numër përkujtimuer botue nëpër kujdes t'At Benedikt Dema OFM*. Tiranë, "Distapur", 1943, f. 562-563.

²³ N. "Arshi Pipa, "Lundëtarët", Hylli i Dritës, Vjeta XX/1944, nr. 6-7 (218-219), qershtor-korrik 1944. f. 136-138.

²⁴ "Gjon Kolë Kujxhija", "Valle Kombëtare", vëll. I "Dasëm Shkodrane" (Il Cenacolo, Firenze), Leka, Vjeta XV/1943, nr. 8-9, gusht-shtatuer 1943. f. 270-274.

²⁵ N. "Izedin Jashar Kutrulija dhe Mitrush Kuteli, "IV. Sulm e lot. Me një fjalë prej Dr. Pas-Tiranë 1944". Hylli i Dritës, Vjeta XX/1944, nr. 6-7 (218-219), qershtor-korrik 1944. f. 138-139.

²⁶ Gjatë kësaj kohe përktheu së bashku me p. Giuseppe Valentinin: ALFIERI, Vittorio. *Sauli*, tragjedi, përkthye shqip prej Z. e Z. (pseud). Lajmëtar i Zemrës së Krishtit, Shkodër, 1937, 115 f., e cila është ribotuar më pas edhe në Itali: Alfieri, Vittorio. *Sauli*, tragedi. Përkthim metrik e shtjellime nga Zef Valentini. Bologna, R. Patron, 1965. 197 p; si dhe CORNEILLE, Pierre. *Polieukti*. Tragjedi. Pierre Corneille; përkthye shqip prej Z. e Z. (pseud.). Shkodër, Botim i Lajmtari i Zemrës së Krishtit, 1936. 86 f.

²⁷ Shih: ZAMPUTI, Injac. në: *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputti / Documenti per la storia dell' Albania 1623-1653, Trascritti e tradotti da Injac Zamputti, St. Gallen-Prishtinë 2015, f. 569.

²⁸ Në identifikimin e shkrimeve të Zamputti-t të botuar para vitit 1945, kryesisht ato të botuara në revistën "Leka", studiuesi i vlerës Willy Kamsi, bazuar në pseudonimi *Ales*, nuk i beson Palokë Dakës por P. Paulin Margjokës, dhe shkrimet me këtë pseudonim ia veshë Dom Aleksandër Sirdanit, pa arsytuar shumë, duke ditur se shkrime të ndryshme dhe krijime letrare në prozë e poezi dihej pak a shumë se ishin të Zamputti-t. Shih: KAMSI, Willy. "Leka", 1929-1944. *Bibliografi kronologjike*. Biblioteka Françeskane "At Gjergj Fishta", Serija bibliografike, Bleni III. Botime Françeskane, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Shkodër, 2008. f. 125, shënimi 1 në fundfaqe. Në fund të këtij botimi është bashkangjitur një "Errata-Corrige", në të cilën i sugjerohet lexuesit që për pseudonimi Ales të përdorur në bibliografi, t'i adresohet Injac Zamputti e jo sikurse i është veshur Dom Aleksandër Sirdanit. Për pseudonimet e Zamputti-it shih: DAKA, Palok. *Fjalor pseudonimesh*, anagramash e siglash të përdorura në shtypin shqiptar dhe në botime të tjera gjatë viteve (1743 – 1944). Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia Botuese "Shkenca", Tiranë, 1998. 188 f.

më të shtrenjtë, nuk kurseu as atëherë kur vështirësitë jo të pakta që pati në jetë iu bënë “ferrë”. Sikurse do e shohim më pas ai mundi të dalë prej andej pa i cënuar virtytet e tij morale, të cilat shumëkush në kohën e tij me apo pa dëshirë i la mënjanë. Mbas pushtimit italian u thirr nga zyra e “Fashio-s”, në Shkodër të cilën e drejtonte Estref Frashëri, për të kryer detyrën e sekretarit, ndërkohë që Valentini u transferua në Tiranë. Pakënaqësinë e punës në atë institucion ia rrëfen At Valentinit, i cili e fton të punojë në Tiranë në redaksinë e gazetës “Tomori”, drejtor i së cilës ishte Vangjel Koça, për të përgatitur faqen letrare. Pakënaqësitë e përtëritura sërish e bëjnë që të kthehet në Shkodër dhe të viojë studimet e larta. Në qershor të vitit 1941, paraqitet në universitetin e Triestes në Itali me planin e diplomës dhe mbas 5 muajsh në tetor të atij viti doktorohet në Shkencat Politike, me tezën e laurës me temë: “Shtatëqinta Venedikase dhe Arbëria Turke”,²⁹ e cila do të bëhej në mënyrë të tërthortë “paradhoma” hyrëse dhe njëkohësisht mbështetja e punës që ai do të kryente gjatë gjithë jetës në rrethana krejt të tjera, nën një regjim politik ku shkencat politike ishin gjëja e fundit që hynin në punë, në mos prishnin punë. Do theksuar se i gjithë materiali burimologjik që ka shërbyer për realizimin e kësaj teze lidhur me marrëdhëniet mes Venedikut dhe Shqipërisë, ishin materialet e muzeut si dhe shkresat dokumentare të pajisura me ekstrakte të dokumentacionit që ai Valentini kishte grumbulluar edhe me ndërmjetësi të korrespondentëve që kishte në arkivat e Italisë, kryesisht me Bartolomeo Cecchetti-n e Arkivit të Venedikut.³⁰ Më duhet të them se ky punim i lënë mënjanësh jo vetëm nga autori, për arsytet që mund të merren me mend, por edhe nga studimet e mëvonshme përbën në të vërtetë një studim me rëndësi jo vetëm për të njohur formimin e historianit të ardhshëm por edhe një model të punës me dokumentet dhe metodologjinë e ndjekur, pa lënë mënjanë specifikën dhe rëndësinë që paraqet ai punim për periudhën e marrë në shqyrtim. Thotë vetë Zamputi: *Se si hyra pastaj në botën e dokumentacionit, është një histori më vete ... Veçse, qysh pas martese, nisa të interesohesha për këtë degë, aq sa vetë Valentinit nisi t'i krijohet përshtypja dhe kënaqësia se një ditë do të merresha me historinë.*³¹ Në fillim të vitit 1938 botoi në revistën *Leka* melodramën *Damiani Himarjot*,³² e cila u botua me pseudonim Ales, si punim letrar i rrethit të “Lekës”, me rastin e kremtimeve të 25-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, për t’u botuar më pas më vete në vitin 1944.³³ Në vitin 1940 botoi tek Shtypshkroja “Zoja e Papërlyeme” librin e parë me novela *Zemra Njerëzish*³⁴. Në gjashtë

²⁹ *Il Settecento Veneziano e l’Albania Turca*, Tesi di Laurea di Ignazio Zamputti, Relatore: Chiar.mo Prof. Giorgio Rolletto, R. Università di Trieste. Facoltà di Scienze Politiche, Anno Accademico 1940-1941. 181 pp. Biblioteca Kombëtare e Shqipërisë, Tiranë. Al.15. a.40.

³⁰ Autori njihet me botimin: CECCHETTI, Bartolomeo. *Degli stabilimenti politici della Repubblica veneta nell’Albania e delle sollevazioni in Oriente, fino al secolo 16. sunto di una memoria*. Estratto da: Atti del R. Istituto veneto di scienze, lettere e arti, vol. 3, serie 4. [Venezia, s.n.], 1874 (Venezia, Grimaldo e C.). 22 p. [Mbi institucionet politike të Republikës së Venedikut në Shqipëri dhe mbi kryengritjet në Lindje deri në shek. XVI. Përmbledhje e një kujtese]. Marrë nga: Atti del R. Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, vol. 3, serie 4. Venezia, Tip. Grimaldo e C., 1874. 22 f.

³¹ ZAMPUTI, Injac. *Njerëz, fakte, ngjarje-kujtime*. Dorëshkrim.

³² ALES. *Damiani Himarjot. Melodram*, Leka, Vjeta X/1938. Nr. 1-3, f. 92-129 (694-731).

³³ ZAMPUTI, Injac. *Damiani himarjot*. Dramë lyrike, Paperlyemja, Shkodër, 1944, 79 f.

³⁴ ZAMPUTI, Injac. *Zemra njerëzish*. Novela. Shtypshkroja «Zoja e Papërlyeme», Shkodër, 1940. 119 f.

vitet e fundit të punës pranë Kolegjit Saverian, falë fatit që pati të kishte koleg At Giuseppe Valentinin, pranë të cilit ishte asistent dhe njëkohësisht sekretar i *Akademisë Saveriane*, ai njohu dhe përvetësoi bazat metodologjike rigoroze prej “jezuiti”, të punës albanologjike, kryesisht praktikës arkivore dokumentare dhe asaj përkthimore e cila do t’i shërbente më pas si pikënisja e duhur për studimet e mëvonshme rreth historisë së popullit shqiptar. Me të drejtë do të thotë Aurel Plasari se Zamputti u bë “*përmbaruesi testamentar i saverianëve*”.³⁵ Në gjysmën e dytë të tetorit të vitit 1941, kthehet sërish në Shqipëri duke lënë sërish mënjanë ofertat për punë në Trieste. Valentini i propozon vendin e lektorit në Universitetin e Padovë, por duke pasur parasysh lidhjen e tij të ngushtë me familjen, jezuitët dhe Shqipërinë, sërish e refuzon. Pranon kontratën e punës si mësues efektiv i Kolegjes Saveriane dhe i Seminarit Papnor që i ofron Drejtoria e Kolegjit Saverian. Mbërriti vjeshta e vitit 1943 kur edhe u përcaktuan fatet e luftës, ndërkohë rektori i kolegjit At Gjon Karma i njofton pushimin nga puna ngaqë kolegjit i ishte ndërprerë financimi italian për stafin mësimor. Në dilemën për të zgjidhur mosmarrëveshjen kontraktuale me gjyq, sedra dhe nderi i ndërgjegjës së Zamputti-t vendos të tërhiqet duke marrë rrogën e tre muajve dhe duke e mbyllur çështjen me kaq. Boton dhe më 1944 librin e dytë me tregime e novela *Atje nën hijen e Rozafës*, botuar nga Ismail Mal’Osmani,³⁶ dhe përkthen *Historija e një shpirti – autobiografija e Shenjtes Terezinë e Krishtit Fëmijë*,³⁷ prej të cilave siguron ndonjë të ardhur modeste. Në vitin 1945, menjëherë pas luftës së dytë botërore, fillimisht punon në redaksinë e gazetës “Koha e re” e më pas si drejtues i Shtëpisë së Artit dhe Kulturës në Shkodër. Këtu përgatit të vërë në skenë melodramën “Rozafa” të Dom Ndre Zadejës, ndërkohë autori i saj sapo ishte arrestuar dhe pas një kohe të gjatë provash ato u ndërpre në ndërkohë vihet në skenë tragjedia “Juda Makabe” e Fishtës e cila pati sukses të jashtëzakonshëm. Në mbledhjen themeluese të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë u emërua sekretar i saj, ndërkohë kishte filluar vala e arrestimeve të klerit, madje pushkatohej Dom Ndre Zadeja, Dom Lazër Shantoja, At Giovanni Fausti. Pushohet nga puna dhe e thërrasin në degën e punëve të Brendshme ku i kërkojnë me takt që të lqargohet nga Shqipëria, kërkesë të cilën ai e refuzon. Pothuajse për dy vjet, nga viti 1946 deri në korrik të vitit 1947, e transferojnë me punë në gjimnazin e qytetit të Gjirokastrës, larg familjes, ku jep lëndën e letërsisë dhe atë të filozofisë në Liceun e atij qyteti duke zëvendësuar Mark Demën. Mbase kthehet në Shkodër për pushime, ngarkohet sërish të shkojë në Gjirokastrë të mbajë një kurs dy-mujor psikologjie për mësuesit e atij qyteti. Në nëntor të vitit 1947 filloi punë pranë Institutit të Studimeve Shqiptare, i cili më pas u quajt *Instituti i Shkencave* (më pas *Instituti i Historisë*) i sapoorganizuar/krijuar në vitin 1947. Përmes një Urdhërese të Kryeministrit, më datën 8 qershor 1949 u krijua Arkivi i Shtetit, i cili fillimisht, funksionoi pranë Institutit

³⁵ PLASARI, Aurel. "Nje 80-vjetor i akademizmit shqiptar në Shqipëri". Ligjëratë e mbajtur nga Prof. Dr. Aurel Plasari në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, më 19 dhjetor 2017.

³⁶ *Atje, nën hijen e Rozafës*. Ismail Mal’Osmani, Tiranë 1944, 110 f.

³⁷ *Historija e një shpirti – autobiografija e Shenjtes Terezinë e Krishtit Fëmijë*. Përkthei Injac Zamputti. Botim i Kumbonës të së Dieles, nr. 15, Shtypshkroja “Shqypja”, Shkodër 1944. 163 f.

të Shkencave, kështu që kërkohej punë në lidhje me njohjen, sistemimin, klasifikimin dhe katalogimin e dokumentacionit. Në këtë institucion u grumbullua pasuria dokumentare e fondeve që vinin nga konfiskimi i arkivave të institucioneve fetare sikurse atyre të françeskanëve dhe jezuitëve, regjistrat e akteve të Gjyqit të Sherisë së Elbasanit e të Beratit apo edhe arkivave private sikurse ishte ai i Lef Nosit, prej të cilit doli në dritë dorëshkrimi i Anonimit të Elbasanit dhe natyrisht u trashëguua i gjithë dokumentacioni i krijuar nga Instituti i Studimeve Shqiptare/*Istituto di Studi Albanesi*,³⁸ Për këtë arsye për rreth tre vjet (1949-1951), punoi si përgjegjës teknik i organizimit të këtij Arkivi,³⁹ drejtor i të cilit qe Zef Mala, deri sa ky arkiv kaloi në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kujton Zamputti: „*Kishim arritë në fazën kur materialet arkivore të institucioneve të ndryshme, mbasi kishin qenë shfrytëzue nga hetuesia e gjykatave “popullore”, duheshin kërkuar në mes të ndyesinave të bodrumeve që kishin qenë selia e kafshëve. Fondet e kalbëzue me kemi nxjerrë me lopata dhe i kemi transportue me karro dore e, pastaj, kemi nisë spastrimin e tyre. Në Durrës dy a tri shtëpi ishin plot e përplot me shkresat e Ministrisë së Mbrendshme dhe të Luogotenencës. Kishin qenë grumbullue aty gjatë kohës së marrëdhanieve të mira me Jugosllavinë, gjoja për t’i çue në fabrikat e letrës, por në të vërtetë për të pasunue arkivat e shërbimit sekret. Kishin mbetë pa u nisë kur u prishën marrëdhانيت. Duheshin sjellë përsëri në kryeqytet. Kishin humbë organizimin origjinar dhe duheshin pastrue nga pislleqet. E drejtoja unë këtë punë me nja dyzet punëtorë e punëtore durrsakë. Shkoja çdo mëngjes prej Tirane dhe kthehesha çdo mbamje. Kështu vazhdoi puna për disa muej. Një ditë, kur arrita në Durrës, dy a tre punëtorë që kisha caktue përgjegjës për të kontrollue punën, më dolën përpara të alarmuem dhe më thanë se magazina ku depozitoheshin paketat e materialeve të seleksionueme e të organizueme provizorisht, kishte qenë sekuestrue nga organet e Ministrisë së Mbrendshme. I sigurtë për punën që kishim ba, nuk u alarmova dhe iu përgjegjja qetë-qetë: “Ministria e Mbrendshme ban punën e vet, na të vazhdojme punën tonë”.*⁴⁰ Në vitet '50 e fillimin e viteve '60, shkruan letërsi: tri drama, një melodramë, dy tregime të gjata, një poemë për luftën e Himarës të vitit 1481, por nuk e lejojnë të botojë, ndaj edhe detyrohet të heqë dorë nga letërsia e t’i kushtohet vetëm historisë e paleografisë. Në vitin 1953, kaloi në Sektorin e Historisë së Mesjetës, ku iu ngarkua si detyrë mbulimi i periudhës së sundimit osman (shek. XV-XVII). Pas shumë ecejakesh,

³⁸ *Ma i pari Kuvend i studimevet shqiptare / Il primo convegno di studi albanesi*, Tirana 9-13 aprile 1940 (Instituti i Studimeve Shqiptare i temelatës “Skanderbeg”) Roma 1940 (Tipografia Ministero Affari Esteri). 61 f. Për më shumë shih: Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar, (AQSH), Tiranë. Fondi 200. Instituti i Studimeve Shqiptare (1940-1944). Në vitin 1942, Instituti në fjalë do të ndërrojë emrin e do të quhet “Instituti Mbretëror i Studimeve Shqiptare”.

³⁹ Një pasqyrë e shkurtër rreth bërthamës së fondeve të ish-Arkivit të Institutit të Shkencave (sot Arkivi Qendror i Shtetit), mund të shihet në artikullin: «Arkivi Historik i Institutit të Shkencave» në rubrikën “Jeta shkencore” në Buletin për Shkencat Shoqërore, Nr. 3, 1954, f. 131-133, pa emër, por gjykuar nga gjuha e përdorur, autori është me shumë siguri Injac Zamputti, sepse dihet se në atë kohë ai ishte përgjegjësi i Arkivit Historik, dhe ajo që e përforcon më tepër është fakti sepse, lidhur me punën organizative arkivistike të Zamputti-t, në AQSh, gjenden: » Projekte dhe skica të Injac Zamputti mbi studimin e dokumentacionit dhe organizimit arkivor të tij». Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 19. 7 fletë.

⁴⁰ ZAMPUTI, Injac. *Njerëz, fakte, ngjarje-kujtime*. Dorëshkrim.

po atë vit, arriti të transferojë në Tiranë edhe familjen. Në *Institutin e Historisë* Zamputti punoi për rreth 40 vjet me radhë duke transkriptuar, përkthyer dhe komentuar qindra, për të mos thënë mijëra dokumente të rëndësishme për historinë e Shqipërisë falë njohjes shumë të mirë të latinishtes dhe italishtes mesjetare, paleografisë dhe arkivistikës, çfarë do të thotë se përkthimi i dha atij mundësinë të bëjë edhe mjaft studime në fushën e historisë, gjuhësisë dhe arkeologjisë etj. Botimi i dokumenteve për historinë e Shqipërisë nuk ishte një punë e lehtë, sepse pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve nuk gjendeshin në Shqipëri, për arsye se një pjesë e pakët e tyre gjendeshin në arkivat historike vendase,⁴¹ të cilat ishin shkatërruar përgjatë pushtimeve të shumta, kryesisht atij osman e më pas me hyrjen e regjimit komunist, ndaj në këto kushte, mbetej që ato të siguroheshin përmes një udhe tjetër; nga arkivat e vendeve të huaja, italiane, spanjolle, dalmatine si Venecia, Vatikan, Padovë, Milano, Barcelonë, Raguzë, Dubrovnik etj. Për gjendjen e materialeve dokumentare në Arkivin e Propagandës Fide lidhur me Shqipërinë, Zamputti i kishte nxjerrë njoftimet nga studiues dhe albanologë të ndryshëm si: Daniele Farlati,⁴² Mario Roques,⁴³ Fulvio Cordignano,⁴⁴ Cirillo Carolevskij,⁴⁵ Nilo Borgia,⁴⁶ Jovan Radonič⁴⁷ etj. Pjesa me e madhe e materialit dokumentar të mbledhur nëpër arkivat e huaja (Romë, Venedik, Raguzë, Paris, Vjenë, Athinë, Bukuresht, Sofje, Beograd, Zagreb, Stamboll etj.) në fund të viteve '50 dhe në fillim të viteve '60, nga kërkues dhe studiues të ndryshëm, të dërguar nga shteti shqiptar dhe me shpenzimet e këtij të fundit, e që përbën një sasi deri diku të

⁴¹ ZAMPUTI, Injac. "Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për Historinë e Shqipërisë." *Buletin i Shkencave Shoqërore*. Tiranë, 1955, nr. 3, f. 122-130.

⁴² *Illyricum Sacrum VII. Illyrici Sacri. Tomus septimus, Vol.VII, Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachensis, et Sirmiensis Cum Earum Suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu et Jacobo Coletto Olim Eju-sdem Societatis Alumno. Venetiis, MDCCCXVII (1817). Apud Sebastianum Coleti. Superiorum Permissu Ac Privile-gio. 1817, p. (III-XVI) + 638.

⁴³ ROQUES, Mario. *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*. Përkthye nga frëngjishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga Eïlly Kamsi. Botimet Françeskane, Shkodër, 2011. *Le Dictionnaire albanaise de 1635...*, Librairie Orientaliste Paul Gëuthner, Paris, 1932.

⁴⁴ CORDIGNANO, Fulvio, S.I. *Geografia ecclesiastica dell' Albania dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII*, (Gjeografia kishtare e Shqipërisë prej dekadave të fundit të shekullit të XV deri në gjysmën e shekul-lit të XVII) Roma. Pont. Institutum Orientalium Studiorum, 1934. ff. 70. Ribotim në: *Orientalia Christiana Periodica*, Roma, Vol XXXVI. (36) 4. Num.99. Decembri 1934. Roma, ff. 229 - 294.

⁴⁵ KARALEVSKIJ, Cirillo. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche*. Fasc. 1-3. Estratto dal BESSARIONE, Rivista di Studi Orientali, Roma, M. Bretschneider, 1911-1913. 3 v. 157 pp. *Documenti inediti per ser-vire alla storia delle chiese italo-greche*. Fascicolo I. Estratto dal "Bessarione", rivista di studi orientali, Anno XIV, Serie 3, Fascicolo 111-113). Roma, 1911. 41 pp. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche. La missione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei secoli XVI-XVIII. Documenti inediti ricavati dall'Archivio della S.C. di Propaganda Fide e del Pont. Collegio Greco*. Fascicolo II. Estratto dal "Bessarione", rivista di studi orientali, Anno XV, (Serie III), vol. 8, Fascicolo 117-118). Roma, 1911-1912. p. 49-92. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche*, Fascicolo III. Estratto dal "Bessarione", rivista di studi orientali, fasc 120 [aprile-giugno 1912] e 123 [gennaio-marzo 1913]. Roma, M. Bretschneider, 1912-1913. p. 93-157.

⁴⁶ BORGIA, Nilo. *I monaci basiliani d'Italia in Albania*. Appunti di storia missionaria. Secoli XVI - XVIII. Istituto per l'Europa Orientale 2 Serie. Politica Storia Economia. XXVII. Roma, 1935. Vol. II. Periodo secondo. Reale Accademia d'Italia, Centro Studi per l'Albania, 4 Roma, 1942.

⁴⁷ RADONIČ, Jovan. *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje: od 16. do 19. Veka*. Beograd: Naučna Kniga, 1950. 746 p. Јован Радонић, *Римска Курија и Јужнословенске Земље, од XVI до XIX века ст. 10*. Београд 1950.

konsiderueshme me dokumente qoftë në fotokopje qoftë në mikrofilma të cilët thuhet se janë dorëzuar në arkivin e Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë dhe në vitet '92-'94, janë dërguar në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë. Mbas viteve '90 nuk ka pasur përsëritje të këtij interesimi sa i takon sigurimit të dokumentacionit për periudhën mesjetare. Në vitet 2010-2012, pat një interesim nga Qendra (sot Akademia) e Studimeve Albanologjike për sigurimin e dokumentacionit arkivor për shekullin e XX, nismë kjo që u mor me rastin 100-vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar dhe me këtë rast është grumbulluar një sasi mjaft e madhe dokumentesh për këtë periudhë. Vetëm nga dokumentacioni austro-hungarez janë botuar 6 vëllime me dokumente ndërkohë që dy vëllime u botuan me dokumentacionin e ardhur nga arkivat britanike. Ndërkohë për shekujt XVII-XIX, Arkivi Sekret i Vatikanit dhe posaçërisht Arkivi i Propagandës Fide ende nuk janë shfrytëzuar "teharrur" sa duhet.

Gjatë viteve 50-të, (nuk kemi mundur t'a verifikojmë se në ç'mënyrë), por është fakt se u sollën një sasi e konsiderueshme dokumentesh të mikrofilmuara nga *Arkivi Historik i Propagandës Fide*, të cilat profesori nisi t'i transkriptonte, përkthente dhe komentonte e botonte fillimisht në *Buletin e Universitetit Shtetëror të Tiranës* (Seria e Shkencave Shoqërore), sikurse bëri me relacionin e Frang Bardhit mbi Zadrimën (1956),⁴⁸ dhe relacionin e të njëjtit relator mbi Pukën (1958),⁴⁹ relacionin e Pjetër Budit dërguar kardinalit Gozzadino (1958),⁵⁰ për t'i botuar ata më pas në serinë dyvëllimshme me titull: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*. Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. Vëll. II. (1634-1650). Tiranë 1965. Në fakt është për t'u shënuar se në vitin 1956, nën shembullin e *Regesti-t* të lënë nga Cordignano dhe Valentini,⁵¹ Zamputti paralajmëroi punën për transkriptimin dhe botimin e dokumenteve të tre vëllimeve të ardhshme (1963, 1965 dhe 2015), me dokumente nga Arkivi Historik i Propagandës Fide, përmes botimit të regestit të 72 dokumenteve të para.⁵² Ajo që kemi mundur të mësojmë është se fotokopjet e këtyre dokumenteve të nxjerra nga ai arkiv, Zamputti ia kishte parë mbi tryezë eprorit të tij që drejtonte Sektorin e Historisë së Mesjetës, Aleks Budës, të cilit duke i vënë në dukje rëndësinë që kishin ato dokumente ia kërkoi që t'i përkthente si punë suplementare në shtëpi. I gjithë materiali dokumentar i këtyre dy vëllimeve me relacione është përthyer e përgatitur për botim punë për një vit e gjysëm në vitet 1955-1956, duke filluar punë çdo mëngjes nga ora tre ose tre e gjysëm për të vazhduar deri sa zgjoheshin fëmijët ;

⁴⁸ ZAMPUTI, Injac. "Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike dhe shoqërore të shekullit XVII. Relacioni i Frang Bardhit mbi Zadrimën dhe regjesti i 72 dokumentave të rij". *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1956, nr. 2, f. 157-198.

⁴⁹ ZAMPUTI, Injac. "Mbi disa materiale të reja dokumentare të shek. XVII. Relacioni i Frang Bardhit mbi Pukën". *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1958, nr. 3, f. 170-215.

⁵⁰ ZAMPUTI, Injac. "Relacioni i Pjetër Budit drejtue kardinalit Gozzadino me 1621". *Buletin i Shkencave Shoqërore*. Tiranë, 1958, nr. 2, f. 79-92.

⁵¹ CORDIGNANO, P. Fulvio – VALENTINI, P. Giuseppe. *Saggio di un Regesto storico dell'Albania*. Scutari, Tipografia Dell'Immacolata, 1937 - 1940. 106 p. përmban te një regest me 1490 dokumenet për periudhën 1199-1568.

⁵² ZAMPUTI, Injac. "Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike dhe shoqërore të shekullit XVII. Relacioni i Frang Bardhit mbi Zadrimën dhe regjesti i 72 dokumentave të rij". *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1956, nr. 2, f. 193-198.

aty në tavolinën e bukës në kuzhinën e apartamentit të tij të ngushtë. Vëllimin e tretë të këtyre dokumenteve arriti t'a punojë e t'a bëjë gati për botim vetëm mbasi doli në pension.⁵³ Dokumentacioni që ka lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë i mbledhur nga ai arkiv, i cili tashmë është botuar në dhjetë vëllime, sipas një përlogaritjete të afër që kemi bërë, përbën as më shumë e as më pak por rreth ¼ e fondit të përgjithshëm që ka arkivi në fjalë për Shqipërinë. Ky ishte shkaku kryesor që ndaj Zamputti të shpërthente lufta ideologjike. Duke pasur parasysh faktin se për Zamputtin mundësia e lëvizjes për të prekur me dorë dokumentacionin burimor nga arkivat e huaja ishte e pamundur, si një mentar largpamës dhe largvajtës njëkohësisht, ai nisi ashtu vetmitar projektin vetjak afatgjatë për përgatitjen e studiuesve të rinj në këtë disiplinë, në mënyrë që ata kurdo që të krijohej mundësia, të ishin në gjendje për të bërë kërkime në arkivat e huaja, në mënyrë që të vilnin e të sillnin prej andej dokumentet e duhura. Puna e tij paraprake përgatitore që në të vërtetë një shkollë joinstitucionale, e cila për fat të mirë nuk është se shkoi dëm e gjitha, sepse Injac Zamputti sikurse e thamë, nuk duhej dhe nuk u lejua asnjëherë të dilte jashtë Shqipërisë, as për të realizuar kërkimin e dokumenteve dhe as për të marrë pjesë në simpoziume apo konferenca shkencore ndërkombëtare, ku ai ftohej nga historianët dhe shkencëtarët e huaj në cilësinë e autoritetit kompetent të padiskutueshëm. Origjina e tij italiane, shkollimi dhe formimi i tij në Kolegjin Saverian të Etërve Jezuitë dhe më pas në *Akademinë Albanologjike Saverjane*, kontaktet që kishte pasur para hyrjes së regjimit komunist me At Giuseppe Valentini-n, Fulvio Cordignano-n dhe kolegët e tyre të cilë cilësoheshin si fashistë dhe kriminelë, ishin tre elementë të mjaftueshëm që Zamputti të konsiderohej nga regjimi diktatorial si një element i dyshimtë me hijëzim « reaksionar » që do të thoshte se paraqiste një potencial të mundshëm për « rrezikshmëri shoqërore » e për rrjedhojë ai duhej të mbahej i izoluar dhe nën mbikëqyrje konstante. Kësaj i shtohej edhe refuzimi i tij këmbëngulës që i kishte bërë presionit të policisë sekrete (Sigurimit) për të bashkëpunuar me të në tetor të vitit 1949.⁵⁴ Në vitin 1967, kur revolucioni kulturor

⁵³ ZAMPUTI, Injac. *Dokumente për historinë e Shqipërisë "(1623-1653)/Documenti per la storia dell' Albania 1623-1653"*. Transkriptuar e përkthyer nga - *Trascritti e tradotti da Injac Zamputti*. Albanisches Institut dhe "Faik Konica", Prishtinë 2015. 578 f.

⁵⁴ Lidhur me këtë aspekt ja se ç'shkruan ai në kujtimet e tij: "Viti 1949 ka qenë për mue ma i randi i jetës sime. Edhe vitet që do të vijnë nuk do të jenë ma të lehta për mue e për familjen time... Në tetorin e atij viti të zi (por a pati pastaj ndonjë vit të bardhë për mue?) një djalë hyni në jetën time për me e bamë edhe ma të zezë. Kur po shkoja rrugës në atë mbramje të errët, m'u afrue nga pas një hije si të ishte hija e trupit tim në rreze të hanës. Në një qoshe të rrugës, pranë ish pallatit të Zogut, hija lëshoi za. Ndalova dhe u gjeta ballë për ballë me atë djalë. Më ftoi që të shkoja me të në një drejtim tjetër. Në krye të rrugës së Barrikadave takuem në një burrë të pjekun që po na priste. Gjithë mirësi më vunë në mes dhe ecëm nëpër atë rrugë në të cilën nuk bante dritë asnjë llampë dhe hymë në rrugën Qemal Stafa e cila ishte gjithashtu në errësinë të plotë dhe vetëm dritat e dyqaneve ndriçonin ndopak. Nisën të thuheshin disa fjalë të pakuptimta për mue. Shumë vonë erdha në vete dhe kuptova humnerën ku donin me më plandosun. Sikurse lexuesi e ka kuptue, unë tashma isha mësue të ulja kokën. Por në atë mbramje të zezë puna kishte shkue në fije të penit. Harrova nanë, grue, motër e fëmijë dhe ndalova hapin i vendosun për mos me ecë një metër ma tej me ato dy hije që më ftonin të hyja në një apartament aty përballë. Kambëngulja ime mos me u bindë i tronditi shoqnesit e mij që më dhanë me kuptue se, në raste të tjera, kishin dalë përherë fitues. Kur e panë se isha i vendosun edhe të vdisja por jo të bindesha, më detyruen të lëshoja një deklaratë se nuk e pranoja propozimin që m'u ba. Nuk pata asnji ngurrim. Në dritën e vitrinës së një dyqani shkrova fjalët që m'u diktuen, sigurisht me shprehjen negative për propozimin që m'u ba. Kjo

kinez iu vërsul besimeve fetare, Zamputti u sulmua tërthorazi dhe drejtpërdrejt, sidomos pas botimit dy vjet më parë të artikullit: “Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII”,⁵⁵ në të cilin theksonte se: “Thamë ma parë se lëvizja për gjuhën dhe për arsim u zhvillue në këtë pjesë të vendit e të shoqnisë shqiptare që ruejti, me gjithë procesin e islamizimit, lidhjet fetare me Romën dhe që u inkoadruë me lëvizjet e veta në aksionin e Vatikanit dhe të fuqive të tjera të krishtena kundër turqve. Vetëm në këtë terren prandej pati mundësi të ushtrohej aso kohe përgjithësisht problemi i gjuhës dhe i nevojës që kishin popullsitë shqiptare për arsim e kulturë”.⁵⁶ Pikërisht për shkak të akuzave se “kishte sjellë Vatikanin në Shqipëri”, Zamputti do të përgjigjej publikisht.⁵⁷ Madje për këtë shkak ai nuk iu lejua të botonte studimet e tij në pjesën më të madhe të shtypit periodik, pengesë nga e cila do të çlirohej vetëm mbas njëzetë vjetësh, por gjithsesi u mbajt në Institut vetëm sepse ai (Instituti i Historisë) kishte nevojë për të; sepse dokumentacioni mesjetar nuk lexohej si duhej prej askujt tjetër. Injac Zamputti duke mos qenë një njeri i regjimit, në këtë vështrim nuk gëzonte ndonjë mbështetje të veçantë pothuajse prej askujt, por pavarësisht nga kjo ai vlerësohej konfidencialisht nga pjesa më e madhe e kolegëve të tij për profesionalizmin, kompetencën, integritetin, përgjegjshmërinë dhe ndershmërinë e pashoqe. Ai bëri emër në atë kohë të vështirë, pikërisht falë këtyre cilësive, duke u angazhuar kështu tërësisht me të gjitha aftësitë e tij intelektuale në shërbim të shkencave albanologjike. Detyra që i kishte vënë vetes për botimin e burimeve dokumentare lidhur me mesjetën shqiptare shihej prej tij si domosdoshmëri për fillimin dhe vënien në udhë të mbarë e të qëndrueshme të studimeve historike për këtë periudhë, që do të thoshte gjithashtu një konceptim modern të historiografisë shqiptare. Edhe pasi doli në pension në vitin 1975, ai nuk e ndërpreu punën asnjëherë.

Burimet konsiderohen si rrënjët e kërkimit historik, sepse janë pikërisht ato që na japin të dhënat e nevojshme sikurse janë dokumentet, të cilat përbëjnë “objektet”, “dëshmitë” ndërmjetësuese për t’a bërë të kuptueshëm realitetin e ngjarjeve të së shkuarës. Është interesant fakti se në mënyrë të tërthortë bazat themeltare të mbledhjes dhe botimit të burimeve dokumentare për Shqipërinë dhe shqiptarët i vendosën tre etër jezuitë : At Filippo Riceputi, (1667-1742), Danielo Farlati (1690-1773) dhe Jacobo Coleti (1734-1827), të cilët na lanë kontributin e parë për të mos thënë themelot dhe me mjaft vlerë me dokumentet e ndryshme të botuara, të ndërshtëna në veprën e tyre monumentale *Illyricum Sacrum* në tetë

deklaratë ndoshta do të gjendet në dosjen time të M.P.M. dhe, nëse do të dalë në dritë, do të shihet se nuk më asht dridhun dora kur e shkrova. Hijet e asaj mbramje të zezë më kanë ndjekun gjithë jetën. Edhe sot në pleqninë time kur po thuhet se erdhën kohë të reja (1992), kujtimi i asaj mbramje më ban me u dridhë dhe më pengon që të them çdo gja me hollësi, sepse qeshë porositun me kërcënim që ta mbaja për vete atë propozim dhe, nëse jam gjallë ende, asht sepse fjalën e mbajta deri sot...”. ZAMPUTI, Injac. Njerëz, fakte, ngjarje-kujtime. Dorëshkrim.

⁵⁵ ZAMPUTI, Injac. “Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII. “Studime historike”, 1965, nr. 3, f. 37-59.

⁵⁶ ZAMPUTI, Injac. “Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII. “Studime historike”, 1965, nr. 3, f. 49.

⁵⁷ ZAMPUTI, Injac. “Letër në redaksi. Rreth disa formulimeve të gabueme në artikullin “Elemente të vetëdijes shqiptare për liri, për gjuhën shqipe dhe për arësim në shek. XVI-XVII.”, Në: *Studime historike*, 1965, nr. 3, f. 37-59, *Studime. Historike*, 1967, Nr. 2, fq. 195-199.

volume,⁵⁸ e cila është pa as më të voglin dyshim vepra më e rëndësishme për historinë kishtarë të shqiptarëve e botuar deri më sot, (dhe jo vetëm), sidomos vëllimi i VII-të i saj,⁵⁹ i cili trajton historinë kishtarë të trojeve shqiptare (Kryeipeshkvinë e Tivarit, ipeshkvitë e Arbënisë, Balcit, Budvës, Danjës, Drishtit, Ulqinit, Pultit, Shurdhaut, Sardës, Shasit, Shkodrës si dhe kryeipeshkvisë së Durrësit, ipeshkvinë e Lezhës, Amantias, Apolonisë, Vlorës, Bendës, Priskës, Stefaniakës, Kunavisë, Krujës e Skampës). Aty trajtohet historia e ungjillëzimit të ilirëve dhe përhapja e krishtërit, që prej periudhës apostolike, jepen njoftime për ndërtimin e kishave, manastireve, abacive, katedraleve, jepen kufijtë e ndarjeve administrative kishtarë, kronologjia e hierarkisë katolike me listat e ipeshkvinjve sipas kryeipeshkvive dhe ipeshkvive të marra në shqyrtim; gjenden aty qytete, personalitete kishtarë e laike të kohës, si dhe mjaft dokumente autentike si: bula papnore, diploma të ndryshme, privilegje, fletëdhurata, akte sinodale e konçilesh kishtarë, gjenealogji, stema, biografi, dëftesa, letërkëmbime, ditare, udhëpërshkrime, kontrata, akte noteriale, relacione të ndryshme të vizitave baritore të kryeipeshkvinjve, ipeshkvinjve; legjenda, libra, dorëshkrime të vjetër, kodikë etj, që në të shumtën e rasteve autorët i kanë sjellë të plota e të pacënuara, pra të pashkurtuara e që sot kanë rëndësi të jashtëzakonshme, kur kemi parasysh se për një pjesë të madhe të tyre origjinalet kanë humbur. Botimi i parë më serioz i burimeve dokumentare për historinë mesjetare të Shqipërisë, bërë me kritere rigorozë shkencore u realizua në fillim të shekullit të XX, prej medievistëve: hungarezit Dr. Ludëig Thalloczy (1854-1916), çekut Dr. Konstandin Jireček (1854-1918) dhe kroatit Dr. Milan Šufflay (1879 - 1931), nën redaktimin e këtij të fundit, të cilët i botuan më 1913 dhe 1918 *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis*

⁵⁸ *Illyricum Sacrum*. Tomus primis. Ecclesia Salonitana. Ab ejus exordio usque ad Saeculum quartum Aerae Christianae, auctore, Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. (Superiorum Permissu, ac Privilegio), 1751. f. [V-LII] +1 -780; *Illyrici Sacri*. Tomus secundus. Ecclesia Salonitana. A quarto saeculo Aerae Christianae, usque ad excidium Saloniae. Accessere Vita Diocletiani Imperatoris, Acta Sanctorum ex ejus genere et Marmora Saloniana, auctore, Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. (Superiorum Permissu, ac Privilegio), 1753. f. [III-XII] +1 -636 + [V-XLVIII]; *Illyrici Sacri*. Tomus tertius. Ecclesia Spalatensis olim Salonitana. Auctore, Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. (Superiorum Permissu, ac Privilegio), 1765. f. [III-XVI] +1 -586; *Illyrici Sacri*. Tomus quartus. Ecclesiae suffraganae Metropolis Spalatensis. Auctore, Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. (Superiorum Permissu, ac Privilegio), 1769. f. [III-XI] +1 -528; *Illyrici Sacri*. Tomus quintus. Ecclesiae Jadertina cum suffraganeis, et ecclesia Zagabriensis. Auctore, Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. (Superiorum Permissu, ac Privilegio), 1775. f. [III-XV] +1 -672; *Illyrici Sacri*. Tomus sextus. Ecclesiae Ragusina cum suffraganeis, et ecclesia Rhiziniensis et Catharensis. Auctore, Daniele Farlato presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. (Superiorum Permissu, ac Privilegio), 1800. f. [III-VIII] +1 -540; *Illyricum Sacrum VII. Illyrici Sacri. Tomus septimus, Vol.VII, Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis, et Sirmiensis Cum Earum Suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu et Jacobo Coletto olim Ejusdem Societatis Alumno. Venetiis, MDCCCXVII (1817). Apud Sebastianum Coleti. Superiorum Permissu Ac Privilegio. 1817, f. (III-XVI) + 638; *Illyrici Sacri*. Tomus octavus. Ecclesia Scopiensis, Sardicensis, Marcianopolitana, Achridensis et Ternobensis, Cum Earum Suffraganeis. Auctore. Jacobo Coletto, olim Presbitero Societatis Jesu. Venetiis: Apud Sebastianum Coleti. Superiorum Permissu, Ac Privilegio, 1819, f. (III-XVI) + 330. Duke qenë se vepra gjendej me mjaft vështirësi, në shkurt të vitit 2004, asaj iu bë një ribotim fototipik – anastatik në Prishtinë. *Illyricum Sacrum*, Bibliotheca: monumenta albanica 2. Për botuesin Skënder Blakaj; Këshilli botues: Alain Ducelier, Robert Elsie, Eleutorio Fortino, Rexhep Ismajli, Josip Kolanoviq, Shaban Sinani, Aleksandër Stipçeviq. Botimi i dytë, Second Edition, Arbi Ltd, Prishtinë, 2004. 638 f.

⁵⁹ Ky volum është i përkthyer pjesërisht edhe në gjuhën shqipe nga Imzot Frano Illia në Milot në vitin 1963 dhe gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit (A. Q. SH.), nr. i fondit 569. *Illyricum Sacrum* (19. 03. 1963 - 10. 09. 1963), dosja 40, 223 faqe.

illustrantia. (Akte dhe diploma që ilustrojnë çështje të Arbërisë së Mesjetës).⁶⁰ Ata kanë përmbledhur dokumente, letra, akte kancelarie të fisnikërisë arbënore që i përkasin historisë së Shqipërisë për periudhën 343-1406, (Volumi i parë 344-1343 përmbledh 835 dokumente, ndërsa Volumi i II 1344-1406 përmbledh 812 dokumente), të shpërndara në botime të ndryshme, nxjerrë në Perëndim prej arkivave të Venedikut, Romës, Napolit dhe Raguzës. Studiuesit shqiptar Filip Fishta, na rezultojnë të jetë i pari që pat propozuar dhe nisur punën në vitin 1932, për të përgatitur dhe botuar një seri dokumentesh për historinë e Shqipërisë, seri të cilën ai e pati emërtuar: "MONUMENTA ALBANICA".⁶¹ Ndërkohë projektin metodologjik si strukturë pune për mbledhjen dhe botimin e burimeve për historinë e Shqipërisë e gjejmë tek Lumo Skëndo (Mit'hat bej Frashëri 1890-1949), botuar, në revistën "Përpkjka", 4 vjet më vonë në vitin 1936.⁶² Pas pushtimit të Shqipërisë me 7 prill 1939 nga Italia, u krijua në vjeshtën e atij viti pranë *Reale Accademia d'Italia, Qendra e Studimeve për Shqipërinë (Centro di Studi per l'Albania)*, e cila kishte si qëllim hartimin dhe botimin e një serie kërkimesh shkencore, gjuhësore, letrare dhe antropologjike, ndër të cilat edhe botimin e burimeve dokumentare për historinë e Shqipërisë (*Fonti per la storia d'Albania*) në formën e një koleksioni dokumentesh të titulluar: *Codex Diplomaticus Albaniae/Codice diplomatico albanese* apo *Monumenta Albaniae Historica*.⁶³ Ngjashëm do e përsëriste këtë shqetësim edhe Ilo Mitkë Qafëzezi në vitin 1942, teksa propozonte botimin e një *Corpus Scriptorum Albanensium*.⁶⁴ Motorri i vërtetë i kësaj ndërmarrjeje shumë të rëndësishme u bë P. Giuseppe Valentini S.J, i cili u emërua zyrtarisht anëtar i Qendrës së Studimeve për Shqipërinë më 5 dhjetor 1940, pa lënë mënjanë as P. Fulvio Cordignano-n S.J, dhe Giuseppe Schirò, por edhe të Ermanno Armao-s,⁶⁵ të cilët u bënë orientuesit dhe bashkëpunëtorët më të rëndësishëm të Qendrës, ngaqë ofruan përvojën e tyre personale si dhe bashkëpunimin me qendrën e sivëllezërve të tyre, *Akademine Albanologjike Saveriane* në Shkodër ku ata kishin një arkiv të pasur. Cordignano dhe Valentini kishin realizuar kërkime në Arkivin e Vatikanit (Regestin Vaticano dhe atë Avignonese, fondin

⁶⁰ THALLÓCZY, Ludovicus De, – JIREČEK, Costantinus – ŠUFFLAY, Emilianus De. *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*. (Akte dhe diploma që ilustrojnë çështje të Arbërisë së Mesjetës). Collegerunt et digresserunt Vol. I (Annos 344-1343). Tabulamque geographicam continens). Vindobonae MCMXIII. Vjenë, (1913). Typis Adolphi Holzhausen. XXXVIII + 292 pp; Vol. II. (Annos 1344–1406 continens). Vindobonae, MCMXVIII Vjenë, (1918). Typis Adolphi Holzhausen XXIII + 301 pp. Botimi i dytë fototipik u bë nga Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave & revista EKSKLUZIVE, Tiranë-Prishtinë, 2002. Vepra ishte menduar të kishte 5 volume, por ky projekt nuk u realizua. Shih për këtë letrën që Milan Shyflaj i dërgonte Lumo Skëndos, botuar në revistën *Dituria*, nr. 12. tetor 1928 f. 372 - 374.

⁶¹ FISHTA, Filip. "Ndër gjurmimet e veprimit të "Propaganda Fide" në Ballkan", në: *Hylli i dritës*, Vjeta VIII/1932, Shkodër, korrik - gusht 1932, Nr. 7-8, f. 374.

⁶² SKËNDO, Lumo. "Përpkjka", Revistë e përmuajshme Kulture, Viti I. Vol. I. Tiranë, Tetor 1936. f. 9-14.

⁶³ Për një pamje të përgjithshme lidhur me studimet për Shqipërinë mendoj se mbetet ende aktual një artikull brilant i studiuesit Giuseppe Praga i shkruar në vitin 1940. Shih: PRAGA, Giuseppe. "Lo stato attuale degli studi sull'Albania e i compiti della storiografia italiana". *Rivista Storica Italiana*, Serie 6, vol. V, fasc. II. Milano-Varese, A. Nicola e C. 1940, pp. 206-230. Shih përkthimin shqip: "Gjendja aktuale e studimeve mbi Shqipërinë dhe detyra e historiografisë italiane", në *Pasqyra e t'Rrëfyemit*. Botim i Qendrës Shqiptare të Studimeve Letrare "Pjetër Budi", Viti I, Nr. 1. Janar-Prill 2015. f. 64-96.

⁶⁴ Gazeta "Tomorri", Tiranë, 21. I. 1943.

⁶⁵ ARMAO, Ermanno. *Località, chiese, monti e toponimi varii di un'antica carta dell'Albania Settentrionale*, Pubblicata sotto gli auspici della Reale Società Geografica Italiana (Con facsimile della carta). /Pubblicazioni "dell'Istituto per l'Europa Orientale" - Roma. Seconda Serie. Politica-storia-economia XXVI/, Roma,1933-XI. 195 f. *Vende, kisha, lumenj, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore*, Përktheu Akil Spathari, Botuar nën përkujdesjen e Amb. Willy Kamsi, Korbi, 2006. 220 f.

Borghese, fondin Albani, Nunziatura e Venezia-s), në Arkivin e Propagandës Fide (materialet e shekullit. XVII), në Arkivin e Shtetit të Venezia-s, dokumentet e Senatit, të Këshillit të të Dhjetëve etj. Pasuria e ish-Akademisë Albanologjike Saveriane sikurse ishin muzeu me koleksionet e vyera arkeologjike dhe numizmatike,⁶⁶ biblioteka albanologjike si dhe arkivi me koleksionet dorëshkrimore dokumentare të vjela nëpër arkiva të ndryshme europiane, pa lënë mënjanë koleksionet fotografike, nuk u morën sa e si duhet në konsideratë nga Akademia Italiane, për më tepër pas kalimit të kësaj gjendjeje kalimtare (1939-1944), me ardhjen në pushtet të regjimit komunist, ajo u shkallmua tërësisht duke bërë që një pjesë e mirë e kësaj pasurie, të pësojë të njëjtin fat sikurse edhe ajo e urdhërit françeskan, për të cilën na njofton *de visu* At Zef Pllumi O.f.M.⁶⁷; të shpërndahej në institucione të ndryshme në mënyrë të atillë që të humbeshin gjurmët e kësaj njësie unitare albanologjike, pa llogaritur këtu me këtë rast dëmtimet e pjeshme dhe për fat të keq edhe humbjet e mjafta, tashmë të parikthyeshme. Sidoqoftë veprimtaria e *Akademisë Albanologjike Saveriane* mund të shihet e dëshmuar në një regjistër të bartur nga Arkivi Saverian, i cili gjendet i depozituar në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar, (AQSH), në Tiranë⁶⁸ dhe në një relacion të ruajtur në Arkivin e Akademisë Mbretërore Italiane, të hartuar që të dy nga At Giuseppe Valentini S.J.⁶⁹ Dyshimeve të Jup Kastratit se Valentini kishte marrë me vete dorëshkrime të Xanonit apo pjesë të skedarit të arkivit⁷⁰ Valentini i përgjigjej: «*E këtu vjen pyetja : ku mbaruen dorëshkrimet e Xanonit e ku skedarët e Valentinit? Në mos i paçin marrë Jugosllavët (sikur më tha dikushi), shkodranët kanë se kuj ia sjellin atë pyetje në Shkodër a në Tiranë. Ishallà s'i ká marrë kush per me bā letra cigaresh a për me pështjellë saraga, përpara këtij rilulzimi studimesh qi po sodisim sot prej së largu me andje. Sá për vedi, kur u nisa për Romë më 1943 (nuk ika, por kjeçë dërgue aty për të drejtue botimet e Institutit të Studimevet Shqiptare); e disa duelën, sá patën të holla; nuk mora gjâ me vedi, tue mos parapá se nuk do të ktheheshem, veç pak tesha shtatit, dorëshkrimet e Institutit për t'u botue, nji eksemplar të Bogdanit për do riprodhime për edicjon të rì të P. M. Harapit e dorëshkrimin (jo skedarin e volumit II të «Contributi alla cronologia albanese ». Tjetër gjâ jo, as veglat e punës, si makinat fotografike etj. (tash kush i ká i gëzoftë). Skedarët historikë m'u desht me i hartue sërish në Romë, në Bibliothekë t'Institutit Papnuer Orjental; skedarët e tjerë s'kam si i báj mâ rishtas tue më mungue bibjotheka.»⁷¹*

Zamputti do të rimarrë ribotimin *Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417, - Le Registre de Cadastrage et de Concessions pour le district de Shkodër*

⁶⁶ Për pasurinë numizmatike Muzeut Saverian prej rreth 3.500 monedhash me interes albanologjik dhe jo vetëm, të gjetura në Shqipëris dhe jashtë saj shih: Z. VALENTINI S. J. *Numismatika saveriane*, në: "Leka", Vjeta XI/1939, nr. 4, prill, Shkodër 1939. f. 104-111. Po ai, *Vestigia di Manfredi di Hohenstaufen, Re di Sicilia e Signore di "Romania" in Albania*, në: "Numismatica", Perugia 1939. ("Grafica"), nr. 3. Po ai, *La numismatica in Albania. Esperienze d'un collezionista*, po aty, Perugia 1939, nr. 5-6. Castellani, Giuseppe. *Albania numismatica*. Estr. da: *Rassegna Numismatica*, a. 29 (1932), nn. 7-8-9. Roma: Rassegna numismatica, 1932. 21 pp.

⁶⁷ PLLUMI. At Zef. *Urro vetëm për me tregue*. Botimi i dytë, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006. f. 84-87.

⁶⁸ "Regjistër mbi inventarin e materialit dokumentar arkivor, grumbulluar e sistemuar nga bashkëpunorët e kolegjit "Saverian", përpiluar nga rektori i kolegjit Zef Valentini". Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar, (AQSH), Tiranë. Fondi 134 Urdhëri Jezuit. Dosja 73, 102 fletë.

⁶⁹ "CONCORDIA PARVAE RES CRESCUNT - AKADEMI ALBANOLOGJIKE SAVERIANE - ACADEMIA ALBANOLOGICAE XAVERIANA", *Allegato (copia) al Verbale dell'adunanza del Centro Studi Albania del 20 novembre 1939, anno XVIII*⁰, në: Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei (ASANL), Fondo Accademia d'Italia, Centro di Studi per l'Albania (CSA), b. 1, fasc. fasc. 2.

⁷⁰ KASTRATI, Jup. "Anton Xanoni", në: *Shkodra*, Nr. 1, Shkodër, 1962. f. 105-106.

⁷¹ VALENTINI, Zef S.J. "Skjarime rreth Xanonit", në "Shejzat", nr. 1-2/1963, f. 33.

1416-1417,⁷² të cilin e kishte botuar më parë At Fulvio Cordignano,⁷³ apo sikurse do të bëjë më vonë duke ribotuar të përsaktësuar mjaft dokumente të botuara nga mësuesi i tij P. Giuseppe Valentini në serinë e njohur të tij *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*.⁷⁴

Në vitin 1993 u riatdhesua në Itali, ku sërish vijoi punën e tij mbi dokumentet shqiptare të historisë mesjetare, duke lënë dorëshkrim dy vëllime të tjera me dokumente të transkriptuara e të përkthyer si dhe një autobiografi në trajtën e një ditari kronologjik personal me mjaft interes, i cili prët të botohet. Injac Zamputti vdiq në Tivoli, (Itali) më 28 shkurt 1998, për t'u riatdhesuar sërish në Shqipëri, ku edhe u varros më pas në varrezat e Sharrës në Tiranë më 5 mars 1998, sipas amanetit të lënë prej tij. Megjithëse një punonjës shkencor i dalluar për kontributet e tij për historinë e Shqipërisë, atij nuk i dha asnjë titull shkencor. Asnjëherë nuk ia njohën titullin doktor i shkencave dhe diplomën e marrë në Trieste, megjithëse të gjithë e thërrisnin "Profesor," madje ai u pagua gjithnjë si punonjës me arsim të mesëm dhe asnjëherë nuk i dhanë jo vetëm një titull shkencor, por as edhe një vlerësim dinjitoz për punën e kryer. Në vitin 1995, u dekorua me titullin: "Punonjës i shquar i Shkencës dhe i teknikës " nga Presidenti i Republikës Sali Berisha, me motivacionin: "Për kontribut shumë të shquar në zhvillimin e shkencave albanologjike".

II

Historiani dhe filologu

"Die Geschichte beginnt dort, wo Denkmäler verständlich werden und wo glaubwürdige Dokumente existieren". **"Historia nis aty ku monumentet bëhen të kuptueshëm dhe ku ekzistojnë dokumente të denja për t'u besuar."** [Leopold von Ranke (1795-1886)].

Punës së madhe përgjatë dyzetë vjetëve për transkriptimin dhe përkthimin e dokumenteve burimore origjinale nga latinishtja dhe italishtja mesjetare,⁷⁵ i shtoi edhe kontributin e tij me studime historike përkatëse për këtë epokë,⁷⁶ periudhë e cila ishte ende në atë kohë një nga më të errëtat në historinë e Shqipërisë. Janë me mijëra skeda

⁷² ZAMPUTI, Injac. *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417*, - *Le Registre de Cadastrage et de Concessions pour le district de Shkodër 1416-1417*. Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Tiranë, 1977. 499 f.

⁷³ Shih: CORDIGNANO, Fulvio. *Catasto veneto di Scutari : [1416-1417] / [a cura di] Fulvio Cordignano*, 2. ed: Tolmezzo, Stab. grafico Carnia, 1944. 189 pp. 2: *Registrum concessionum*. Roma : Tip. poliglotta Cuore di Maria, 1942. 171 pp; *Onomasticon del Catasto veneto di Scutari e Registrum concessionum : [1416-1417] / [a cura di] Fulvio Cordignano*. Tolmezzo : Stab. grafico Carnia, 1945. 90 pp.

⁷⁴ *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*, Joseph Valentini S. J. *Labore reperta et transcripta*. Pars Tertia (Scanderbegianam Periodum complectens), Vol. I - XXIV. Munchen, 1951 - 1973.

⁷⁵ "Pasqyrim i punës shkencore të bërë nga Injac Zamputi në Insitutin e Historisë". Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 13. 157 fletë.

⁷⁶ Një pamje e plotë rreth punës së tij mund të shihet në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar, (AQSH), Tiranë. Fondi 846 i përbërë prej më shumë se 100 dosjesh, të cilat iu dhuruan arkivit në fjalë në vitin 2010 nga djali i tij Jozef Zamputi.

dhe mijëra faqe të "Shkenca duhet të jetë rigorozë në të gjitha anët, por sidomos në bazat mbi të cilat ajo vepron."- do të shprehej ai.⁷⁷ Injaz Zamputti me punën e tij skrupuloze mbështetur mbi dokumentacionin e shqyrtuar, botoi në mënyrë sistematike një varg studimesh në formë artikujsh që u botuan në *Buletin e Shkencave Shoqërore*, në revistat *Studime Historike*, *Studime Filologjike*, *Iliria*, *Studia Albanica*, etj. E fillon me zberthimin e alfabetit të Anonimit të Elbasanit për ta përfunduar mbas tridhetë vjetësh tek zberthimi i Mbishkrimit të Arbënit, të cilët sollën një pamje dhe këndvështrim të ri të kësaj periudhe të patrajtuar majftueshëm deri atëherë në studime. Ndër punimet e tij të para ishte transkriptimi i alfabetit të dorëshkrimit të njohur si "Anonimi i Elbasanit", të cilin e shoqëroi me komentin përkatës, duke përsaktësuar e datuar kohën e shkrimit të tij në shek. XVII, si dhe duke argumentuar me këtë rast edhe lëvizjen e ritit ortodoks të shoqëruar me një liturgji përkatëse në gjuhën shqipe.⁷⁸ Po kështu transkripto alfabetin e panjohur të shek. XIX, të një poezie me përmbajtje bektashiane,⁷⁹ si dhe trajtoi udhën e mundimshme të shqipes që solli alfabetin e Kongresit të Manastirit.⁸⁰ Më pas botoi shkrimet lidhur me luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesit turk në vitet 1479-1492;⁸¹ projektet shqiptare për çlirimin e vendit në vitet 1577-1621;⁸² bashkimin e Maleve shqiptare dhe ekspeditën e Vuço Pashës në Kelmend;⁸³ gjendjen në krahinën e Dukagjinit dhe Pultit në gjysmën e parë të shekullit XVII,⁸⁴ si dhe rëndësinë ndërkombëtare të Kuvendeve shqiptare në shekujt XVI-XVII,⁸⁵ të cilat në vitin 1961 përmblihen shkurtazi në monografinë *Përpyjekjet Shqiptare për liri i pavarësi në shek. XVI-XVII*,⁸⁶ fryt ky i punës së dalë nga shqyrtimi i imët i dokumentacionit arkivor të asaj periudhe, por për fat të keq këtu nuk i janë bashkangjitur referimet e duhura të artikujve të

⁷⁷ ZAMPUTI, Injac. "Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit". *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1995, Nr. 5-6, f.17.

⁷⁸ ZAMPUTI, Injac. "Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të anonimit Elbasanas", *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Nr. 1, 1949, f. 55-57, dhe posaçërisht "Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit - transliterim, transkriptim dhe koment". *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë. 1951, nr. 3-4, f. 64-131

⁷⁹ ZAMPUTI, Injac. "Një dorëshkrim bektashjan i gjysmës së dytë të shek. XIX». *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë. 1955, nr. 4, f. 203-210.

⁸⁰ ZAMPUTI, Injac. "Kontribut për historikun e alfabetit tonë". *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë. 1957, nr. 1, f. 184-199.

⁸¹ ZAMPUTI, Injac. « Luftat e popullit shqiptar kundër pushtimit turk në vjetët 1479-1492 ». *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë. 1956, nr. 1, f. 76-95.

⁸² ZAMPUTI, Injac. «Projektet shqiptare për çlirimin e vendit drejtue Evropës në vjetët 1577-1621 ». *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë. 1956, nr. 4, f. 116-132.

⁸³ ZAMPUTI, Injac. « Bashkimi i Maleve shqiptare në fillim të shekullit XVII-të - Ekspedita e Vuço Pashës mbi Kelmend më 1638. *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, seria për Shkencat Shoqërore, 1957, nr. 1, f. 63-95.

⁸⁴ ZAMPUTI, Injac. *Dukagjini dhe Pulti në gjysmën e parë të shekullit XVII - Të dhana mbi diferencimin shoqor*. *Buletin i Shkencave Shoqërore*. Tiranë, 1959, nr. 1, f. 3-20.

⁸⁵ ZAMPUTI, Injac. « Randësia ndërkombëtare e Kuvendeve shqiptare në kalim prej shekullit XVI në të XVII-tin », *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, 1962, nr. 4, fq. 140-152. Ribotuar në : *Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike*, Tiranë 1965, f. 498-505, botuar në përktimin italisht në: *Rassegna di Studi Albanesi*, nr. 1. Tiranë, 1963, f. 101-109.

⁸⁶ ZAMPUTI, Injac. *Përpyjekjet e shqiptarëve për liri në dy shekujt e parë të sundimit otoman*. "Naim Frashëri", Tiranë, 1961. 123 f.

mëparshëm të autorit që i përmendëm më sipër, sikurse këtë tematikë ai e zgjeroj edhe më tej.⁸⁷ Seria e studimeve të tij në fushën e historisë politike të Shqipërisë fillon mbas epokës së Skënderbeut dhe mbërrin deri tek Bushatlitë, duke arritur të plotësojë kështu një zbrastësi të madhe që ekzistonte deri në atë kohë për të lidhur epokën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me shekullin XVIII. Periodizimi i lëvizjeve shqiptare për çlirim është kryekëput rezultat i studimeve të Injaz Zamputit dhe në këtë periodizim tashmë mbështetet e gjithë historiografia shqiptare mes shekujve XVI-XVII. Ishte pikërisht Zamputi ai që ndërmori studimin e personaliteteve, shkrimtarëve të Letërsisë së Vjetër Shqipe, qysh nga Buzuku, Budi Bardhi e Bogdani; katër klerikët që i kanë vënë bazat letërsisë shqipe dhe që kanë luftuar që të mos humbiste gjuha shqipe, por edhe për të kundërshtuar synimet e klerit katolik sllav që dërgohej në Shqipëri për të sunduar dioqezeat e Shkodrës dhe të Lezhës. Kjo bëri që të dilnin në dritë jeta dhe veprimtaria e personaliteteve me rëndësi të botës shqiptare apo autorëve të hershëm të letërsisë shqipe sikurse Gjon Buzuku,⁸⁸ Pjetër Budi,⁸⁹ Frang Bardhi,⁹⁰ Pjetër Mazrreku,⁹¹ Pjetër Bogdani,⁹² ndërkohë që për autorët e mëvonshëm bëri përjashtim vetëm Ndre Mjeda.⁹³ Në vitin 1984 botoi tek revista *Iliria* studimin lidhur mbi rindërtimin Mbishkrimit të Arbërit, si një mundësi për leximin e tij për herë të parë në mënyrë të plotë.⁹⁴ Një lloj ngushëllimi për të erdhi në fund të viteve 80-të kur iu dha e drejta e publikimit të studimeve të tij në shtypin shkencor si dhe iu botua përkthimi i librit *Burgimet e mija* të Pashko Vasës (1989). Meqenëse shoqëria shqiptare, kryesisht në veri të vendit, ishte shndërruar në qendër të qëndresës kundër pushtesit osman dhe, meqenëse duke studiuar historinë politike duhej të njihje mjedisin e saj, Zamputi u mor edhe me studime etnike, demografike, zakonore, sikurse ka trajtuar dukuritë e ndryshme të shoqërisë kanunore duke argumentuar se Kanuni ka qenë një nga mjetet pozitive për rruajtjen e shqiptarizmit dhe nuk ka qenë çdo gjë negative sikurse e propagandonin studiuesit marksistë.⁹⁵ Në vitin 1993, botoi dy veprat studimore kushtuar dy autorëve të rëndësishëm të letërsisë shqipe: At Gjergj Fishtës dhe Ismail

⁸⁷ ZAMPUTI, Injac. « Aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare në shekujt e parë të pushtimit otoman veçanërisht në vjetët 1593-1620 ». *Studime Historike*, 1967, nr. 3, f. 113-128.

⁸⁸ ZAMPUTI, Injac. « Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në Letërsinë e Vjetër Shqiptare. » *Studime Filologjike*. Tiranë, 1986, nr. 3, f. 185-204.

⁸⁹ ZAMPUTI, Injac. « Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit. Letra drejtue me 1621 kardi nalit Gozzadino ». *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë. 1958, nr. 2, f. 67-94. Shih: Arkivin Qendror të Shtetit (A.Q.Sh.), Fondi 846, Dosja 22 dhe 23.

⁹⁰ ZAMPUTI, Injac. « Qëmtime për Budin e Bardhin ». *Studime Historike*. Tiranë, 1985, nr. 1, f. 165-176.

⁹¹ ZAMPUTI, Injac. *Pjetër Mazrreku dhe Fjalorthi i tij i vjetit 1633*. *Studime Filologjike*. Tiranë, 1964, nr. 2, f. 167-174. *Studia Albanica*. Tirana, 1964, nr. 2, f. 129-136.

⁹² ZAMPUTI, Injac. « Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit ». *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1954, nr. 3, f. 39-56. *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*. *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1963, nr. 2, f. 199-207.

⁹³ ZAMPUTI, Injac. « Si e njoha unë Ndre Mjedjen » në: *Nëntori*, Revistë letrare, artistike, shoqërore e politike, Viti 7, Nr. 8. gusht, 1960, f. 203-214.

⁹⁴ ZAMPUTI, Injac. « Rindërtimi i Mbishkrimit të Arbërit dhe mundësitë e reja për leximin e tij ». *Iliria*, 1984, nr. 2, f. 207-218.

⁹⁵ ZAMPUTI, Injac. "Pozita shoqërore e grues malësore shqiptare sipas kanunit", në: *Buletin i Universitetit Shtetëro të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1961, Nr. 2, f. 101-123.

Kadaresë, të titulluara përkatësisht: *Fishta – Koha, Njeriu, Vepra*⁹⁶ dhe *Ekskursion në dy vepra të Kadaresë; Autobiografia e popullit në vargje dhe Eskili ky humbës i madh*.⁹⁷ Jo çdo gjë që shkruante ai botohej. Shkrimet e tij kalonin nëpër një proces rigoroz kontrolli dhe merrnin aprovimin e redaksisë pasi ai të pranonte të gjitha vërejtjet (disa here edhe shtrembërimet) që pretendonte edhe më i papërgatituri mediokër diskutues që “mbronte vijën e Partisë dhe të ideologjisë marksiste” në Institut. Për shumicën e rasteve “barka e shpëtimit” ishte Aleks Buda që firmoste. Një pjesë e mirë e studimeve të tij, mbasi diskutoheshin, nuk merrnin aprovimin për botim dhe për rrjedhje mbeteshin dorëshkrim dhe si të tilla ruheshin ndër sirtarët e kolegëve të tij. Në vitet 1995-1997, një pjesë e këtyre studimeve me shumë interes u botuan në revistën *Hylli i Dritës*.⁹⁸ Ndër ta ishin ai për fillimet e letërsisë në gjuhën shqipe, që trajton interpretimin e gabuar që i është bërë dëshmisë që njihet me emnin e Brokardit (fillimi i shekullit XIV) në lidhje me lashtësinë e shkrimit të shqipes,⁹⁹ dy mbishkrimeve të fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me Principatën e Arbërit,¹⁰⁰ përdorimin e disa fjalëve në praktikën fetare katolike,¹⁰¹ si prejardhjen e toponimit Valbona.¹⁰² Është marrë po ashtu edhe me studimin e pushtimit romak në bregoren shqiptare, me principatat shqiptare, me vendosjen e zotnimit venedikas dhe me marrëdhëniet feudale dhe agrare në rrethin e Shkodrës në dy dekadat e para të zotnimit venedikas (shek. XIV-XV), ku veçohen disa përsaktësime toponimike lidhur me aksionin kolonizues të grek Dionisit të bregdetit shqiptar e luftërat iliro-romake, ku solli si shembull korrigjoimin e interpretimit të historiografisë tradicionale që pikën e quejtun “Lissa” që e çon te ishulli dalmatin dhe argumenton se “Lissa” e historianëve romakë është “Ishmi”. Në këtë mënyrë qartësohen pasiguritë gjeografike që studiuesit modernë i kanë vënë në dukje se gjenden te historianët e lashtë.¹⁰³ Po

⁹⁶ ZAMPUTI, Injac. *Fishta, koha, njeriu, vepra*. “Pasqyra...”, Tiranë, 1993. 175 f.

⁹⁷ ZAMPUTI, Injac. *Ekskursion në dy vepra të Kadaresë*, Shtëpia Botuese “Dituria”, Tiranë, [1993], 235 f.

⁹⁸ Pas vdekjes së tij, nën kujdesin e të birit Jozef Zamputti, u botuan në revistën *Hylli i Dritës*, sipas dorëshkrimeve edhe punimet e mëposhtme: “Kujtime për Dom Ndre Mjeden”. Nr. 2, 2011, f. 122-141; “Gjon Kole Kujxhija”. Nr. 3, 2011, f. 131-136; “Kronika e Shkodrës”. Nr. 4, 2011, f. 69-84; “Çashtja e kombësisë në shekullin XVII”. Nr. 2, 2012, f. 49-52; “Shënime për fazën përfundimtare të lëvizjes shqiptare dhe të ekspeditës së Gjon Kastriotit”. Nr. Jubilar, 2013, f. 277-300; si dhe “Pozita shoqërore e grues malësore shqiptare sipas Kanunit”. *Hylli i Dritës*, Tiranë, 2015, Nr. 3-4, f. 164-190.

⁹⁹ ZAMPUTI, Injac. “Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe.” *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1995, Nr. 1-2, f. 14-51.

¹⁰⁰ ZAMPUTI, Injac. “Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit”. *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1995, Nr. 5-6, f. 16-29.

¹⁰¹ ZAMPUTI, Injac. “Mbi disa fjalë të kristalizueme në lutjet e në praktikën fetare katolike”. *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1996, Nr. 1-2, f. 9-17.

¹⁰² ZAMPUTI, Injac. “Valbona – argumente dhe dëshmi në lidhje me prejardhjen e këtij toponimi”. *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1996, Nr. 3-4, f. 68-79.

¹⁰³ ZAMPUTI, Injac. “Përsaktësime në toponiminë me fiset përkatëse n’aksionin kolonizues të Dionisit në luftat iliro-Romake”. *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1997, Nr. 1-2, f. 25-49.

ashtu përgatiti dhe botoi me paraqitje të tekstit të transkriptuar, përkthimin dhe rindërtimin e dokumentacionit të «Regestit Kamsi», punuar me shënime plotësuese.¹⁰⁴

Injac Zamputti e nxori historinë e Shqipërisë të periudhës së sundimit të zymtë osman (shek. XVI-XVIII), nga kronikat provinciale, thujse të panjohura e të shpërndara andej-këndej ndër burime të pakta dokumentare të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke e shndërruar atë në një seri të plotë dokumentare, unike e të munguar për këtë periudhë historike, seri e cila shkëlqen jo vetëm për nga sasia por mbi të gjitha për nga cilësia e saj.¹⁰⁵ Udhëtimi i tij në një tokë djerrë dhe të pashkelur më parë, e cila që me vdekjen e Gjergj Kastriotit (1468) dhe rënien e Shkodrës (1479), rëndom konsiderohej si një periudhë 5 shekullore e humbur, apo e thënë ndryshe “periudhë e errësirës”, që gjithsesi kishte “prodhuar” historinë e saj, rezultoi jo vetëm frutdhënës, por mbi të gjitha themelor në shkrimin e historisë së popullit shqiptar për këtë periudhë kohore. Vepra dokumentare dhe studimore e Injac Zamputti-t ia arriti të provojë qartazi se përkundrejt frakturës së rëndë politike-ekonomike dhe kulturore që kreu pushtimi osman, ai nuk arriti të bënte atë që pretendonte e pretendon të bëjë historiografia ballkanike; orientimin ideologjik i periudhës së regjimit komunist (1945-1990) dhe tash së voni edhe disa qyqarë të sevdasë neootomane, të kontaminuar me përbërës ngjyrosës nga shkretëtirat arabike, të cilët kishin dhe kanë si shumatore të përbashkët mendimin që e konsideronte kinse këtë periudhë si një shkëputje e pakthyeshme e lidhjeve të botës shqiptare me botën përëndimore, që rrekej në fund të fundit ta zhvendoste e ta paraqiste Shqipërinë në Lindje. Dokumentacioni që pruri Zamputti tregoi qartë se shqiptarët pavarësisht bindjeve fetare (katolikë ose ortodoksë, apo më pas duke marrë fenë e pushtuesit e duke u konvertuar me dhunë apo për privilegje në myslimanë), edhe përgjatë kësaj periudhe “përgjumjeje” vijonin të ishin të orientuar nga Europa, jo thjesht si një alternativë e detyruar nga nevoja, por mbi të gjitha se ata e shihnin dhe e shohin edhe sot këtë orientim si një ndjesi dhe njëkohësisht si një përkatësi identitare. Këtë e tregon qartazi dokumentacioni i kohës i përcjellë nga Injac Zamputti, prej të cilit merret vesh se shqiptarët janë në komunikim dhe marrëdhënie të ngushtë me Republikën e Venedikut e Republikën e Raguzës, me Mbretërinë e Napolit, me Mbretërinë e Spanjës dhe Selinë e Shenjtë. Këtë barrë përgjegjësie shkencore, fati e deshi ta ndërmernte vetiu mbi shpatulla këtu e gjashtëdhjetë vjet më parë një dijetar i tillë, më një profil elitar për të cilin familja puna dhe atdheu ishin si uji, ajri e zjarri, përmes të cilëve ai përballoi, trysninë intelektuale të një monodrame vetmitare e cila nuk e ligështoi, nuk e demoralizoi dhe nuk e dëshpëroi për asnjë çast të vetëm, por i dha mundësinë të gëzojë me modestinë që e karakterizonte për gati 9 dhjetëvjeçarë frymën dhe *corpin* e

¹⁰⁴ ZAMPUTI, Injac. “Regesti Kamsi. Paraqitja, teksti, përkthimi dhe rindërtimi i dokumentacionit mbi të cilin asht mbështetur në përpiluesin e Regestit”. *Hylli i Dritës*, Vjeti XXV, Tiranë, 1997, Nr. 5-6, (246-247). f. 70-95

¹⁰⁵ Njëfarë pamje fillestare mund të shohet në: “Bibliografi provizore e dokumentave të shek. XVII- XVIII (1675-1718) të punuara nga Injac Zamputti për historinë e Shqipërisë”. Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 5. 84 fletë.

paqtë që frymonte bota e tij e pasur e shpirtit. Me të drejtë ka theksuar historiani Pëllumb Xhufi se “...falë tij, [Injac Zamputtit, shënimi im K.M], *historia e Shqipërisë në shekujt e sundimit osman mbeti një histori evropiane dhe nuk u katandis në një kronikë provinciale otomane.*”¹⁰⁶

Kontributi dhe trashëgimia e tij e pasur shkencore pranë Institutit të Shkencave dhe atij të Historisë, përfshin pjesën më të madhe të dokumentacionit të shekujve XVI-XVII, (tre shekujt të parë të sundimit osman), dhe veçanërisht dokumentacionit kishtar të kësaj periudhe. Këtë dokumentacion ai e transkriptoi, përktheu, komentoi dhe botoi në dhjetë vëllime me një akribi të rrallë shkencore nën logon e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Historisë, vëllime të cilat janë ende të pakalueshme dhe përbëjnë serinë themelore të burimeve për historinë e Shqipërisë të botuara në Shqipëri. Si burime kryesor i studimit hulumtues për gjetjen e dokumentacionit dhe më pas përpunimit dhe seleksionimit të tij, i kanë shërbyer vjeljet e kryera nga fondet jashtëzakonisht të pasura të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë,¹⁰⁷ e cila ka ndërmjetësuar sigurimin përmes praktikës së huazimit apo mikrofilmimit të botimeve të rralla nga bibliotekat e huaja apo botime dhe dokumente të mikrofilmuara që i kishte biblioteka dhe Arkivi i Instituti i Historisë, ardhur përgjithësisht nga Arkivat e huaja, të cilët ia vunë në dispozicion autorit, ndërkohë që pjesa tjetër përbëhej nga materiale të pabotuara që ruheshin në Arkivin Qendror të Shtetit,¹⁰⁸ si pjesë nga fondet dokumentare të konfiskuara nga nga shteti komunist në Arkivin e Jezuitëve, Arkivin e Françeskanëve, Arkivin e Kryeipeshkvisë së Shkodrës, Arkivin e Kryeipeshkvisë së Durrësit etj.¹⁰⁹ Janë më shumë se 5000 faqe me dokumente të botuara të dala nga dora e tij, ndërkohë që rreth 1500 të tjera mbeten ende të pabotuara. Të gjitha këto vëllime janë botuar me transkriptimet origjinale, përkthimet përkatëse, me indekset e emrave të personave e të vendeve dhe me shpjegimet e duhura. Është e qartë se Zamputi duke jetuar e punuar në mjediset e jezuitëve, pasaçërisht mes Ndre Mjedës, Giusepe Valentini-t dhe Fulvio Cordignano-s, duke parë punën e tyre lidhur me arkivimin e dokumenteve kishte krijuar një përvojë të vlefshme e cila i shërbeu më pas në riorganizimin e Arkivit të Shtetit dhe atij të Historisë. Duke qenë se ai kishte kaluar nëpër duar *de visu* koleksionet dokumentare, i kishte inventarizuar dhe i kishte kataloguar ato, do të thotë se ai kishte një pamje të plotë rreth përmbajtjes së fondeve. Bazuar në prioritet e vëna nga Instituti i Historisë për shkrimin e Historisë së Shqipërisë në 3 vëllime, vëllimi i parë i së cilës u botua në vitin 1959,¹¹⁰ Zamputi pati edhe pjesën e tij. Në pjesën e tretë të këtij vëllimi, në kapitujt VII dhe VIII, Zamputi ka dy nënkapituj. I pari mban

¹⁰⁶ XHUFË, Pëllumb. “Historia evropiane e Injac Zamputtit”. *Shekulli*. Nr. 2878, 14 shkurt, 2010, f. 16 - 17.

¹⁰⁷ ZAMPUTI, Injac. « Parathënie », në: *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Historisë Vëll.I. (1507-1592), Tiranë 1988, f. 4.

¹⁰⁸ ZAMPUTI, Injac. « Parathënie », në : *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. IV. (1479-1506), Pjesa I, (1479-1499). Mihal Duri, Tiranë 1967. f. 5.

¹⁰⁹ *Këto fonde gjenden të depozituara në Arkivin Qendror të Shtetit (A.Q.Sh.) : Fondi 131, Argjipeshkvia e Durrësit (1631-1967), 75 dosje; Fondi 132, Argjipeshkvia e Shkodrës (1638-1966), 3487 dosje; Fondi 132/A, Argjipeshkvia e Shkodrës (1892-1911), 585 dosje; Fondi 133, Urdhëri Françeskan (1710-1967), 1677 dosje; Fondi 133/A, Urdhëri Françeskan (1763-1965), 270 dosje, si dhe Fondi 134, Urdhëri Jezuit (1189-1954). 263 dosje (1760-1954).*

¹¹⁰ *Historia e Shqipërisë*. Vëllim i Parë. Përgatitur nga një kolektiv punonjësish shkencorë të sektorëve të historisë së kohës së lashtë dhe të kohës së mesme. Hartuar nga Selim Islami-Kristo Frashëri. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1959. 544 f.

titullin : « Vazhimi i rezistencës shqiptare në malësi (1480-1506), »¹¹¹ ndërsa i dyti : « Vatrë e qëndresës shqiptare në shek. XVI-XVII»¹¹² mbetej prioritet shqyrtimi i dokumentacionit arkivor dhe natyrisht kontributi i Zamputit ka qenë vendimtar. Kjo mund të shihet fare qartë në përgatitjen dhe botimin e vëllimeve me dokumente që pasuan vëllimin e parë të këtij teksti,¹¹³ i cili më pas u pasua më pas edhe nga dy vëllimet e tjera, e ku dora e Zamputit pa dyshim ka pasur vendin e saj të rëndësishëm. Por ndryshe nga këta vëllime me dokumente, të cilat u botuan pa transkriptimet e origjinaleve, Zamputi në botimet e mëvonshme i ikën punës kolektive të mëhershme dhe i kthehet statusit të dokumentit si i tillë dhe falë përvojës që testoi me publikimet e herpashershme në Buletinin e Shkencave, sikurse ishte rasti me relacionet e Frang Bardhit e të Pjetër Budit bëri të mundur që në vitin 1963 dhe 1965 të botonte dy vëllimet e njihura me relacione të gjysmës së parë të shekullit XVII. Nga botimet e tij kryesore (dhjetë volume të tjera me dokumentacion historik), veçohen përmbledhja me dokumente kishtarë me titull: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*.¹¹⁴ Vëllimi i parë ka 39 dokumente gjithsej, 16 prej të cilëve janë relacione, 19 janë letra 1 informacion, 2 janë dëshmi dhe 1 është pasqyrë. Vëllimi i dytë ka 114 dokumente nga të cilët 19 janë relacione, 75 janë letra dhe 20 janë të tjera si 3 dëshmi, 1 pasqyrë, 1 urdhëresë 8 lutje, 1 dëftesë, 1 informacion, 3 kërkesa 1 promemorie dhe 1 interdikt.¹¹⁵ Po ashtu përktheu dhe përgatiti për botim: *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417, - Le Registre de Cadastrage et de Concessions pour le district de Shkodër 1416-1417*,¹¹⁶ i cili përbën një burim me rëndësi për njohjen e krahinës së Shkodrës në fillim të shek XV. Ai ka të regjistruar të gjithë fshatrat e komunës së Shkodrës, emrat e banorëve të tyre, sasinë e detyrimeve, tokat dhe vreshtat e komunës, si doganat dhe peshkoret, bashkë me të ardhurat e tyre. Në botimin *Dokumenta të shekullit XV për Historinë e Shqipërisë*. Vëll. IV (1479-1506). Pjesa I (1479-1499).¹¹⁷ Përgatitur nga Injac Zamputi, Tiranë, 1967, pjesa e parë e dokumenteve të këtij vëllimi trajton dokumentacionin lidhur me rënien e qyteteve dhe

¹¹¹ *Historia e Shqipërisë*. Vëllim i Parë. Përgatitur nga një kolektiv punonjësish shkencorë të sektorëve të historisë së kohës së lashtë dhe të kohës së mesme. Hartuar nga Selim Islami-Kristo Frashëri. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1959. f. 314-323.

¹¹² *Historia e Shqipërisë*. Vëllim i Parë. Përgatitur nga një kolektiv punonjësish shkencorë të sektorëve të historisë së kohës së lashtë dhe të kohës së mesme. Hartuar nga Selim Islami-Kristo Frashëri. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1959. f. 352-371.

¹¹³ *Burime të zgjedura për historinë e Shqipërisë*. Vëll. II, Shek. VIII-XV. Përgatitur nga A. Buda, I. Zamputi, K. Frashëri (Red. Përgjegjës), P. Pepo. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, Mihal Duri, 1962. 409 f; *Burime të zgjedura për historinë e Shqipërisë*. Vëll. III. Shqipëria nën sundimin feudal ushtarak otoman (1506-1839). Përgatitur nga I. Zamputi, S. Naçi, Z. Shkodra, A. Buda (Red. Përgjegjës), Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, Mihal Duri, 1961 (1962). 336 f.

¹¹⁴ ZAMPUTI, Injac. *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3 dhe 3/2, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. Vëll. II. (1634-1650). Tiranë 1965. Vëll. I. 540 f. Vëll II. 525 f.

¹¹⁵ Lidhur me këtë argument shih edhe «Studim i Injac Zamputit me temë "Mbi politikën e Vatikanit në aksionin kishtar në vendin tonë në gjysmën e parë të shek XVII", bashkë me skeda studimi të autorit për të njëjtën temë». Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 29. 316 fletë.

¹¹⁶ ZAMPUTI, Injac. *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës, 1416-1417, - Le Registre de Cadastrage et de Concessions pour le district de Shkodër 1416-1417*. Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Tiranë, 1977. 499 f,

¹¹⁷ ZAMPUTI, Injac. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. IV. (1479-1506), Pjesa I, (1479-1499). Mihal Duri, Tiranë 1967. 311 f.

kështjellave të fundit të Shqipërisë në duart e turqve në 1479 përmes 373 dokumenteve, kurse pjesa e dytë (1499-1506), e botuar në vitin 1979,¹¹⁸ përmban një shtojcë plotësuese të pjesës së parë me 58 dokumente, si dhe dokumentacionin vijues që shkon deri në fund të vitit 1506 me plot 456 dokumente. Një pjesë e mirë e shtojcës plotësuese prej 58 dokumentesh të renditura më numër progresiv rendor të pavarur, ribotohen të zëvendësuara, të plotësuara dhe të korrigjuara, ku nuk mungon e shënuar edhe natyra e punës së re përkatëse, mbasi autori ka pasur rastin kësaj here të punojë drejtpërdrejt mbi fotokopjet e nxjerra nga arkivat përkatëse,¹¹⁹ e cila tregon se kjo është një dëshmi konkrete rëndësisë që i jepte ai punës mbi dokumentet. Kjo periudhë dokumentare pasqyron përpjekjet e shqiptarëve për të rimëkëmbur principatën e Kastriotëve. Në katër vëllimet me titull: *Dokumentet të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*. Tiranë, Instituti i Historisë, 1989. Vëllimi I, (1507-1592). Përgatitur nga Injac Zamputti, 1989; Vëllimi II, (1593-1602). Përgatitur nga Injac Zamputi, 1990. Vëllimi III, (1603-1621). Përgatitur nga Injac Zamputi: Vëllimi IV, (1675-1699). Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha, 1990,¹²⁰ përfshihen gjithsej 921 dokumente venedikase, raguziane dhe dokumente austriake në gjuhët italisht dhe gjermanisht me prejardhje nga kancelaritë e Venedikut, Raguzës, dhe Vjenës (Vëllimi i parë ka 280 dokumente, vëllimi i dytë ka 195 dokumente, vëllimi i tretë 211 dokumentet dhe vëllimi i katërt 235 dokumente), të cilët sjellin të dhëna me vlerë për krahinën perëndimore bregdetare që në shumicën e tyre botoheshin për herë të parë e që sillin të dhëna për trevat verilindore të Kosovës dhe rrafshit të Dukagjinit përmes informacioneve me hollësi lidhur me veprimet luftarake të ushtrisë austriake në këto vise për pushimin e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, kështjellës së Kaçanikut, si dhe për depërtimin deri në thellësi të krahinës së Lumës. Këto dokumente dëshmojnë qartazi se trevat e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit ishin troje të banuara kryesisht nga popullsi shqiptare dhe përfshiheshin në konceptin gjeografik dhe etnik të Shqipërisë dhe kundërshtojnë pikëpamjet nacionaliste të mjaft studiuesve jugosllavë lidhur me popullsitë gjoja autoktone serbe në ato territore. Është kjo periudhë e cila shënon një pikë me rëndësi në organizimin e lëvizjes për çlirim nga pushtimi osman, përmes organizimit të kuvendeve shqiptare si një formë e lartë e organizimit politik shqiptarë sikurse ishte Kuvendi i Dukagjinit, në të cilin morën pjesë 2656 krerë prej 13 krahinave shqiptare, që i bie të kenë qenë të pranishëm rreth 200 krerë për secilën krahinë. Injac Zamputti përveç veprave të botuara, ka lënë edhe disa dorëshkrimet me vlerë ku spikat: Vëllimi i tretë me dokumente të nxjerra nga Arkivi i Kongregatës së Propagandës Fide në Romë të transkriptuara e të përkthyer të periudhës mes viteve 1623-1653, me 169 dokumente e pjesë relacionesh të transkriptuara e të përkthyer + 61 dokumente të transkriptuara pa përkthim), vëllim ky vijues i dy vëllimeve të botuara tashmë para 50 vjetësh me titullin: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*. Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputti. Vol. I. (1610 - 1634). Tiranë 1963. Vol. II. (1634 - 1650). Tiranë, 1965, vëllim i cili u botua në vitin 2015 me titullin : *Dokumente për historinë e*

¹¹⁸ ZAMPUTI, Injac. *Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506*. Akademia Shkencave e R.P.S të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Pjesa e dytë (1499-1506), Përgatitur për botim nga Injac Zamputi. Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Instituti i Historisë, Tiranë, 1979. 559 f.

¹¹⁹ ZAMPUTI, Injac. « Parathënie », *Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506*. Akademia Shkencave e R.P.S të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Pjesa e dytë (1499-1506), Përgatitur për botim nga Injac Zamputi. Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Instituti i Historisë, Tiranë, 1979. f. 3.

¹²⁰ ZAMPUTI, Injac. *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Historisë Vëll.I. (1507-1592), Tiranë 1988, 490 f; vëll.II. (1593-1602), Tiranë 1990. 387 f; Vëll. III. (1603-1621), Tiranë 1989. 465 f; Vëll. IV. (1675-1699). Me bashkëautor dhe Selami Pulahën. Tiranë, 1990. 569 f.

*Shqipërisë "(1623-1653)/Documenti per la storia dell' Albania 1623-1653.*¹²¹ Po ashtu në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë ruhet përkthimi i relacionit të Imzot Vinçenc Zmajevičit të vitit 1702, me titullin: *Relacion i gjendjes së Shqipërisë dhe Serbisë (nënkupto: Kosovës - K. M), të vizituara nga Vinçens Zmajevič, Arqipeshkëv i Tivarit në vitin 1702 - 1703 (Tivari - Shkodra - Postriba - Pulti - Sapa (Zadrima), Lezha - Durrësi - Serbia (Kosova),*¹²² si dhe një tjetër me titull: *Dokumente të shekullit të XVIII për historinë e Shqipërisë, Vol. I. (1700 - 1718),*¹²³ si dhe dy vëllime të tjera me dokumente të shekullit XV, përgatitur për botim vijim i vëllimit *Dokumete për historinë e Shqipërisë të shek. XV. Pjesa 1, 1400-1405,*¹²⁴ njëri me Pranvera Bogdanin¹²⁵ dhe tjetri me Perparime Hutën.¹²⁶ Gjithsesi projekti diplomatikës së tij sa i takon përgatitjes së burimeve dokumentare për botim do të vendosej paraprakisht në dy shtylla: a. në botimin e dokumenteve të botuara nga të tjerët dhe b. në botimin e dokumenteve të pabotuara të nxjerra drejpërdrejt nga arkivat. Në të dy rastet parimi themelor i vendosur prej tij do të ishte i njëjtë : qëndrimi sa më besnik ndaj teksteve dhe paralel me ta botimi i transkriptimeve të dokumenteve origjinale përballë përkthimit shqip. Në mjaft raste në pamundësi për të patur përduarsh *de visu* faksimiljet e dokumenteve arkivore autentike, nxjerrë nga burime parësore, materialet burimore të këtyre vëllimeve Zamputti i ka siguruar duke hulumtuar nëpër bibliografite ekzistuese të botimeve me karakter përmbledhjeje dokumentesh ose në studimet që kanë në shtojcat e tyre dokumente për ilustrim; hulumtime në historigrabinë e shekujve XVI-XVII (nëpër studime apo shtojca studimesh të shoqëruara me dokumente shoqëruese ilustruese të nxjerra nga fonde të ndryshme arkivore (histori me karakter të përgjithshëm, itinerare udhëtimi të udhëtarëve, dhe për aq sa ishte e mundur edhe materiale dokumentare paralele¹²⁷ nga burime të ndryshme, materiale të krijuara nga kancelaritë, zyrtarët, entet, të cilët hartonin shkresa, urdhëresa, raporte, porosi etj), duke bërë njëherësh edhe korigjimet e duhura të gabimeve të shkaktuara nga mosanaliza e mirë e burimeve parësore ose edhe të bëra qëllimisht për arsye politike.¹²⁸ Një pjesë e madhe e këtyre dokumenteve kanë qenë të botuara, kryesisht prej au-

¹²¹ ZAMPUTI, Injac. *Dokumente për historinë e Shqipërisë "(1623-1653)/Documenti per la storia dell' Albania 1623-1653".* Transkriptuar e përkthyer nga - *Trascritti e tradotti da Injac Zamputti.* Albanisches Institut dhe "Faik Konica", Prishtinë 2015. 578 f. Shih po ashtu: Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar, (AQSH), Fondi 846, Dosjet 81, 82, 83.

¹²² Arkivin e Institutit të Historisë Tiranë. në sinjalizimin A - II - 535 dhe nr. inv. 4120. Vëllimi i parë f. 1 - 115, Vol. II. f. 116 - 197. Përktheu Injaz Zamputi, (1988). Shih po ashtu: *Relacion i Kryeshkopit të Tivarit Vincent Zmajevich i përkthyer nga Injac Zamputi mbi gjendjen e dioqezave dhe peshkopatave në Shqipëri për shek. XVIII (1702- 1703).* Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 106. 175 fletë. Shih po ashtu dosjet 104 dhe 105 të të njëjtit fond.

¹²³ ZAMPUTI, Injac. *Dokumente të shekullit të XVIII për historinë e Shqipërisë, Vol. I. (1700 - 1718),* Materiale të gatshme për shtyp. Dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë. (A - III - 55 z. Nr. inv. 4208).

¹²⁴ *Dokumete për historinë e Shqipërisë të shek. XV. Pjesa 1, 1400-1405.* Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi. Tiranë, Akademia e Shkencave, 1987. 712 f.

¹²⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV (1406-1410),* v. II, përktheu Injac ZAMPUTI dhe Pranvera Bogdani BOGDAN. Arkivi i Institutit të Historisë. A-III-563.

¹²⁶ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV (1411-1416),* v. III, përktheu Injac ZAMPUTI dhe Perparime HUTA. Arkivi i Institutit të Historisë. A-III-564.

¹²⁷ ZAMPUTI, Injac. « Parathënie », *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë,* Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Historisë Vëll.I. (1507-1592), Tiranë 1988. f. 3.

¹²⁸ Shih: ZAMPUTI, Injac. në: *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653),* Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputti / *Documenti per la storia dell' Albania 1623-1653,* Trascritti e tradotti da Injac Zamputti, St. Gallen-Prishtinë 2015, f. 572.

torëve dhe institucioneve të huaja si ato studiuesve të ndryshëm si: Augustin Theiner,¹²⁹ Franc Mikloshich,¹³⁰ Stojan Novakovič, Eusebius Fermendzin,¹³¹ Franjo Rački, Sime Ljubič, Ivan Kukuljevič, Vikentij Vasilyevich Makučev,¹³² Charles Hopf,¹³³ Franc Babinger,¹³⁴ Giuseppe Gelcich, Nicolae Jorga,¹³⁵ Marino Sanuto,¹³⁶ Konstandin Jireček, Ludëig von Thalloczy, Milan Sûflay,¹³⁷ Gennaro Maria Monti,¹³⁸ Konstantinos Sathas,¹³⁹ Vittorio Catualdi, Constantin Marinesco, François Lenormant,¹⁴⁰ Donato Fabianich,¹⁴¹ Luigi Maria Ugolini,¹⁴² Cirillo Karolevskij,¹⁴³

¹²⁹ THEINER, Augustin. *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historia Illustrantia, maximam partem nondum edita ex tabulariis vaticanis deprompta et collecta, ab Augustino Theiner. 1: Ab Innocentio PP. III. usque ad Paulam PP. III, 1198-1549.* Romae : Typis Vaticanis. Romae, 1863. XXXVIII, 667 p. THEINER, Augustin. *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam illustrantia maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis deprompta collecta ac serie chronologica disposita T. 2 A Clemente VII usque ad Pium VII (1524-1800). cum additamentis saec. XIII. et XIV.* Zagrabiae Officina Societatis Typographicae 1875. XVI, 346 p.

¹³⁰ MIKLOSICH, F. –MÜLLER, J. Acta et Diplomata graecae medii aevi sacra et profana collcta, editerunt, Franciscus Miklosich et Josephus Müller, volumen. I-VI, Vindobonae, Wien, 1860-1890.

¹³¹ FERMENDŽIN, Euzebije. Acta Bosnae potissimum ecclesiastica cum insertis editorum documentarum registis ab anno 925 usque ad annum 1752. *Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium. 1892. Volume 23 di Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. MSHSM 23, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagabriae, 1892, 613 pp. f. 337-338.*

¹³² MAKUSHEV, Vikentij. *Monumenta Historica Slavorum Meridionalium vicinorumque populorum deprompta a Tabulariis et Bibliothecis Italicis a Vincentio Macushev etc....* Vol. I-II. Belgradi, M.DCCC.LXXX-M.D.C.LXXXII.

¹³³ HOPF, Charles. *Chroniques Gréco-Romanes*, par Charles Hopf, Berlin, Weidmann, 1873.

¹³⁴ BABINGER, Franc. *Das Ende der Arianite*, München, 1950. *Fundi i arianitëve*, Përktheu nga gjermanishtja Nestor Nepravishta, Plejad, 2004.

¹³⁵ JORGA, Nicolae. *Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades*, Ive sèrie 1453-1476, Bucaresti 1916. f. 194-197.

¹³⁶ SANUDO, Marino. *I Diarii di Marino Sanuto.* (1496-1533). A cura di Rinaldo Fulin, Federico Stefani, Nicolò Barozzi, Guglielmo Berchet, M. Allegri, Vèll. I-VI. Venezia, Visentini, ed. 1879.

¹³⁷ THALLÓCZY, Ludovicus De, – JIREČEK, Costantinus – ŠUFFLAY, Emilianus De. *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia.* (Akte dhe diploma që ilustrojnë çështje të Arbërisë së Mesjetës). Collegerunt et digresserunt Vol. I (Annos 344-1343). Tabulamque geographicam continens). Vindobonae MCMXIII. Vjenë, (1913). Typis Adolphi Holzhausen. XXXVIII + 292 pp; Vol. II. (Annos 1344–1406 continens). Vindobonae, MCMXVIII Vjenë, (1918). Typis Adolphi Holzhausen XXIII + 301 pp. Botimi i dytë fototipik u bë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave & revista EKSCLUZIVE, Tiranë-Prishtinë, 2002. Vepra ishte menduar të kishte 5 volume, por ky projekt nuk u realizua. Shih për këtë letrën që Milan Shyflaj i dërgonte Lumo Skëndos, botuar në revistën *Dituria*, nr. 12. tetor 1928 f. 372 - 374.

¹³⁸ MONTI, Gennaro Maria. *La spedizione in Puglia di Girgio Castrionta Scanderbek e i feudi pugliesi suoi, della vedova e del figlio.* In : IAPIGIA, numero speciale « La Puglia e l'Albania », Anno X/1930, Fasc. III. f. 275-320.

¹³⁹ SATHAS, Kōnstantinos N. *Documents inedits relatifs a l'histoire de la Grece au moyen age publies sous les auspices de la Chambre des deutes de Grece / par C. N. Sathas.* Paris, Maisonneuve et C. 9 volume. 1880-1890.

¹⁴⁰ LENORMANT, T. M. *Turcs et Monténégrins*, par F. Lenormant. Paris, 1866.

¹⁴¹ FABIANICH, Donato. *Storia dei Frati Minori dai primordi della loro istituzione in Dalmazia e Bosnia fino ai giorni nostri II*, Tip. Fratelli Battara, Zara, 2 vol. 1863, 1864, 464 & 382 p.

¹⁴² UGOLINI, Luigi Maria. "Pagine di Storia Veneta ai tempi Scanderbeg e dei suoi successori (con due documenti inediti)"- Në: *Studi Albanesi*, Istituto per l'Europa Orientale, Vol. III-IV. Romë, 1933-1934. 68 pp

¹⁴³ KARALEVSKIJ, Cirillo. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche.* Fasc. 1-3. Estratto dal BESSARIONE, Rivista di Studi Orientali, Roma, M. Bretschneider, 1911-1913. 3 v. 157 pp. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche.* Fascicolo I. Estratto dal "Bessarione", rivista di studi orientali, Anno XIV, Serie 3, Fascicolo 111-113). Roma, 1911. 41 pp. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche. La missione greco-cattolica della Cimarra nell'Epiro nei secoli XVI-XVIII. Documenti inediti ricavati dall'Archivio della S.C. di Propaganda Fide e del Pont. Collegio Greco.* Fascicolo II. Estratto dal "Bessarione", rivista di studi orientali, Anno XV, (Serie III), vol. 8, Fascicolo 117-118). Roma, 1911-1912. p. 49-92. *Documenti inediti per servire alla storia delle chiese italo-greche*, Fascicolo III. Estratto dal "Bessarione", rivista di studi orientali, fasc 120 [aprile-giugno 1912] e 123 [gennaio-marzo 1913]. Roma, M. Bretschneider, 1912-1913. p. 93-157.

Fulvio Cordignano,¹⁴⁴ Giuseppe Valentini,¹⁴⁵ etj., të cilët nuk e kanë pasur si qëllim më vete botimin e dokumenteve për Shqipërinë por janë marrë në shqyrtim për botim për shkak të përbajtjes integrale të dokumentit për viset ballkanike në të cilat bënte pjesë edhe Shqipëria, por që gjendeshin në botime të ndryshme vetëm në gjuhën e origjinalit e që thuajse përbënin raritete dhe ishin të shfrytëzueshme me shumë vështirësi, për shkak se pjesa më e madhe e tyre ishin botuar rreth një shekull më parë, ndaj edhe kjo kishte bërë të nevojshëm botimin e tyre, ndërsa një pjesë fare e vogël e tyre që u përfshinë aty, janë dokumente të dala drejtpërdrejt nga burimore arkivore, kryesisht rastësore. Në jo pak raste dokumentacioni i botuar më parë ka qenë i njëanshëm, i kufizuar në hapësirë dhe në përmbajtjen e tij integrale, i kushtëzuar kështu varësisht dhe qëllimisht nga synimi i autorëve përgatitës të përmbledhjeve dokumentare dhe më pas edhe i botueve të tyre. Në këto dokumente ka edhe ndonjë rast kur dokumenti nuk është botuar i plotë, por vetëm pjesa që Zamputti e gjykoi se kishte interes dhe që nevojitej, ngaqë sillte informacion rreth zhvillimeve ekonomiko-sociale, kishtare dhe politike të vendit në territoret e trojeve etnike shqiptare, duke ndjekur kështu një praktikë të njohur në botimet e ngjashme të kësaj natyre. Çdo material dokumentar i botuar më parë ose jo, që trajtonte në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi çështje që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe shqiptarët është paraqitur në këto vëllime në rend kronologjik. Një pjesë dokumentash, nisur nga qëllimi i ndryshëm autorëve dhe botuesve të cilat nuk e kënaqnin rigo-rozitetin shkencor, kur ka qenë e mundur janë përkthyer drejtpërdrejt nga origjinali duke sqaruar gabimet e mundshme të shtypit dhe duke e lexuar korrekt origjinalin. Pranëvënia e origjinaleve ballas përkthimit shqip nga autori ynë është përcjellë gjithashtu me një punë redaktuese kritike mbi tekstet e botimeve nga të cilat ai i ka nxjerrë dokumentet. Në mungesë të dokumenteve origjinaleve arkivore, punën redaksionale e bërë mbi bazën e një shqyrtimi të imët kritik duke e shoqëruar këtë me shënimet përkatëse. E gjitha kjo është pasqyruar në përkthim, ku autorit i është dashur të mbajë sërish qëndrim të qartë duke zgjedhur udhën më të drejtë dhe për çdo paqartësi, dykuptimësi apo paplotësi dhe për t'a lehtësuar studiuesin, tekstin e përkthyer e ka shoqëruar me shënime sqaruese të mbushura me informacion tejet të vlefshëm në funksion të kuptimit sa më të saktë të teksteve përmes një një logjike intuitive depërtuese të përimituar e cila njëkohësisht vjen e koncentruar dhe e qëruar nga inflacioni gjuhësor i panevojshëm. Kjo ishte një bërthamë që do të shërbente për një punë sistematike të hulumtimeve të ardhshme sepse Zamputti ishte i bindur se dokumentet e botuara prej të huajve kishin mangësi, se madje kishte parashikuar se „Në kohë të ardhshme do të dalë nevoja që edhe materialet e njohura e të botuara prej hulumtuesve të huaj të sigurohen me mjete moderne të riprodhimit fotografik për të bërë siç e thamë transkriptime të drejtpërdrejta.“¹⁴⁶ Pjesa më e madhe e materialeve qenë krijuar për nevoja të administratës dhe luftës, për të siguruar të dhëna lidhur me pozitën strategjike dhe burimet ekonomike për të cilat interesoheshin oborret princërore e mbretërore. Një pjesë e madhe e këtij dokumentacioni nuk është i drejtpërdrejtë, por i tërthortë, i gjentur kryesisht në korrespondencën, relacionet dhe memo-

¹⁴⁴ CORDIGNANO, Fulvio, S.I. *Geografia ecclesiastica dell' Albania dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII*, (Gjeografia kishtare e Shqipërisë prej dekadave të fundit të shekullit të XV deri në gjysmën e shekullit të XVII) Roma. Pont. Institutum *Orientalium Studiorum*, 1934. ff. 70. Ribotim në: *Orientalia Christiana Periodica*, Roma, Vol XXXVI. (36) 4. Num.99. Decembri 1934. Roma, ff. 229 - 294.

¹⁴⁵ CORDIGNANO, P. Fulvio – VALENTINI, P. Giuseppe. *Saggio di un Regesto storico dell'Albania*. Scutari, Tipografia Dell'Immacolata, 1937 - 1940. 106 p. përmban te një regest me 1490 dokumenet për periudhën 1199-1568.

¹⁴⁶ ZAMPUTI, Injac. « Parathënie », në: *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Historisë Vëll.I. (1507-1592), Tiranë 1988, f. 5.

rialet që mbaheshin me botën e jashtme. Shqipëria ishte pjesë e takimit të drejtpërdrejtë me botën Perëndimore përgjatë gjithë bregdetit të saj nga Tivari, Ulqini, Shkodra, Lezha, Durrësi, Vlora, Butrinti e po ashtu edhe Himara-Labëria, Shqipëria Veriore dhe ajo e Mesme Qendrore, Dukagjini etj. Qëllimi i botimit të tyre ka qenë vënia në dispozicion të studiuesve dhe studimeve e dokumenteve të dorës së parë, të cilat do të mund të shërbenin si bazë për interpretime dhe riinterpretime të çështjeve dhe ngjarjeve të caktuara historike të përfshira në kufijtë kohorë ku datohen dokumentet e botuara.¹⁴⁷

III

DOCUMENTUM/MONUMENTUM.

Dokumenti dhe statusi i tij si monument.¹⁴⁸ Revolucioni dokumentar i Zamputti-t. Teknika, metoda, instrumentet.

“A mund t’a dokumentosh?” opo “A mund t’a vërtetosh?” është kjo pyetje që përgjithësisht na shfaqet sa herë bëjmë biseda lidhur me historinë për raste të dyshimta ngjarjesh, për të cilat nuk jemi të sigurtë për saktësinë e tyre dhe si për t’i fortifikuar e ftojmë bashkëbiseduesin të na “provojë” me “fakte” dokumentare dyshimet tona lidhur me vërtetësinë e pohuar prej tij. Janë këto dy pyetje të cilat i dëgjon më së shumtin nga profesorët e regjur të historisë të cilët i ngrenë si provokim nëpër auditorë universitare me studentët e tyre. Është pikërisht çasti kur futet në lojë me autoritetin e tij dokumenti. Një dokument është dëshmi dhe njëkohësisht shprehje e një marrëdhënie të caktuar e cila na vjen si vullnet asnjans e që d.m.th., i pavarur, ndaj me të drejtë ai është konsideruar si monument.¹⁴⁹ Pikërisht për t’i dhënë rëndësinë e duhur dokumentit, me kohë u formësua edhe diplomatika e cila është një disiplinë që studion dëshmitë e shkruara e që ushtrohet kryesisht në tekste dhe detyra e saj është të furnizojë publikun duke botuar tekste dokumentare me një redaktim kritik të stabilizuar, të përdorshëm e të padyshimtë. Si nismëtar i kësaj discipline konsiderohet rregulltari jezuit Daniel van Papebrock (1628-1714), nën kujdesin e të cilit u botua seria e mirënjohur e etërve jezuitë bolandistë: *Acta Sanctorum e nisur së botuari në Anversë në vitin 1643 nga Jean Bolland (1596-1665), ndërsa themeluesi i saj në kuptimin e mirë të fjalës konsiderohet murgu benediktin i Shën Maurit Jean Mabillon (1632-1707), me veprën De re diplomatika libri VI (1681), autori gjithashtu i Annales Ordinis Sancti Benedicti (1703-1707). Problemi i unifikimit të metodës së botimit të burimeve dokumentare në trajtën e normave të përgjithshme të vlefshme edhe për disiplina të tilla si paleografia, filologjia dhe diplomatika, e ka zanafillën në gjysmën e dytë të shekullit të XIX për t’u disiplinuar në gjysmën e dytë të shekullit të shkruar. Metoda e ndjekur nga diplomatistët gjermanë Theodor von Sickel (1826-*

¹⁴⁷ Shih: MALLTEZI, Luan. “Injac Zamputi - Historiani shqiptaro-italian që hodhi dritë mbi mesjetën tonë”. *Gazeta shqiptare*. Nr. 4837, 13 shkurt, 2010, f. 18 - 19.

¹⁴⁸ Termi «document» vjen nga folja latine *doceo* që do të thotë me paraqitë, me paraqitë një fakt. Folja latine brendamban një mbivendosje të tillë semantike me një tjetër term *monéo*, prej së cilës rrjedh fjala *monument*. Në një epokë jo fort të largët termat *documentum* e *monumentum* përdorehin si terma të barazvlershëm. Diplomatika e përcakton dokumentin si « dëshmi të shkruar të një fakti të natyrës juridike, hartuar në forma të ndryshme, të cilat janë në gjendje të sigurojnë besueshmërinë e provës së faktit të kryer».

¹⁴⁹ LE GOFF, Jacques. *Documento/Monumento*, in *Storia e memoria, Enciclopedia Einaudi*, Torino 1978, vol. V, pp. 38-43.

1908), Paul Fridolin Kehr (1860-1944) e Harry Bresslau (1848 – 1926) në serinë magjistrale dhe unike dokumentare gjermane dhe europiane njëherësh *Monumenta Germaniae Historica* (MGH), mbetet themelore dhe e pakalueshme ende deri më sot në nivel kontinental. Posaqërisht vepra e këtij të fundit (Harry Bresslau) *Handbuch der Urkundenlehre für Deutschland und Italien/Manuale di diplomatica per la Germania e l'Italia*,¹⁵⁰ përbën për lexuesin i specializuar, traktatin përmbledhës organik më rigoroz e më sistematik sa i takon metodologjisë historiko-filologjike të zbatueshme në fushën e diplomatikës, e cila mbetet vepra me autoritetin referencial të padiskutueshëm në nivel ndërkombëtar. Duhet thënë se në vende të ndryshme u pa nevoja për të formuluar disa kritere sikurse në Itali në vitin 1902,¹⁵¹ Spanjë në vitin 1944,¹⁵² Belgjikë në vitin 1955,¹⁵³ në ish-Bashkimin Sovjetik 1955.¹⁵⁴ Diplomatika është po ashtu edhe një disiplinë si të thuash filologjike që themelohet mbi kritikën e teksteve, por që aspekti filologjik i saj duket sikur mbetet në hije. Me kohë është arritur të bëhet një rivlerësim i pozicionit të diplomatikës si disiplinë historike duke marrë parasysh objektin e saj sikurse është riprodhimi besnik, përgatitja dhe publikimi i dokumenteve. Rimarrja e një nisme të dytë botuese me karakter sistematik si entitet dokumentar kërkon një angazhim teknik bazuar në metodën, interesin dhe rezultatet që do të bënte të mundur një rivlerësim të burimeve dokumentare të fushës politike, kishtare, sociale dhe ekonomike, si investim i domosdoshëm në kërkimet për studimet historike për historinë e popullit shqiptar. Për studimin shkencor të dokumenteve si fonde historike është e nevojshme kritika diplomatike, dhe si i tillë botimi kritik i burimeve dokumentare paraqet si në aspektin formal dhe në atë substancial mjaft elementë të cilët nuk korrespondojnë me normat e formuluar nga filologët për botimet e teksteve të vjetra letrare. Fenomeni, le ta quajmë “relativiteti burimeve” – ka të bëjë me rastin kur dy ose më shumë burime për një arsye ose një tjetër nuk bien pajtohen, nuk bien dakord për të njëjtin fakt të cilit i referohen. Për ta zbutur apo si i thonë për ta zgjidhur këtë çështje studiuesit dhe studiuesve u duhet të shtënë në punë metodën e kritikës dokumentare. Është për t’u vënë re fakti se termi “diplomatikë” në

¹⁵⁰ *Handbuch der Urkundenlehre für Deutschland und Italien*. Leipzig, Verlag von Veit & Comp., 1912. XVIII, 746 p. Leipzig, Verlag von Veit & Comp., 1915. X, 392 p. Berlin, Leipzig, E. de Gruyter & Co, 1931. VII, p. 394-664. Botimi i parë në një vëllim të vetëm doli fillimisht në vitin 1889, e që u pasua me një rishimim të plotë të tij, i cili u botua në dy vëllime; fillimisht vëllimi i parë në vitin 1912, si dhe pjesa e parë e vëllimit të dytë në vitin 1915. Pjesa e dytë e vëllimit të dytë u kompletua nga Hans Ealter Kleitz pas vdekjes së Bresslau-t, dhe u botua në vitin 1931. Ne kemi konsultuar në vitin 2012, botimin respektiv të përkthyer e botuar në italisht në vitin 1998: BRESSLAU, Harry. *Manuale di diplomatica per la Germania e l'Italia*. Traduzione di Anna Maria Voci-Roth; sotto gli auspici della Associazione italiana dei paleografi e diplomatisti. Roma, Ministero per i beni culturali e ambientali, Ufficio centrale per i beni archivistici, 1998. LXXXVI, 1423 p.

¹⁵¹ Shih: *Norme Generali per la Pubblicazione dei Testi Storici per servire alle edizioni della Regia deputazione di Storia Patria per le Antiche province e la Lombardia*, Torino, 1902; *Norme per la stampa delle Fonti per la storia d'Italia*. Pubblicato in «Bullettino dell'Istituto storico Italiano», 28 (1906), pp. XI-XXI; *Norme per la pubblicazione documentarie della Società storica subalpina*, in «Bollettino storico-bibliografico subalpino», 35 (1933), p. CENCETTI, Giorgio. *Progetti di unificazione delle norme per la pubblicazione delle fonti medioevali*, in: Atti del Convegno di Studi delle Fonti del Medioevo Europeo" in occasione del 70° anniversario della fondazione dell'Istituto Storico Italiano (Roma 14-18 aprile 1953). Vol. II, Comunicazioni, Roma, nella sede dell'Istituto, 1957. p. 25-34; TOGNETTI, Giampaolo. *Criteri per la trascrizione di testi medioevali, latini e italiani*. (Quaderni della «Rassegna degli Archivi di Stato», 51). Roma, Panetto & Petrelli, 1982. 66 p

¹⁵² *Norma de transcripcion y edicion de textos y documentos*. C.S.I.C, Escuela de Estudios Medievales (EEM). Madrid 1944.

¹⁵³ *Instruction pour la publication des textes historiques*, Bruxelles 1955.

¹⁵⁴ *Pravila izdanija istoriceskich dokumentov*, Moskva, 1956.

studimet shqiptare ka munguar ose më sak nuk është përdorur nga askush më parë me sa dimë ne deri në vitin 2015, kur atë e bëri publik studiuesi i mirënjohur Aurel Plasari, pikërisht në përkujtim të Zamputti-t.¹⁵⁵ Po ashtu në të gjithë fjalorët e shqipes përpos termit *diplomatikë* mungon edhe termi *diplomalist*. Të mos ketë ditur gjë Zamputti-i rreth saj është pothuajse e pamundur, kur shihet puna që ai na ka lënë mbas. Zaten se gjëja e fundit që mund të hamendësohet mund të ketë qenë ngatërresa që sjell si shembull Plasari mes “diplomatikës” dhe “diplomacisë”, e cila mund të kishte rezultuar edhe një “dregëz” jo fort pa shkak, kruarja e së cilës do të ngatërronte keqas Zamputtin me nostalgjinë e studimeve për shkencat politike, e për rrjedhojë edhe me pasoja e mbase për këtë arsye nuk është zgjatur më shumë. Është e tepër të zgjatemi më tej. Studentët dhe studiuesit e rinj që pretendojnë të hyjnë në albanologji vijojnë ta vuajnë edhe sot e kësaj dite mungesën e një teksti bazë rreth kësaj disipline. Metoda kritiko-filologjike e historike e përdorur prej Zamputti-t është metoda e duhur botuese e cila duhet të jetë uniforme si model që duhet të jetë bazike në teknikën paleografike e diplomatike për të fituar kështu pavarësinë dhe autoritetin bindës të duhur në duar të historianëve të ardhshëm. Për historinë e albanologjisë Eqrem Çabej dhe Injac Zamputti do të themelonin dy „shkollat“ e tyre përkatëse; shkollën filologjike dhe atë të diplomatikës. I pari në vitin 1959 me “Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre”,¹⁵⁶ dhe i dyti në vitin 1963 me „Parathanie-n“ e „Relacioneve“. Diplomatika si “specie” filologjike shqiptare si të thuash është themeluar si disiplinë filologjike më vete edhe si kritikë e teksteve dokumentare nga Injac Zamputti. Filologjia e diplomatikës së tij shkon krahas kritikës së tekstit. Zgjedhja mes filologut të teksteve letrare dhe filologut të teksteve dokumentare përbën edhe zgjedhjen autentike, arketipin origjinal të studiuesit shqiptar të cilit iu desh të çelte udhë dhe të vijonte i vetëm pothuajse pa ndjekës. Ai ishte studiuesi unik që përgatiti edicionet disavëllimshe të teksteve dokumentare të riprodhuar në mënyrë integrale nga burime të ndryshme qoftë arkivore të mbledhura nëpër arkiva të ndryshëm dhe qoftë të botuara më parë në botime në vende të ndryshme. Për kërshërinë e lexuesve, ndonëse një tekst i gjatë për citim, por e riprodhohet më plotë pjesën që na intereson:

“Në përgatitjen dhe në paraqitjen e këtyne materialeve dokumentare kemi punue në bazë të disa kritereve të cilat e shohim të nevojshme t’ua themi lexuesve. Në radhë të parë do të flasim për ato materiale që na i kemi marrë nga botimet e maparshme. Në redaktimin e tyre na jemi përshtetur mbi tekstin e botuem sepse nuk i posedojmë origjinalet në fotokopje. Gjatë procesit të punës shpesh kemi pasë rasë dyshimi rreth një terme, një emni ose një shprehje për të cilën na patëm bindjen se duhej t’ishte një gabim transkriptimi ose shtypi. Kur të mendojmë shkrimet e vështira t’origjinaleve, damtimet që ato kanë pësue nga koha, emnat e panjohun e të huej për botuesit, si edhe vështirësitë tipografike në të cilat kanë ndeshë botuesit, atëherë bindemi se lajthitjet janë të mundshme. Megjithatë, sa kohë që qemë të detyruem të punojmë vetëm përmbi ato botime, nuk patëm mundësi në rasë të dyshimta veçse të çfaqnim dyshimet tona dhe të banim shënimet relative. Kur u gjetëm përballë dy ose tri varianteve të të njëjtit dokument, si p.sh. na ngjau me relacionin e Marian ose Françesk Bolicës të vjetit 1614, atëherë bamë çdo përpjekje që

¹⁵⁵ PLASARI, Aurel. “Injac Zamputti, themeluesi i diplomatikës shqiptare”. Gazeta *Panorama*, E enjte, 28 prill 2016, f. 18-19.

¹⁵⁶ ÇABEJ, Eqrem. “Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre”, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Seria e Shkencave Shoqërore, Tiranë 1959, Nr. 2, f. 104-115. Botuar edhe në *Studime gjuhësore*, bl. VI, Prishtinë, 1977, f. 329-341. Botimi i II. Prishtinë, 1988, f. 324-340.

të jepnim një tekst sa ma kritik që patëm mundësi. Në lidhje me materialet dokumentare, që na kemi transkriptue nga fotokopjet e origjinaleve, kemi ndjekë kriterin t'i mbahemi besnikë tekstit tue pranue çdo grafi, të sigurtë, të pasigurtë ose edhe të gabueme që mund të kishte dhanë autori, pa prekë asnjë shenj dhe asnjë veçanti të shkrimit. Në rasë të rralla, aty ku fjala n'origjinal mund të sillte ndonjë dyshim ndër lexuesit se mos ishte lexim i gabuem prej nesh, i kemi vumë përbri një (sic). Nga një herë, në të tilla rasë, kemi vumë edhe të zakonshmen (!) për t'ua tërheqë vemendjen lexuesve se e kemi lexue me kujdes. Natyrisht kjo nuk përjashton se në ndonjë rasë mundet që na vetë nuk kemi dijtë të lexojmë mirë, sepse lajthitjet janë gjithmonë të mundshme, sado kujdes që t'i vihet punës. Gabimet e vogla të dukshme nuk e pamë me udhë as t'i ndreqnim as t'i shënonim me ndonjë kllapë si u tha sipri. As kjo nuk përjashton gabimet tona dhe ato që eventualisht do të na dalin nga shtypi. Në përgjithësi lexuesi duhet të ketë parasysh se tekstet i kemi lexue me kujdes, por se gjuha, stili dhe sidomos ortografia e këtyne materialeve pasqyrojnë në përgjithësi vështirësitë ose lëkundjet karakteristike të gjuhës italishte në korrespondencën private e kancelareske si edhe shkallën e ultë t'arësimit në të cilën gjendej ky ose ai shkruer. Shpesh herë ndodh që origjinalet janë të damtueme dhe ndonjë fjalë ose shprehje ka mbetë e copëtue me ose fare e shlyeme. Në përgjithësi, dhe me ndonjë përjashtim të parandësi, fjalët i kemi plotësue kur kemi qenë të qartë, dhe këto pjesë të shtueme i kemi vendosë në kllapa katrore. Edhe këtu gjithashtu nuk përjashtohet ndonjë lajthitje jonë. Në lidhje me kllapat katrore, që kemi vendosë në pjesët e përkthimeve, do të vrejme se kanë vlerë tjetër. Mbrenda këtyne kllapave, në pjesët shqipe, kemi vendosë fjalë e shprehje që nuk i ka teksti, por që na vetë i kemi shtue me qëllim që ta bajmë ma të kuptueshëm. Qoftë në tekstet e origjinaleve, qoftë në përkthimet, kudo ku na vetë nuk kemi pasë siguri leximi, kuptimi, përkthimi etj., zgjidhjen që kemi dhanë e kemi shoqnu me një pikëpyetje të vendosun në kllapë (?). Aty ku nuk kemi pasë asnjë mundësi të plotësojmë vendet e zbrazta etj. kemi vendosë një radhë pikash: E vetmja punë, që kemi bamë në redaktimin e materialeve të transkriptueme prej nesh nga fotokopjet, ka qenë se fjalëve ua kemi zhvillue shkurtimet që përdorte grafia e kohës dhe prandëj fjalët, në këto rasë, i kemi dhanë të plota. Dhania e fjalëve të plota asht përdorë dendun nga botuesit e dokumentave të kësaj natyre. Mundësi lajthitje nuk ka, por, kur na u paraqit edhe dyshimi ma i vogël, na e lamë të paprekun fjalën. Këtu na duhet të vemë në dijeni lexuesit se na dallojmë atë që, në këto shkrime, asht shkurtim i grafisë së fjalëve nga copëtimi që u ban fjalëve në disa rasë shkruesi. Për shkurtim na kuptojmë ato trajta që e riejnë rranjën e fjalëve, ose një pjesë të saj, dhe e lidhin me mbaresën; p.sh. **V're, Ves°, t'po, n'ro, Ill.mo** etj. që na i zbërthejmë respektivisht: **Vostre, Vescouo, tempo, nostro, Illustrissimo** etj. Fjalë të copëtue janë përkundra ato që jepen ose me një shkrojtë të vetme, ose vetëm me dy-tri shkrojat e para, pa ndonjë mbaresë; p.sh. **N.S., sac., V.S.** etj. që na n'origjinal i lamë të paprekuna por tue i dhanë të plota ose të zbërthyeme në përkthim kur edhe këtu nuk patëm mundësinë të lamë copëtimet pa shkaktue keqkuptim. Në lidhje me përkthimet do të shënojmë se jemi përpjekë jo vetëm t'i qëndrojmë besnikë origjinalit, por edhe të ruenim deri ku t'ishte e mundun edhe stilin e autorit. Nuk i kemi standardizue as kristalizue disa shprehje e disa terma të cilat, nga gjuha e origjinalit, mund të silleshin (dhe efektivisht i sollëm) ose në një formë ose në një tjetër pa ia cenue kuptimin. Dihet se secila gjuhë ka veçoritë e veta. P.sh. fjalën **possessioni** disa herë e përkthijem **tokë buke**, disa herë vetëm **tokë** dhe ndonjë herë edhe **prona**, si na u duk ma mirë në rasë të veçanta, por që të gjitha të njëjtën gja thonë. Ka pastaj rasë sinonimie, si p.sh. dy fjalët **parroco** dhe **curato**, me gjithë ndryshimet e nuancat që mund të kenë, për rasët tona i përkthijem me të njëjtën termë: **famullitar**. Por nga ndonjë herë na u duk se për fjalën e dytë mund të përdornim pa keqkuptim

fjalën shqipe kujdestar; kështu, rrjedhimisht, fjalën cura e përkthyer kujdestari. Në disa relacione ka shprehje që përsëriten në pambarim në formë të standardizuese; na i kemi përkthyer me forma të ndryshme, të gjitha me kuptim të barabartë, sepse s'dinim pse të zgjidhnim njenën formë ma parë se tjetrën. Kështu p.sh: frazën che la serve e përkthyer pavarësisht herë: që i shërben asaj (kishë), herë: që shërben aty (n'atë kishë). Dhe kështu me radhë, dhe lexuesi do të na falë lajthitjet të cilat aspak nuk besojmë se i kemi shmangë, me qenë se vështirësitë në disa rasë janë të pakapërcyeshme për fuqitë tona. Ne na qetëson fakti se studiuesit po i vëmë para edhe tekstet origjinale dhe do të dijë t'i gjejë e t'i korrigojë lajthitjet tona. Dihet se ka vështirësi të mëdha t'identifikosh toponimet në disa rasë dhe t'ua vesh përbri termën që u përgjigjet sot. Disa identifikime që kanë bamë botuesit të bajnë edhe me buzëqeshë. Këto vështirësi rrjedhin: a) ose nga pasiguria grafike e shkruarit; b) ose nga evolucioni që ka bamë vetë terma; c) ose nga zhdukja dhe emigrimi i toponimeve. Në pamundësi ta banim në çdo rasë identifikimin, kemi ndjekë këtë rrugë: në përkthimin shqip i japim toponimet n'ato grafi dhe n'atë interpretim si kemi arrijtë me ndihmën e hartave gjeografike ose me bibliografinë ekzistuese. Aty ku nuk dijtëm ta identifikonim, e sollëm fjalën n'atë trajtë që na u duk ma mirë për leximin shqip. Edhe në rasët në të cilat interpretimi ynë paraqet pasiguri ose do të shkaktojë gjithnjë buzëqeshje, menduem se përpjekja jonë nuk e damton saktësimin dhe punën e matejshme që mund të bajnë studiuesit. Po ashtu kemi veprue edhe me onomastikën të cilën po e japim të shqiptarizuese n'atë interpretim si kemi arrijtë me kërkimet tona, por gjithëmonë me rezervë dhe pa mbyllë shtegun e përsaktësimeve të matejshme.”¹⁵⁷

Ky tekst ka pasur dhe ka ende vlerën e një manuali të vogël metodologjik për diplomatikën shqiptare. Zamputti ka mbajtur shënime në skedarët dhe në fletoret e tij, çdo dokument, por mbi të gjitha kryesorja për të ka qenë të mos i ikte nga dora asnjë prej tyre; asnjë e dhënë dokumentare që kishte lidhje me Shqipërinë që nga lashtësia e deri në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Vështirësia kryesore që i është paraqitur ka qenë deomos mospasja në dispozicion e botimeve të rralla të dokumentacionit, sidomos ato të shekullit XIX, fakt ky që e ka detyruar të daktilografojë ose të shkruajë mundimshëm në fletoret e tij, sikurse mund të shihet në fondin e tij personal në AQSh. Pavarësisht kësaj, ai i ka kopjuar me dorë apo daktilografuar tekstet e plota të dokumenteve të nxjerra nga këto botime, dhe kjo pavarësisht nga fakti që ato dokumente i ka transkriptuar më pas drejtpërdrejt nga fotokopjet dhe mikrofilmat që i sillëshin prej arkivave të Venedikut, të Romës dhe të Raguzës, mbasi ai vetë kishte përgatitur më parë listën e dokumenteve që ua dorëzonte ekipeve që më pas shkonin për t'i mikrofilmuar. Familjarët dhe miqtë e tij dëshmojnë punën e tij prej murgu mbi mikrofilmat që i sillnin nga arkivat e huaja. Mbasi ia zmadhonin, ai punonte me orë të tëra me lentin e tij ndër duar para syve, duke lexuar dhe bërë transkriptimin me një durim të jashtëzakonshëm. Pasi i hidhte në letër tekstet e dokumenteve me ato shkrimet karakteristike të silitizuara në formë dhe përmbajtje sipas përdorimeve të kohës, sidomos sqaronte shkurtimet e tyre si dhe plotësimet e pjesëve të dëmtuara prej kohës, ai i hidhte me shkrimin e tij të bukur në të pastër e më pas i përkthente dhe niste duke bërë plotësimet e duhura të toponomastikës dhe mikrotoponimisë historike për emrat e moçëm që shfaqeshin nëpër dokumente, duke i lokalizuar ato përmes konsultimeve të hartave të vjetra që kishte arritur t'i koleksiononte

¹⁵⁷ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII.*, Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3 dhe 3/2, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. f. 9-10.

qëllimisht për këtë punë.¹⁵⁸ Edhe punën përfundimtare në makinën e shkrimit e bënte gjithnjë vetë. Nuk ia linte t'a kryente këtë punë asnjë daktilografisti sepse dëshironte të kontrollonte gjithçka vetë deri në imtësi. Po ashtu edhe në fazën përmbyllëse, ia sillnin bocat e shtypshkronjës sipas porosisë së tij, për t'i korrigjuar po ai vetë. Po ashtu bibliografia, të gjitha shënimet, të gjitha treguesit emërorë të emrave të vendeve dhe të personave në fund të librave me dokumenta, shpjegimet terminologjike të fjalëve të veçanta janë përgatitur të gjitha nga dora e tij. Si për të provuar se sa dëshirë të madhe kishte ai që t'a „provonte“ sërish veten me dokumentet, edhe pse i kishte nxjerrë duarsh me kohë, Zamputti-i, ishte prapë aty, madje kjo punë nuk përfundonte as këtu në vëllimet e përgatitura e të botuara në bibliotekën e tij, pjesë e përdorimit personal. Përfund tyre shihen sërish shënime plotësuese të të zotit të tyre i cili kuvendimin me ta e kishte pasur pjesë të ekzistencës së tij, e që nuk mori më vete duke na e lënë trashëgim pajë për brezat e ardhshëm të diplomatikës shqiptare.

Vijues i traditës së „shkollës jezuite“, Zamputti-i do të vijonte ta çonte më tej këtë traditë, gjithnjë i vetëm dhe gjithnjë brenda Shqipërisë, pa as më të voglin kontakt fizik me vendndodhjet e burimeve arkivore, ndërkohë që kolegu i tij At Valentini do ta vijonte edhe ai të çonte në realizim të njëjtën punë me *Acta Albaniae Veneta*,¹⁵⁹ edhe ai pa pasur as më të voglin kontakt fizik dhe komunikativ me vendin „amë“, ku tashmë arkivi i tij ishte sekuestruar pa lënë gjurmë të pashme publikisht. Mbledhjen dhe botimin e burimeve dokumentare, Zamputti e shoqëroi me kritikën e burimeve e cila si disipinë u zhvillua nga Ernst Bernheim (1850-1942). Ajo konsiston para së gjithash në vlerësimin e autenticitetit të një burimi duke verifikuar besueshmërinë e tij qoftë në rastet kur kemi të bëjmë më shumë se me një kopje të të njëjtit dokument, sikur është rasti i relacionit të Mariano Bolicës (1614), për të cilin autori ka punuar mbi tre kopje të ndryshme¹⁶⁰ përmes ushtrimit të metodave komplekse të cilat duke u ndërkëmbyer arrijnë të integrojnë njohuri të shumta ndërdisiplinore. Vëllimin e parë të *Relacione-ve*,¹⁶¹ Zamputti-i e ka pajisur në fund të tij me dy lloj shënimesh për secilin dokument : shënime për tekstet origjinale (f. 467-475), dhe shënime për tekstet shqipe (f. 475-499), ndërkohë që në vëllimin e dytë të botuar dy vjet më pas shënimet për tekstet origjinale i vendosi në fundfaqe, ndërsa shënimet e për tekstet shqipe sërish në fund të vëllimit. Nuk janë

¹⁵⁸ „Harta të Shqipërisë të grumbulluara nga Injac Zamputi për efekt studimi“. Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 96. 50 fletë.

¹⁵⁹ VALENTINI, Giuseppe. *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Joseph Valentini S. J. Labore reperta et transcripta. Pars Tertia (Scanderbegianam Periodum complectens), Vol. I - XXIV. Munchen, 1951 - 1973. Shih: CAPIZZI, Carmelo. „Gli Acta Albaniae Veneta di Giuseppe Valentini“, Estr. da: *Rivista Storica del Mezzogiorno*, a. 5, n. 1-4, Lecce: I.T.E.S, 1970. p. 76-88; po ai: „Un' opera decisiva della storiografia albanese: gli Acta Albaniae Veneta di Giuseppe Valentini“. Estr. da: *Dissertationes albanicae: in honorem Josephi Valentini et Ernesti Koliqi septuagenariorum* / [Redaktion: Peter Bartl, Martin Camaj, Gerhard Grimm], B. 13, 1971. Munchen: Trofenik, 1971. p. 9-20. 206 p.

¹⁶⁰ Ky relacion është nxjerrë nga Arkivi i Venedikut dhe është botuar së pari nga F. Lernormant në veprën; *Turcs et Monténégrins*, Paris, Didier et.C. i e, 1866, f. 286 - 330. „Relazione di Mariano Bolizza diretta a Michele Maffio, sul sangiacato di Scutari“. „Relacion i Mariano Bolicës drejtue Mikel Maffos, mbi sanxhakun e Shkodrës, Vjeti 1614“. (Ljubic in STARINE, v. XII, p. 166-193). Anno 1614. në: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vol. I. (1610 - 1634). Tiranë, 1963. f. 241-293. (ital. 240-292). Origjinali gjendet në Arkivin e Shtetit në Venecia, (në *Miscellanea Codici N. 254*), gjendet në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë me numër vendi: Dr. 3.A.2. [2] fl. 57 f.

¹⁶¹ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vol. I. (1610 - 1634). Tiranë, 1963.

pak por rreth 1700 shënime në të dy vëllimet, të cilat së bashku me fjalorthin terminologji në fund të vëllimit të dytë përbëjnë, një manual të jashtëzakonshëm sqarimesh të kontestit historik, sqarimesh gjuhësore e posaçërisht toponomastikë si dhe përkufizimeve terminologjike njëherësh të cilat dëshmojnë akribinë shkencore të dijetarit Zamputti. Shpjegimet e thukëta nganjëherë deri në përimtime në dukje të karakterit episodik, sidomos sa i takon terminologjisë kishtarë kanë qenë, janë dhe do të mbeten për shumë kohë një model konsultimi për studiuesit, arsimtarët, gazetarët, studentët dhe lexuesin e kultivuar që do të ketë rastin t'i përdorë këto vëllime. Aty do të gjejnë për çdo rast nëpër shënime dhe në këtë fjalorth këshilluesin e patëmetë. Dokumentet janë transkriptuar drejtpërdrejt nga riprodhimi fotografik i origjinaleve duke i vendosur përkrah përkthimit edhe traskriptimin e origjinalit, pra qoftë në gjuhën e origjinaleve, qoftë në përkthimin shqip, të përcjella gjithashtu me shënime dhe komente sqaruese të karakterit terminologjik,¹⁶² historiko-diplomatik, toponomastikës historike¹⁶³ dhe gjuhësisë, të cilat nga ana tjetër përbëjnë një aparat ndihmës fort të çmuar për çdo studiues, për të mos thënë se janë të pazëvendësueshëm dhe të pandarë nga vetë tekstet e dokumenteve, në funksion të të cilëve ato janë përgatitur. Interpretimi i të dhënave që përcjellin dokumentet e botuara prej tij, janë një çelës me rëndësi thelbësore në kuadrin e vetë burimeve që na ka sjellë Zamputti e që ruajnë vlerën e interpretimeve po kaq të rëndësishme sa mund të krahasohen me vetë dokumentet. Ai në mjaft raste është munduar të zgjidhë se kush e ka prodhuar, ku është prodhuar dhe cili është konteksti i dokumentit duke kombinuar dhe ndër-këmbyer kështu të dhënat e integruara shpesh të paqarta të dokumentit me dokumentet e tjera paraardhës e pasardhës në rend kronologjik. Duke kaluar nga faza e parë filologjike që lidhet me vlerësimin e autenticitetit formal të dokumentit, përmes analizës së shkrimit, analizës stilistikore (formulimit stilistikor përshtendës) hyrës (pra nëse është e shkruar nga e njëjta dorë), apo datimin në koherencë me kohën, vendin etj., Zamputti ka kaluar më pas natyrisht në fazën interpretative të dokumentit që ka të bëjë me vlerësimin e përmbajtjes së dokumentit të lidhur natyrisht kjo në marrëdhënie me dokumentet e tjerë paraardhës e pasardhës, duke nënvizuar, ndërshtënë dhe krahasuar mospërputhjet e mundshme që raportojnë të dhënat e secilit prej tyre. Zamputti është impresionues me intuitën dhe me interpretimet fenomenale që ka bërë, me « katarsisin » e shqyrtimeve të tij ; interpretime ndërdokumentare që kanë kaluar dhe integrojnë një "proces hetimor » të gjatë e të detajuar me nje ndërlidhje fenomenale mes tyre për të nxjerrë prej tyre kronologjinë e ndërtimit të fakteve historike në mënyrën më lineare të mundshme, të cilën për shekujt XVI-XVII e kishim thujse tërësisht fragmentare. Gjurmimi, qëmtimi, mbledhja, arkivimi, studimi, transkriptimi, përkthimi dhe pranëvënia origjinaleve; komentimi dhe paisja me shënime kritike si dhe me indeksat e emrave të personave dhe të vendeve e më në fund botimi i burimeve dokumentare për Shqipërinë dhe shqiptarët e bën Injac Zamputti-n ashtu sikurse e vën re Aurel Plasari "themeluesin e disiplinës së diplomatikës në historiografinë shqiptare"¹⁶⁴, dhe nuk do të ishte e tepërt të thuhet se po ai u bë njëkohësisht edhe themeluesi i shkollës historiografike moderne shqiptare në kuptimin e plotë të fjalës. Kontribut të rëndësishëm në

¹⁶² Vlen të përmendet puna e tij për hartimin e "Nomenclatorit (fjalorit) për shpjegimin e terminologjisë të dokumentave të periudhës së mesjetës" në 8 vëllime. Shih: Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar, (AQSH), Tiranë. Fondi 846. Dosjet 34-41 me 6573 faqe.

¹⁶³ «Studime të Injac Zamputti mbi toponime të ndryshme historike». Arkivi Qendror i Shtetit (A.Q.Sh.). Fondi 846. Dosja 24. 451 fletë.

¹⁶⁴ PLASARI, Aurel. "Injac Zamputi, themeluesi i diplomatikës shqiptare". Gazeta *Panorama*, E enjte, 28 prill 2016, f. 18-19.

studimet shqiptare për autorët e hershëm të letërsisë shqipe dhe sidomos për Pjetër Budin, përbën pa dyshim botimi dhe studimi i materialit të pakët arkivor të përgatitur për botim nga Zamputti, duke nisur nga letër-relacioni i famshëm i tij dërguar Kardinalit Gozadino,¹⁶⁵ njoftimet për vdekjen e tij në lumin Drin,¹⁶⁶ si dhe kopjen e akuzave¹⁶⁷ dhe procesverbalin e gjyqit të Kallmetit, shoqëruar me studimet përkatëse prej tij.¹⁶⁸ Por këtu do të ndalemi vetëm tek procesverbali i gjyqit të Kallmetit. Në dokumentin e transkriptuar përballë origjinalit me tiull: “Procesverbali për zhvillimin e gjyqit në Kallmet në lidhje me akuzat kundër abatis Nikollë Leka”, para 17 prillit 1642,¹⁶⁹ në fund të tij, Zamputti ka shënuar tre pika, të cilat na tregojnë vijimin e dokumentit, i cili këtu ndërpritet dhe menjëherë pas këtyre tre pikave është shënuar një numër referimi (347), që na dërgon në fundfaqe në të cilën lexojmë: “*Mungon vazhdimi në koleksionin e fotokopjeve tona.*” Pra dokumenti nuk është i plotë. Gjatë kërkimeve tona në *Archivio Storico de Propaganda Fide* (Arkivin Historik të Propagandës Fide) në muajt

¹⁶⁵ «Letër e Pjetër Budit drejtue kardinalit Gocadino (Gozzadino) përmbi organizimin e luftës në Shqipëri e vende të tjera të Ballkanit. Romë, 15 shtator, 1621”. “Lettera di Pietro Budi, vescovo nominato di Sappa, diretta al cardinale Gozzadino, in merito alla possibilità dell’organizzazione della guerra in Albania e nel resto dei Balcani”. U botua fillimisht në revistën “Përparimi”, Vjeta VII/1914. Nr. 2. f. 23-25, nr. 3. f. 43-44, nr. 4. f. 59-61 dhe nr. 5. f. 73-74, me sa duket prej drejtorit të kësaj të përkohshme At Gjon Bazhdarit S.J. Originali i kësaj letre së bashku me përkthimin shqip u botua nga Injac Zamputi fillimisht “Letër e Pjetër Budit drejtue kardinalit Gocadino (Gozzadino) përmbi organizimin e luftës në Shqipëri e vende të tjera të Ballkanit.” Romë, 15 shtator, 1621, në Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, 1958, nr. 2. f. 79-94, më pas në: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*. Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3 dhe 3/2, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. Dokumenti nr. 5. f. 297-311, (it. p. 296-310), (shënimet dhe referimet rreth tekstit gjenden në faqet 488-490), për tu ribotuar sërish me titullin: « Letra drejtuar kardinalit Gocadino prej Pjetër Budit kur ky po bëhej gati të vinte në Shqipëri në selinë e Papës, ku mendonte të zhvillonte një aksion për të bashkuar në luftën çlirimtare popullsitë e vendit. » në: *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Historisë Vol. III. (1603-1621), Tiranë 1989. Dok. Nr. 211, f. 376-392.

¹⁶⁶ Shih: *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*. Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë 3 dhe 3/2, Teksti origjinal dhe përkthimi, përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Vëll. I. (1610-1634). Tiranë 1963. 1623, Raguzë, 1 shkurt 1623. Letër e Ipeshkvit të Shkodrës, Domeniko Andreasit, drejtue kardinalit Barberino. E lajmon për vdekjen e Pjetër Budit etj. Ital. Dok. Nr. 6. f. 310-312, shqip f. 311-313; 1623, Raguzë, 28 shkurt – 1623. Letër e Ipeshkvit të Lezhës Benedik Orsinit, drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide. Lajmon për vdekjen e Pjetër Budit dhe porositi emnimit e ipeshkvit të ri. Ita. Dok. Nr. 7. f. 312, shqip f. 313; 1623, Raguzë, 8 mars – 1623. Letër e Ipeshkvit të Shkodrës, Domeniko Andreasit, drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide. Mbi vdekjen e Pjetër Budit dhe për emnimit e ipeshkvit të ri të Sapës. Dok. Nr. 8. Ital. f. 312-314, shqip f. 313-315; 1623, Lezhë, mars – 1623. Letër e ipeshkvit të Lezhës, Benedikt Orsinit drejtue Kongregacionit të Propagandës Fide. Mbi vdekjen e Pjetër Budit dhe mbi nevojën të zgjidhet ipeshkvi i ri. Dok. Nr. 9. Ital. f. 314-316, shqip f. 315-317.

¹⁶⁷ Shih: *Dokumente për historinë e Shqipërisë “(1623-1653)/Documenti per la storia dell’ Albania 1623-1653*. Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti da Injac Zamputti. Albanisches Institut dhe “Faik Konica”, Prishtinë 2015. 1641, para 22 gushtit – Frang Bardhi, me dorën e vet, dërgon kopjen e akuzave me të cilat rëndohet Nikollë Leka për keqbërjet e tij, ndër të cilat edhe nyja 12 që e fajëson për vdekjen e Pjetër Budit. Dok. Nr. 82. f. 293-296. 1642,

¹⁶⁸ ZAMPUTI, Injac. “Koha dhe veprimtaria e Pjetër Budit ». *Nëntori*, nr. 9, 1966, f. 123-142; “Qëmtime mbi Budin e Bardhin ». *Studime historike*, nr. 1, 1985, f. 165-176; “Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit ». *Buletini i shkencave shoqërore*, nr. 2, 1958, f. 67-79. Ribotuar në: *Pjetër Budi*, (Kumtesa dhe artikuj). Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 2008. f. 117-140.

¹⁶⁹ Shih: *Dokumente për historinë e Shqipërisë “(1623-1653)/Documenti per la storia dell’ Albania 1623-1653*. Transkriptuar e përkthyer nga - Trascritti e tradotti da Injac Zamputti. Albanisches Institut dhe “Faik Konica”, Prishtinë 2015. 1642, para 17 prillit – Procesverbali për zhvillimin e gjyqit në Kallmet në lidhje me akuzat kundër abatis Nikollë Leka. Dok. Nr. 89. f. 307-311.

maj-qershor 2017,¹⁷⁰ kaluam nëpër duar midis shumë vëllimeve të fondeve të atij arkivi, ku Shqipëria ka një fond dokumentar mjaft të madh, i cili mbetet ende i panjohur në më shumë se 80 % të tij; edhe vëllimin 264 në fondin *Scritture Originali riferite nelle Congregazioni Generali* (SOCC). Në dokumentin përkatës f^o 34, i cili ndërpritet, vumë re se janë ndërshtënë disa fletë të tjera të cilat nuk kanë lidhje me dokumentin në fjalë, dhe në këtë mënyrë kanë ndërprerë vijimin e dokumentit për të cilin po flasim. Menjëherë pas tyre vijon dokumenti/proceverbal, në fund të të cilit janë edhe nënshkruesit e atij gjyqi. Pra për çdo rast Zamputti ka vepruar sipas metodës së tij të punës, rreptësisht pedante në leximin e dokumentit. Zamputti i përcolli historiografisë shqiptare kontekstin e plotë të doktrinës arkivore bashkëkohore duke e shoqëruar atë me aplikimin d.m.th., botimin më të mirë të mundshëm të prodhimit dokumentar për aq sa i lejoj koha dhe energjitë e tij fizike. Injac Zamputti kreu në diplomatikën shqiptare në një farë mënyrë atë që bëri në Itali Antonio Ludovico Muratori (1672-1750).¹⁷¹ Emri i tij rezulton të jetë emri më i cituar pothuajse në të gjitha rrethet e studimeve albanologjike të disiplinave të ndryshme jo vetëm përmes gjurmës së dokumenteve por edhe përmes studimeve të tij të vyera. Duhet theksuar kjo e fundit, sepse përveçse operacioneve paleografike, tekstologjike e filologjike etj., në personalitetin e Zamputti-t shfaqet po ashtu në krye të herës historiani, për të vijuar më pas gjuhëtari, etnologu, shkrimtari, kritiku dhe studiuesi i letërsisë. Do të ishte në nderin e Akademisë së Shkencave, Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Institutit të Historisë që një nga sallat kryesore të tyre të kishin emrin e tij. Kam menduar dhe vija të jem i mendimit se pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), ose pranë Arkivit Qendror të Shtetit, (AQSh), duhej të kishte një shkollë të posaçme pasuniversitare në Paleografi, Diplomatikë dhe Arkivistikë, një lloj kursi specialistësh që përveç paleografisë, diplomatikës, filologjisë dhe gjuhëve të vjetra (greqisht, latinisht, osmanisht), të jepte mundësinë e formimit në aspekte teorike e praktike ndërdisiplinare, në mënyrë që kandidatët pjesmarrës të diplomuar në shkencat humanitare (histori, letërsi, gjuhësi, etnologji, arkeologji, antropologji kulturore, jurisprudencë apo teologji), të formoheshin si specialistë të pritshëm që garantojnë studimet e nesërme albanologjike. Më mirë se sa emri i Injaz Zamputti-t nuk do të mund t'a nderonte atë duke pasur përkrye emrin e tij.

Është për të ardhur keq që një koleksion i tillë dokumentar, i botuar sipas traskriptimeve të origjinaleve në italisht dhe përkthyer e pranëvënë në shqip, nuk gjendet në asnjë prej bibliotekave publike në rrjetin bibliotekar të Italisë. Mjafto të bësh një kërkim të thjeshtë në katalogun e *L'Istituto Centrale per il Catalogo Unico* (ICCU), në OPAC, e të vësh kollaj, madje të mbetesh i impresionuar dhe tejet i zhgënjyer që në të gjithë këtë rrjet bibliotekash publike, nuk gjendet qoftë edhe një

¹⁷⁰ Me këtë rast shkruesi i këtyre radhëve gjen rastin t'i shprehë mirënjohjen zotit Giovanni Foschi, arkivistit përgjegjës në sallën e studimit, i cili më mundësoi dhe me lehtësoi njëkohësisht vizitën dhe kërkimet e mia në atë arkiv.

¹⁷¹ MURATORI, Lodovico Antonio. *Rerum Italicarum Scriptores. (RIS)*. Rerum Italicarum scriptores ab anno aerae christianae quingentesimo ad millesimumquingentesimum, quorum potissima pars nunc primum in lucem prodit ex Ambrosianae, Estensis, aliarumque insignium bibliothecarum codicibus. Ludovicus Antonius Muratorius ... collegit, ordinavit, & praefationibus auxit, nonnullos ipse, alios vero Mediolanenses Palatini socii ... Cum indice locupletissimo. Mediolani, ex Typographia Societatis Palatinae in Regia Curia, 1723-1751. 28 volumi. Rist. anast. Bologna; [poi] Sala Bolognese, A. Forni, 1975-1983. 25 volumi in 28 tomi.

kopje e vetme e *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*. Një botim i tillë i një rëndësie të jashtëzakonshme për albanologjinë, i botuar për fat të mirë në një gjuhë të rëndësishme ndërkombëtare sikurse italishtja, e shkruar sipas transkriptimeve origjinale, për fat të keq mungon, ndaj midis shumë pritshmërive ribotimi i tyre kësaj here është i mirëseardhur.¹⁷² Në duart e albanologëve të huaj (posaçërisht atyre italianë), qarkullojnë botime të tjera me dokumente të nxjerra nga fondi i Arkivit të Propagandës Fide të botuara nga studiues të tjerë të huaj, që kanë ndonjë dokument për Shqipërinë, ndërkohë që koleksioni i Zamputti-t mungon. Me sa duket “rrezikshmëria” e Vatikanit përgjatë periudhës së regjimit komunist, ka bërë që Italia të përjashtohet nga huazimi bibliotekar, posaçërisht për këtë lloj libri, ndërkohë që për ironi të kërimit tënd mund të gjesh nëpër këto biblioteka përplot botime të ish-diktatorit, fjala vjen si: *Contro il revisionismo moderno, L' eurocomunismo è anticomunismo, Il pericolo angloamericano in Albania, Rapporto sull'attivit  del Comitato Centrale del Partito del Lavoro d'Albania*, dhe mjaft literaturë shtesë ideologjike të asaj kohe e cila gjendet mjaftueshëm në këto biblioteka, mbërritur me sa duket si literaturë e shkëmbyer. Dy vëllimet e *Relacioneve*, të botuara këtu e 50 vjet më parë janë kthyer në një raritet për studiuesit, pa folur pastaj për lexuesit, madje këta vëllime nuk gjenden në një numër të madh bibliotekash kryesore qytetëse në Shqipëri dhe Kosovë, pa folur për bibliotekat e institucioneve të tjera si dhe ato shkollore, ndërkohë që vepra studimore e Zamputti-t mbetet e shpërndarë nëpër organet periodike të shtypit përgjatë 50 vjetëve pa u botuar më vete sikurse do t'a meritonte, edhe përkundrejt një angazhimi publik të Institutit të Historisë kohë më parë për ta botuar atë, por është e qartë se edhe për atë institucion, nuk është e lehtë, sepse nuk mund të „shtrish këmbët më shumë se sa ke jorganin“, për më tepër që kujdesin nga të „ftohtët“ (jorganin), duhet ta presësh ta kesh nga qeveritë shqiptare që për gjithçka thonë se mendojnë, por vetëm për historinë dhe kulturën e këtij vendi që nuk kërkon aq shumë parà, nuk janë kujtuar dhe me sa shihet nuk e kanë ndërmend të kujtohen ndonjëherë. Deri atëherë shpresojmë se emri dhe vepra e Zamputti-t së paku të mos kursehet nga shpërdorimet dekorative presidenciale, jo se Zamputti ka nevojë për medalje, por është fatbardhësisht historiografia dhe kultura shqiptare që ka aq shumë nevojë për emra si ai i Injac Zamputti-t.

Milano, qershor-dhjetor 2017.

¹⁷² Mendojmë se titulli më i drejtë i këtyre vëllimeve do të duhej të ishte: *Relacione të vizitave baritore dhe letërkëmbimi i klerikëve nga Shqipëria në shek. XVII*.